L - 64

HENRIK BARIĆ

# HŶMJE NË HISTORÍN E GJUHËS SHQIPE

SHTËPIJA BOTUESE
„MUSTAFA BAKIJA"
PRISHTINË 1955

Dr. H. BARIĆ
profesor titullar i Universitetit dhe Drejtor
i Institutit ballkanologjik në Sarajevë

# HYMJE NË HISTORÍN E GJUHËS SHQIPE

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
BIBLIOTEKA LEGATË
KRIST MALOKI

Historija e njij gjuhe âsht njikohësisht historija e njij populli.

Fr. Kluge

SHTËPIJA BOTUESE
„MUSTAFA BAKIJA"
PRISHTINË 1955

E përkëthyen prej dorëshkrimit sërbisht

Hilmi THAÇI — Hasan KALESHI

Rrok Lumezit - kët përkthim timin, në shêj përvujtnije.

H. Thaçi

Të gjitha të drejtat, sidomos të dreitën e përkëthimit në gjuhë të hueja e rezervon autori

Nr.inv. L-64

64/07

## PASQYRA E LÂNDËS


I. Qëllimi dhe detyra . . . . . 7— 8
II. Indoevropeishtja zânafillëse. Atdheu i saj i lashtë. Karakteristikat e saja dialektore . . . . . 9—29
III. Pozita e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve t'afërta . . . . . 30—45
IV. Atdheu i hershëm shqiptár në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik. Kontaktet thrako-ilirjane. Ndikimet e greqishtes së vjetër. Kritika hipotezës skitjane . . . . . 46—52
V. Ndikimet e substratit paraindoevropjan . . . . . 53—58
VI. Epoka latino-romane. Hipoteza gotike . . . . . 59—71
VII. Ndikimet sllave . . . . . 72—80
VIII. Ndikimet e greqishtes së ré . . . . . 81—84
Regjistri analitik . . . . . 85—90
Regjistri (i fjalëvet, toponimevet etj.) . . . . . 91—99

## PASQYRA E LÂNDËS


I. Qëllimi dhe detyra . . . . . 7— 8
II. Indoevropeishtja zânafillëse. Atdheu i saj i lashtë. Karakteristikat e saja dialektore . . . . . 9—29
III. Pozita e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve t'afërta . . . . . 30—45
IV. Atdheu i hershëm shqiptár në mbrendësin e Gadishullit Ballkanik. Kontaktet thrako-ilirjane. Ndikimet e greqishtes së vjetër. Kritika hipotezës skitjane . . . . . 46—52
V. Ndikimet e substratit paraindoevropjan . . . . . 53—58
VI. Epoka latino-romane. Hipoteza gotike . . . . . 59—71
VII. Ndikimet sllave . . . . . 72—80
VIII. Ndikimet e greqishtes së ré . . . . . 81—84
Regjistri analitik . . . . . 85—90
Regjistri (i fjalëvet, toponimevet etj.) . . . . . 91—99

# SHKURTESAT

* = shêj trajte e rikonstruktueme.
\> = kalon në (= jep)...
< = rrjedh prej (= vjen nga)...
: = bashkërrânjore me...
khs. = krahasò

alar(odisht), arm(enisht), atdheu zân(afillës), avest(isht), bask(isht), berb(erisht), bret(anisht), bullg(arisht), çak(avisht), çam(ërisht), çek(isht), dak(isht), dakorum(anisht), dalm(atishtja)jug(ore), dalm(ato)rom(anisht), dor(isht), elam(isht), epir(isht), etrur(isht), frigj(isht), gal(isht), g(ath)avet(isht), geg(ënisht), got(isht), greq(isht), gr(eko)shqip, greq(ishtja e)mes(ëme), greq(ishtja e) ré, greq(ishtja e )vj(etër), gjeor(gjisht), gjuha zân(afillëse), hetit(isht), holl(andisht), iber(isht), indoev(ropeisht), indoev(ropeishtja) zân(afillëse), ind(ishtja e)vj(etër), iran(isht), iran(ishtja e)vj(etër), irl(andisht), ir(landishtja e)vj(etër), isl(andishtja e)vj(etër), istrorum(anisht), ital(isht), it(alo)shqip, jon(isht), kar(isht), kauk(azishi), kelt(isht), kërk(isht) [gjuha e vdekun romane e ishullit Kërk], kimr(ishtja e)vj(etër), korn(isht), korn(ishtja e) vj(etër), kret(isht), lat(inisht), lat(inishtja e)vj(etër), lat(inishtja)klas(ike), lesb(isht), let(onisht), ligur(isht), lit(uanisht), maq(edonisht) maq(edon)rum(anisht), medit(eranisht), meglen(isht), megl(eno)rum(anisht), mes(apisht), nord(isht), nord(ishtja e)vj(etër), oset(isht), osk(isht), pamir(isht), pers(ishtja e)vj(etër), prus(ishtja e)vj(etër), rus(isht), sem(itisht), sërb(isht), sllav(isht), sllav(ishtja e)vj(etër), sllav(ishtja) zân(afillëse), sllov(enisht), spanj(olisht), sum(erisht), shqip(ja e)vj(etër), shqipja zân(afillëse), shtok(avisht) tok(arisht), tosk(ënisht), umbr(isht), ung(aro)fin(landisht), uralo-alt(ajisht), venet(isht).

## I.

## QËLLIMI DHE DETYRA

1. Studimi i zhvillimit të njij gjuhe prej dokumenteve mâ të vjetra deri në gjêndjen bashkëkohore n'evolucjonin e saj âsht detyrë e gramatikës historike dhe e fjalorit historik, kurse njohja e zhvillimit të kësaj gjuhe âsht detyrë e linguistikës krahasore, e cila na jep mundësín që, tue studjue marrëdhânjet midis kësaj apo asaj gjuhe me gjuhët tjera, të njofim fazat nëpërmjet të të cilavet âsht zhvillue ajo deri n'epokën historike. Prandèj âsht e qartë se të dyja këto detyra duhet të lidhen midis tyne nëse duem të njofim historín e plotë të njij gjuhe. Në rastin konkret, dmth. përsa i përkèt gjuhës shqipe, fatkeqsisht, jemi shum larg prej kësaj mundësije. Shkaku âsht se lavrimi shkencuer i gjuhës shqipe në fazën historike, si edhè i çdo gjuhe tjetër, kërkon jo vetëm njohjen e hollësishme të dokumenteve të vjetra, por edhè shfrytzimin e rezultateve të nxjerruna nga studimet sistematike të dialektevet, rezultate të cilat kanë nji rândësí vêndimtare për shkak se burimet e shkrueme të shqipes janë të kohëve të reja, kurse gjurmimet në të dyja këto fusha nuk janë endè as në zânafillje dhe, pà bashkëpunimin aktiv të Shqiptarëve, të përgatitun në këte lâmë, madjè âsht e vështirë që të mêndohen.

Prandèj, në këte libërth, kushtue studentavet, kam dhânë vetëm kapitujt hŷmës në historín e gjuhës shqipe, dmth. jam orvatë që të shënoj, në vija te përgjithëshme, fazat e zhvillimit të saj parahistorik aqsa mund të bâhet në gjêndjen e sotshme të shkencës komparative, sepsè gjuha shqipe, megjithë përpjekjet e mëdha të shkencëtarëve të rrallë, ka mbetë në periferín e interesimit linguistik, për të cilën arsye ka endè shum mâ tepër çeshtje të pafillueme sesa të lavrueme, shum mâ tepër probleme të hapta sesa rezultate tashmâ të zgjidhuna. Dogma dhe shkenca janë kundrathânje, dhe mësimi dogmatik âsht

mohim' i frymës shkencore në përgjithësí. Prandèj, megjithë vêndin shqimit të kufizuem, jam orvatë të vêj gjithëmonë në dukje çeshtjet e pazgjidhuna, kurse në rastet jashtzakonisht instruktive kam parashtrue arsyet pro dhe contra, tue citue materjalin mâ të rândësishëm. Në këte mënyrë u jipet udhëzim për t'u thellue në probleme të ndryshme gjuhësore atyne që kanë prirje, vullnet dhe — mundësína.

Si në periudhën historike, ashtu edhè n'ate parahistorike shqipja ka qenë nën ndikimin e shumanshëm të gjuhëve të hueja n'atdheun e saj ballkanik, të lashtë dhe historik. Pikërisht në këte lâmë âsht punue mâ së tepërmi, por shum çeshtje të rândësishme endè nuk janë spastrue, sidomos përsa u përket marrëdhânjevet të gjuhës shqipe me gjuhët ballkano-romane — të gjalla dhe të vdekuna. Prandèj âsht detyrë themelore që të konstatohet kritikisht sesa kanë ndikue përnjimênd këto gjuhë në shqipen — tue pasë vazhdimisht parasỳsh kontributin e shqipes në formimin e gjuhës rumune, ku pikërisht gjindet çelsi për zgjidhjen e çeshtjevet të lokalizimit jo vetëm t'atdheut të lashtë të Shqiptarëvet në Gadishullin Ballkanik, por edhè të djepit të popullit rumun — dhe të zgjidhet çeshtja se kur kanë ardhë Shqiptarët n'atdheun e vet historik. Në lidhje me këte âsht edhè çeshtja e marrëdhânjevet mâ të lashta midis Shqiptarëve dhe Sllavëve të Jugut, çeshtje e cila, në kohët e fundit, âsht bâ objekt gjurmimesh të reja, por rezultatet e të cilavet, përsa i përkèt prioritetit të depërtimit n'atdheun historik të Shqiptarëvet, janë padyshim të gabueshme. Tue u thellue në gjurmimin e marrëdhânjevet reciproke parahistorike të gjuhës shqipe me gjuhët tjera ballkanike, linguistika kryen rolin e shkencës ndihmëse historike — sepsè në mungesë të plotë të burimevet historike, linguistika, me mjetet e veta, âsht e vetmja që mundet ta ndriçojë, të paktën dishka, errësinën e parahistorís së popullit shqiptár atỳ nga fundi i Kohës së vjetër dhe fillimi i Mesjetës. Prandèj jam përpjekë që ta lidhi parahistorín e gjuhës shqipe me parahistorín e popullit shqiptár.

## II.

## INDOEVROPEISHTJA ZANAFILLËSE.. ATDHEU I SAJ I LASHTË. KARAKTERISTIKAT E SAJA DIALEKTORE.

2. Linguistika krahasore, q'prej mâ se nji shekulli, ka sqarue çeshtjen se gjuha shqipe i përkèt grupit të gjuhëve indoevropjane, në të cilat, nga gjuhët evropjane, bâjnë pjesë: greqishtja, latinishtja (me gjuhët romane), gjuhët e lashta gjermanike, keltishtja, gjuhët baltike (lituanishtja, letonishtja bashkë me prusishten e vjetër të vdekun) dhe gjuhët sllave, kurse prej gjuhëvet t'Azís: indo-iranishtja (gjuhët arjane), armenishtja, mandèj gjuha e vdekun hetite n'Azín e Vogël dhe tokarishtja n'Azín Qendrore. Tue krahasue këto gjuhë, shkenca ka mërrijtë me vërtetue marrëdhânjet e afinitetit të tyne dhe ka mujtë me konstatue sesi âsht dukë gjuha zânafillëse e përbashktë prej së cilës, gjatë shekujvet, janë individualizue gjuhët e ndryshme indoevropjane.

3. Vetít fonetike të gjuhës indoevropjane. Krahasimi i gjuhëvet indoev. na tregon se indoev. zânafillëse ka pasë pesë vokale: *a, e, i, o, u,* të cilat kanë mujtë me qenë edhè të gjata edhè të shkurta, dhe veç këtyne ka pasë edhè dý vokale kualitativisht dhe kuantitativisht të padallueme, prej të cilavet njâni, i ashtuquejtuni *shva indogermanicum* ($=\partial_1$), âsht bâ për shkak reduktimi të vokalit të gjatë të patheksuem t'indoev., kurse tjetri, i ashtuquejtuni *shva secundum* ($=\partial_2$), për shkak reduktimi të vokalit të shkurtë të patheksuem t'indoev. Zâvendësimi i $\partial_1$ në gjuhët indoiranishte âsht *i*, kurse në të gjitha gjuhët tjera indoevropjane *a* — krahasò indvj. *pitâ(r)*, avest. *pitár*, greq. *patêr*, lat. *pater*, got. *fadar*, gjerm. *Vater*, irlvj. *athir*, arm. *hair* = indoev. **pə₁tē(r)* „babë, át"; indvj. *sthitáḥ* „tue qëndrue në kâmbë": greq. *statós*, lat. *status*, got. *staþs*, gjermvj.

*stat*, lit. *stataũ* = indoev. **st(h)ə₁*; greq. *hístāmi* = indoev. **sthā*; lat. *datus* : *dōnum*, *satus* : *sēmen* etj. Zâvêndësimi indoevropjan i *ə₂* âsht i ndryshëm: n'indishten e vjetër dhe në greqishten *a*, *i*, *u*; në gjuhët baltiko-sllave *i* dhe *u* (prej nga rrjedhin gjysëmzânoret e sllavishtes *ĭ* dhe *ŭ*); në shqipen, armenishten, latinishten dhe irlandishten e vjetër *a*, — krahasò shqip *katër*, lat. *quattuor*, sllavisht *četyre* (= çek. *čtyři*) me *e*-n shkallëplote në sllav. *četyre*, lit. *keturí*, osk. *petora* „4" dhe shqip *thadër* „spatë me dy teha", lat. *castrāre*, indvj. *šastrám*.

Tue u bashkue vokalet e shkurta indoevropjane *a*, *e*, *o* me *i̯*, *u̯* josilabike janë krijue diftongjet e shkurta indoev. *ai̯*, *ei̯*, *oi̯*, *au̯*, *eu̯*, *ou̯*. Krahasò indoev. **ai̯dh-* „me u djegë" në greq. *aithō* „digjem", latvj. *aide(m)* = latklas. *aedem* (akuz.); indoev. **dei̯os* „zot" = latvj. *deivos* (latklas. *dīvos*), lit. *deivẽ* „lugat"; indoev. **oinos* „nji" = greq. *oinḗ* „njishi" (në zár), latvj. *oino(m)* (latklas. *ūnum*); indoev. **au̯g-* „me u rritë" në greq. *aúdzō*, lat. *augeo* „shtoj", lit. *áugu* „rritem"; indoev. **eusō* „digjem" = greq. *éuō*; indoev. **louqos* „rrafshina" në latvj. (akuz.) *loucum* (latklas. *lūcum*). Diftongjet e formueme prej *shva indogermanicum*, në të gjitha gjuhët indoevropjane, janë bâ *ai̯*, *au̯* nëse në të njâjtën rrokje *ə₁i̯*, *ə₁u̯* nuk janë reduktue (krahasò greq. *pōma* „pije" nga indoev. **pō(i̯)-* me *pínō* (unë) „pij" nga **pə₁i̯-*, kurse diftongjet e formueme prej *shva secundum* janë bâ, qysh në fillim, *ī* dhe *ū*. Tue u bashkue vokalet e gjata origjinare *ā*, *ē*, *ō* me *i̯*, *u̯* josilabike janë bâ diftongjet e gjata origjinare *āi̯*, *ēi̯*, *ōi̯*, *āu̯*, *ēu̯*, *ōu̯*. Krahasò **āi̯* në dativ të njâjsit me mbaresën në *-ā* në indvj. *áśvay-ai* „pelës", greq. *khōrāi* „tokës", latvj. *Fortunai*, lit. *rañkai* „dorës"; *-ēi̯* (n'aoristin e greq. *éleipsa* = indoev. **é-léiqᵘ-s-m̥*; indoev. *ōi̯* në dativin e njâjsit, mbaresa në *-ŏ*: greq. *philōi* „mikut" dhe me humbjen e *i* së fundit — lat. *lupō*; indoev. **nāᵘs* „anija" = indvj. *nāuš*, greq. *naũs*, irvj. *nau*; indoev. *ēu̯* në **dḭ̄eus* „zoti i qiellit" = indvj. *dyāuš*, greq. *Dzeũs*; indoev. *ōu̯* në **gᵘōu̯s* „gjedh" = indvj. *gāuš*, greq. *boũs*.

Sistemit vokalik t'indoev. zânafillëse i përkasin edhè likuidet silabike *l̥*, *r̥* edhè nazalet silabike *m̥*, *n̥*, të cilat mund të jenë edhè të shkurta edhè të gjata, dhe janë krijue për shkak të reduktimit gjuhuer zânafillës të vokalevet të shkurta ose të gjata para likuideve ose nazaleve. Krahasò indvj. *pitr̥šu* „etënve": greq. *patéra* (akuz. „átin"), indoev. **mr̥tis* „vdekje" = indvj. *mr̥tiš*, lat. *mors* (prej **mortis* me *or* prej *r̥*), sllavvj. *sŭ-mrĭtĭ*; indoev. **ulqᵘos* „ujk" = indvj. *vr̥kaḥ*, sllavvj *vlŭkŭ* (*lŭ* = *l̥*). (Për *m̥*, *n̥* indoev. shih § 29).

4. Në konsonantizmin origjinár ka qenë kỳ sistem konsonantesh: Okluzivet. Simbas artikullimit ato ndahen n'okluzive tingullore dhe jotingullore (*p, b, t, d, k', ǵ*) të cilat në të dý rradhët paraqiten edhè si okluzive t'aspirueme (*ph, bh, th, dh, kh, gh*). Përveç *k, g, kh, gh* mbrapaqiellëzore kanë egzistue edhè dý rradhë origjinare: njâna me mbastingujt labjalë *q*ᵘ, *g*ᵘ, *q*ᵘ*h*, *g*ᵘ*h* dhe tjetra me pallatalet: *k', g', k'h, g'h*. Se këto pallatale kanë egzistue n'indoev. zânafillëse shihet se në nji grup gjuhësh indoevropjane kësaj rradhe i përgjigjen eksplozivet sibilante *s, sh, z, zh* (krahasò indoev. **dékm̥* = në greq. *déka* „10", lat. *decem* (lexò: *dekem*) përkundruell indvj. *daša*, lit. *dešim̃-t*, sllavvj. *desę-tĭ*; lat. *cornix* „laraska" përkundruell shqipes *sorrë*; greq. *gomphos* „thue-oni" përkundruell sllav. *zǫbŭ* (sërb. *zûb*); islvj. *gorn* „zorrë" përkundruell shqipes *zorrë* (me *rr* të vonëshme prej *rn*), lit. *žárna*. (shih § 24).

Nga sibilantet indoev. *s* dhe *z*, kỳ i fundit nuk âsht çfaqë si nji tingull i stërlashtë i pamvarun, por âsht krijue në fillim me kalimin e *s*-ës jotingullore në *z* para konsonantit tingulluer, ku ka ardhë — për arsye të ramjes së vokalit rrânjuer — n'afërsín direkte, krahasò fjalën indoev. për „folé" **ni-zd-os* (bret. *nez*, gjerm. *Nest*) të përngjitun prej *ni-* „tëposhtë" (krahasò indvj. *ni*, avest. *ni*) dhe *-sd-*, të shkallës së reduktueme të rrânjës **sed-* në lat. *sedēre* „me ndejë". Bashkëtingujt spirantë *j* dhe *v* n'indoev. zânafillëse nuk kanë egzistue. Tingujt *j, v* në disa gjuhë indoevropjane janë nji fazë e ré e tingujve gjuhorë zânafillës josilabikë *i̯, u̯*.

Në mbështetje të shêmbujve ku në disa gjuhë mbas *k*-ës çfaqet dentali (psh. greq. *árktos* „arí", gal. *artos*, irvj. *art*), kurse në disa gjuhë tjera çfaqet eksplozivi dental (psh. lat. *ursus*, avest. *arša-*) — konsiderohet se në gjuhën zânafillëse ka egzistue mâsëpari tingulli spirant *þ*.

5. Akcenti. N'indoev. zânafillëse kanë egzistue dỳ lloj akcentesh: akcenti *akut* (′), i cili ka mujtë me qëndrue në rrokje të shkurta ose të gjata (edhè në diftongje) dhe akcenti *cirkumfleks* (∼), i cili ka mujtë me qëndrue vetëm në rrokjet e gjata (edhè në diftongjet). Se kỳ shqiptim i dỳllojtë i gjatësís ka qenë origjinár shihet në nji varg mbrapashtesash në greqisht dhe lituanisht — krahasò psh. greq. nom. *alphê* (= indoev. **alg*ᵘ*hā́*) „dobí", lit. *algá* „rrogë" me gjen. greq.

BIBLIOTEKA KOMBETARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS BIBLIOTEKA LEGATE KRIST MALOKI

*alphẽs* (= indoev. **alg$^{u}$hãs*), lit. *algõs*. Akcenti i rrokjes së gjatë akute ka qenë ngjitës, (hypës), kurse akcenti i rrokjes cirkumflekse ka qenë zbritës. Këte na e vërteton përkueshmënija e plotë e gjuhëve sllave dhe greke në këte pikëpamje.

N'indoev. zânafillëse akcenti në fjalë ka qenë i shlirshëm, dmth. nuk ka qenë i lidhun për vêndin e caktuem në fjalë, si âsht psh. në gjuhën e sotshme shqipe, ku ai gjithmonë qëndron në të njâjtën rrokje në të gjitha trajtat (krahasò *báthë*, gjen.-dat. pl. *báthëve; mál-i*, gjen.-dat. pl. *máleve*), dhe pjesërisht edhè në derivatet (krahasò *çúpë*, dem. *çúpëzë*), ose në gjermanishten ku gjithmonë âsht në rrokjen e parë, ose në latinishten ku, në periudhën historike, ka qenë i lidhun për rrokjen e dytë ose të tretë nga fundi i fjalës ndaj kuantitetit të rrokjes së parafundit (krahasò *urtíca*, por *gélīdus*). Mirëpo edhè vetë gjuha latinishte tregon se para këtij sistemi të ngurtë akcentesh, theksi ka mujtë të qëndrojë edhè përpara rrokjes së fundit — krahasò psh. *capio* me *accipio*, *i*-ja e së cilës ka mujtë me ardhë prej *a*-s vetëm në rrokjen e patheksueme, prandèj trajta mâ e herëshme (trajta parahistorike) sigurisht do të ketë qenë **áccapio*. Se ku ka qenë vêndi origjinár i akcentit na tregon rrethana se në gjerm. zânafillëse tenuiset indoevropjane *p, t, k* nëqoftëse janë gjetë menjiherë përpara akcentit indoevropjan, janë bâ spirante jotingullore ndërsa kur nuk ka qenë kỳ rast, kanë kalue në spirante tingullore. Kështu psh. indvj. *bhrā́tār* „vlla" i përgjigjet got. *brôþar*, por indvj. *pitā́(r)* „ât, babë" — got. *fadar* (dmth. *faðar*); simbas këtyne rasteve duhet përfundue se n'ato fjalë në të cilat nji tenuisi indoevropjan i përgjigjet frikativi jotingulluer, akcenti origjinár ka qëndrue drejtpërsëdrejti përpara këtij tenuisi. Pozita e akcentit origjinár gjithashtu mund të vërtetohet edhè me anën e gjuhës shqipe — psh. në reflekset e bashkëtingullit fillestar t'indoev. *s*- në shqipen — sepsè në gjuhën shqipe *s*-ja kalon në *ǵ* (*gj*) vetëm kur qëndron drejtpërsëdrejti përpara akcentit origjinár — krahasò psh. shqip *gjumë*: indvj. *svápnaḥ*, greq. *hýpnos* përkundruell *shtatë* prej indoev. **septḿ-ti*.

Përveç kësaj, akcenti origjinár ka qenë edhè i lëvizshëm, dmth. ai në trajtat e ndryshme të të njâjtës fjalë ka mujtë të qëndrojë në vênde të ndryshme: në rrokjen rrânjore dhe në mbrapashtesat, (krahasò psh. indvj. *ēmi* „shkoj", *imáḥ* „shkojmë", greq. gen. *podós*, dat. *podí* krahas me akuz. *póda* poashtu si n'indvj. *padáḥ*, *padḗ*, krahas me *pā́dam*.

KRIST MALOKI

6. Si pasojë e kësaj l ë v i z s h m ë n i j e t'akcentit origjinár n'indoev. zânafillëse âsht çfaqë *alternacjoni vokalik*, dmth. ndryshimi i rregullt origjinár i kualitetit dhe i kuantitetit vokalik. Për alternacjonin kualitativ krahasò psh. greq. *potē* „fluturim" me *o* në rrokjen e patheksueme me *e* në të theksuemen psh. *pétesthai* „me fluturue", *pétomai* „fluturoj", *ō* në greq. *phōnē* „zâ" ndaj *ā* në *phā́nā* „zâ; prrallë", *ō* në greq. *eupátōr* me *patḗr*. Për alternacjonin kuantitativ krahasò rrokjen e gjatë rrânjore në greq. *phā́mā* „zâ" (indoev. **bhā-* „me folë") në rrokjen e theksueme me $ə_1$ (> greq. *a*) në *phamén* „né flasim" në rrokjen e patheksueme ose n'indvj. *sthitáḥ*, greq. *statós* me rrânjën *sthā-* „me qëndrue në kâmbë", për *e*-n e shkurtë në rrokjen e patheksueme gjindet $ə_2$ (krahasò psh. sllav. *tĭlo* me shkallëploten lat. *tellus* „toka") ose kŷ vokal i shkurtë i patheksuem humb plotsisht — krahasò greq. gjen. sing. *patrós*, dat. *patrí* me akuz. sing. *patéra*, nom. pl. *patéres*, greq. inf. e aoristit *ptésthai* „me fluturue" me *potē* „fluturim"; greq. *lipeîn* „me lânë", *élipon* „làsh" me *leípein* „me lânë vazhdimisht", greq. *é-lython* „erdha" me *eleúsomai* (= indoev. **(e)léudh-* „me ardhë"), got. *budum*, sllav. *bŭděti* me got. *biuda* (= indoev. **bheudh-* „me vështrue, me vû ré").

Kŷ reduktim vokalesh mund të kuptohet vetëm nën hipotezën se akcenti origjinár ka qenë shum ekspirativ, dmth. se rrokja e theksueme âsht shqiptue m â f u q i s h ë m; n'anën tjetër alternacjoni kualitativ (*e* – *o*, *ē* – *ō*) duhet të jetë pasojë e akcentimit muzikuer, simbas të cilit toni i rrokjevet të theksueme ka qenë m â i n a l t ë sesa n'ato të patheksuemet. Prandèj âsht e qartë se n'indoev. zânafillëse kanë veprue të dyja këto parime, si egzistojnë edhè sot në kaq gjuhë të gjalla. Por, meqenëse nuk mund të vërtetohet saktësisht se ato janë çfaqë në të njâjtën kohë, nuk jemi në gjêndje që ti konsiderojmë identike, sadoqë a p r i o r i kjo âsht shum e besueshme. Mirëpo, âsht e sigurtë se n'epokën e indoev. zânafillëse, të cilën mërrijmë me e kuptue me krahasimin e gjuhëvet me nji sistem akcentimi të ruejtun mâsëmiri, akcenti indoevropjan ka qenë kryesisht muzikuer. Çfaqja e *ē* (së gjatë) origjinare krahas me *ĕ*-n (e shkurtë) psh. në lat. *lēgī*, shqip *mb-lodha* (me *o* të shqipes nga *ē* indoev. shih § 43) krahas me lat. *lĕgo*, shqip *mb-ledh*, shpjegohet zakonisht me zgjatimin plotsues të të lashtit vokal të shkurtë, shkaktue me humbjen e rrokjes vijuese të patheksueme (greq. akuz.

*alphēs* (= indoev. **alg$^{u}$hās*), lit. *algōs*. Akcenti i rrokjes së gjatë akute ka qenë ngjitës, (hypës), kurse akcenti i rrokjes cirkumflekse ka qenë zbritës. Këte na e vërteton përkueshmënija e plotë e gjuhëve sllave dhe greke në këte pikëpamje.

N'indoev. zânafillëse akcenti në fjalë ka qenë i shlirshëm, dmth. nuk ka qenë i lidhun për vëndin e caktuem në fjalë, si âsht psh. në gjuhën e sotshme shqipe, ku ai gjithmonë qëndron në të njâjtën rrokje në të gjitha trajtat (krahasò *báthë*, gjen.-dat. pl. *báthëve; mál-i*, gjen.-dat. pl. *málеve*), dhe pjesërisht edhè në derivatet (krahasò *çúpë*, dem. *çúpëzë*), ose në gjermanishten ku gjithmonë âsht në rrokjen e parë, ose në latinishten ku, në periudhën historike, ka qenë i lidhun për rrokjen e dytë ose të tretë nga fundi i fjalës ndaj kuantitetit të rrokjes së parafundit (krahasò *urtica*, por *gēlīdus*). Mirëpo edhè vetë gjuha latinishte tregon se para këtij sistemi të ngurtë akcentesh, theksi ka mujtë të qëndrojë edhè përpara rrokjes së fundit — krahasò psh. *capio* me *accipio*, *i*-ja e së cilës ka mujtë me ardhë prej *a*-s vetëm në rrokjen e patheksueme, prandèj trajta mâ e herëshme (trajta parahistorike) sigurisht do të ketë qenë **áccapio*. Se ku ka qenë vëndi origjinár i akcentit na tregon rrethana se në gjerm. zânafillëse tenuiset indoevropjane *p, t, k* nëqoftëse janë gjetë menjiherë përpara akcentit indoevropjan, janë bâ spirante jotingullore ndërsa kur nuk ka qenë kỳ rast, kanë kalue në spirante tingullore. Kështu psh. indvj. *bhrātār* „vlla" i përgjigjet got. *brôþar*, por indvj. *pitā(r)* „ât, babë" — got. *fadar* (dmth. *faðar*); simbas këtyne rasteve duhet përfundue se n'ato fjalë në të cilat nji tenuisi indoevropjan i përgjigjet frikativi jotingulluer, akcenti origjinár ka qëndrue drejtpërsëdrejti përpara këtij tenuisi. Pozita e akcentit origjinár gjithashtu mund të vërtetohet edhè me anën e gjuhës shqipe — psh. në reflekset e bashkëtingullit fillestar t'indoev. *s-* në shqipen — sepsè në gjuhën shqipe *s*-ja kalon në *ĝ* (*gj*) vetëm kur qëndron drejtpërsëdrejti përpara akcentit origjinár — krahasò psh. shqip *gjumë*: indvj. *svápnaḥ*, greq. *hýpnos* përkundruell *shtatë* prej indoev. **septḿ-ti*.

Përveç kësaj, akcenti origjinár ka qenë edhè i lëvizshëm, dmth. ai në trajtat e ndryshme të të njâjtës fjalë ka mujtë të qëndrojë në vënde të ndryshme: në rrokjen rrânjore dhe në mbrapashtesat, (krahasò psh. indvj. *ēmi* „shkoj", *imáḥ* „shkojmë", greq. gen. *podós*, dat. *podí* krahas me akuz. *póda* poashtu si n'indvj. *padáḥ, padē*, krahas me *pā́dam*.

për titullim nominal[1]), por kjo s âsht e vërtetë. Nëse përjashtojmë vokativin, i cili, në të vërtetë, ka pasë mâ tepër karakter interjekcjoni (khs. greq. *phoré* „o bájtës" me imperativin *phére* „(m)baj!" – rrânja indoevropjane **bhére* – „me bájtë"), indoev. zânafillëze gjithësejt ka pasë dý rasa paradigmatike: a) *casus intransitivus* si objekt, gjegjësisht si subjekt intranzitivi; b) *casus transitivus* si subjekt tranzitivi. Prej rasës intranzitive (dmth. prej objektit të njij tranzitivi) janë krijue rasat e ndryshme t'objektit. Nëse prej rasës s'objektit do të krijohej akuzativi apo instrumentali i objektit, lokativi i objektit apo dativi i objektit në kohën e stërlashtë t'indoev. zânafillëse kjo mvarej prej vetë kuptimit të foljes[2]). Për ate që shpreh ablativi në gjuhët indoevropjane, n'indoevropeishten zânafillëse ka egzistue nji trajtë e veçantë për tregimin e vêndit prej nga dishka largohet dhe për rezultatin e veprimit foljuer.

Trajta specjale e gjenitivit origjinár ka egzistue n'êmnat, por vetëm në plural, kurse në singular nuk ka egzistue fare, si e tregojnë qartë ndryshimet që gjejmë për këte rasë në këte apo ate gjuhë indoevropjane (në gjuhët baltiko-sllave gjenitivi me mbaresën në *-o* âsht ablativi i vjetër — krahasò sllav. *vĭlka*, lit. *vilkõ* = lat. *lupō*, indvj. *vṛkād*; në gjuhët arjane, n'armenisht, në greqisht âsht nji trajtë e ré, përshtatë lakimit të përêmnavet diftorë, — krahasò indvj. *vṛkasya* si *tasya*, greq. *lýkoio* si *toîo*, në gjuhën e përgjithëshme gjermanike *wulfis* si *þis*; në latinishten, keltishten, ilirishten[3]), ligurishten[4]) ai ndërtohet me ndihmën e *-ī-s*, që përkon me adverbin e indishtes së vjetër në *-ī*)[5]).

Shkaku që trajta e stërlashtë e gjenitivit ka egzistue vetëm në plural âsht se marrëdhânja posesive nëvênd të cilës, në periudhën historike, përdoret gjenitivi adnominal, mâsëpari ka qenë shprehë me mjete tjera, sidomos me adjektivet posesive dhe, meqenëse adjektivi nuk ka shprehë numrin, për pluralin ka qenë e nevojëshme nji trajtë e veçantë. Zatën, në fillim ka egzistue nji numër i madh trajtash

---

[1]) Krahasò psh. Hans Krahe, *Indogermanische Sprachwissenschaft*, Berlin (1948) 77.

[2]) Krahasò O. Hujer, *Uvod u istoriju slovenskih jezika*, Beograd 1933, 18 dhe sidomos veprën time *Praindoevropska i indoevropska pitanja*, Beograd 1941.

[3]) F. Sommer, *Indogermanische Forschungen* XLII (1924) 219 etj.

[4]) H. Barić, *Lingvističke studije*, Sarajevo 1954, 56 etj.

[5]) Krahasò Wackernagel, *Mélanges de Saussure*.

me karakter adverbjal në të cilat nuk dallohej as numri gramatikuer, si shohim në trajtat greke me *-phi* (indoev. *-bhi*), që gjinden edhè në kuptimin singular dhe plural, — krahasò greq. (Homer) *iphi* „me fuqí" dhe *dakryophi* „me lot" dhe instrumentalin e armenishtes me *-b*.

8. Lakimi i adjektivit në të vërtetë nuk dallohet nga lakimi i substantivit, vetëm se në 'te shprehet gjinija gramatikore, simbas së cilës prej të njâjtës mbaresë ndërtohen të trija gjinít. Në shkallzim gjinden komparative të ndërtueme prej rrânjësh krejt tjera nga pozitivi, — krahasò lat. *bonus – melior*, sërb. *dobar – bolji*, gjerm. *gut – besser*, lat. *malus – peior*; sërb. *zao – gori* etj. Trajtat e komparativit ndërtoheshin me anën e sufik-eve specjale indoevropjane *-ies -ios* (*-iēs -iōs*) *-is-* (krahasò lat. *maior*, *maioris* „mâ i madh" prej **maĝ-ios*, neutrum *maius* prej *maĝ-iōs*; sllavvj. *bolje* prej **bol-ies*, akuzativi i neutrumit të sllavishtes *bliže* = **bliz-ies*) dhe me sufiksin *-tero* (krahasò indvj. *amá-tara-h*, greq. *ōmó-tero-s* „mâ i papjekun"). Sufiksi i superlativit âsht **-isto* (krahasò greq. *mĕg-isto-s* „mâ i madhi", indvj. *svād-išta-h* = greq. *hēd-isto-s*, got. *sût-ist-s* „mâ i âmbli"), pjesa e parë e së cilës dmth. *is-* âsht në lidhje me shkallën e reduktueme të sufiksit komparativ *-ies*; komparativeve me *-tero-* u përgjigjen superlativet me *-tə₂mo-* (krahasò indvj. *án-tama-h* „mâ i afërti; mâ i vyeshmi" = lat. *in-timu-s* „mâ i besueshmi"). Komparativi dhe superlativi nuk ndërtohen prej adjektivit, por prej rrânjës, prej së cilës âsht nxjerrë ai adjektiv, — krahasò komparativin e indvj. *svād-īyas*, superlativin *svad-išta-h* me pozitivin *svādú-h* = greq. *hed-íōn*, *hĕd-istos* me pozitivin *hedýs* „i hijshëm".

9. Përputhmënija midis lakimit origjinár të përêmnavet vetorë dhe lakimit t'êmnavet âsht bukur e madhe. Sikundër në lakimin e êmnavet (shih § 7), në fillim nuk ka pasë trajtë specjale për gjenitivin e përêmnave vetorë dhe, sikundër n'êmnat, marrëdhânja posesive âsht shprehë me adjektive, kështu ajo në përêmnat vetorë âsht shprehë me përêmna posesivë, të ndërtuem në shum mënyra, krahasò shqip *im*, arm. *im*, greq. *emós*; sllav. *mojĭ*, lat. *meus*, lit. *mána-s*, got. *mein-s* (lexò *mīns*). Midis trajtavet të përêmnavet vetorë në fillim ka pasë edhè t'atilla, të cilat nuk përputhen as me trajtat e êmnavet, as me ato të mbiêmnavet, si psh. lat. *tibi*, umbr. *tefe*, prusvj. *tebbei*, sllavvj. *tebĕ*. Përêmnat vetorë kanë nji rrânjë për

nominativ dhe nji tjetër për akuzativ — krahasò shqip *unë* (prej **udh-ne*): *më*, sllav. *azŭ*: *mene*, lit. *àš*: *manę*, lat. *egō*: *mē*, greq. *egṓ*: *emé*, indvj. *ahám*: *mam*, got. *ik*: *mik*; plur. sllav. *my*: *nasŭ*, got. *weis*: *uns* (prej **n̥s*). Përveç kësaj te përëmnat vetorë âsht nji rrânjë në singular, dhe rrânja tjetër në plural (krahasò indvj. nom. sing. *ahám* „unë": nom. i pluralit *vayám* „né", lat. *ego*: *nōs*, got. *ik*: *weis*, sllav. *azŭ*: *my*; lat. akuzativi i singularit *mē*: akuzativi i pluralit *nōs*, *tē*: *vōs* etj.). Meqenëse plurali i përëmnavet vetorë âsht shprehë me rrânjë tjetër, âsht e qartë se në fillim mbrapashtesat e singularit dhe të pluralit kanë qenë identike, si psh. në lat. *tibi* „tý": *vobi*, në trajtën historike *vobi-s* me *-s* sekondare simbas shëmbullit të *-s* së mbarapashtesavet t'ëmnavet dativ plural *-bos -bus* në latvj. *navebos* „anijeve", lat. *ovi-bus* „dhenve", *dea-bus* „perendeshave", *manu-bus* „duerve" etj.

10. Në lakimin e përëmnavet diftorë, me ndryshim prej përëmnavet vetorë, ka egzistue nji trajtë e veçantë për gjenitivin e singularit, — krahasò gjinín mashkullore të indvj. *tásya* (prej indoev. **tosio*) = greq. *toîo*, got. *þis* (prej indoev. **tesio*), gjinín femnore të indvj. *tásyai*, got. *þizai*. Zhvillimi i mâtejshëm i lakimit të përëmnavet diftorë âsht shum i ndërlikuem. Prej do rrânjësh përëmnore në disa gjuhë janë krijue paradigma, kurse në disa gjuhë tjera do rrânjë përëmnore ose kanë humbë krejtësisht, ose janë ruejtë si mbetunina të paqarta, për shëmbull indoev. **(o)vōm* (sllav. *ovŭ*) në mbrapashtesën e gjenitivit plural të shqipes *-ve* (shih § 37), ose indoev. **ono-* „ai" (sllav. *onŭ*) n'artikullin postpozitiv t'armenishtes *-n* (krahasò *mard-n* „njeriu atý"), kurse në greqisht, në trajtën e izolueme, *ênē* „mbasnesër = ajo ditë". Përëmnit diftuer t'indoevropeishtes së lashtë **k̂is*, të ruejtun në sllavishten *sĭ*, në lit. *šis* — krahasò edhè në shqipen *si-vjet* „këte vjet", *so-nte* „këte natë", i përgjigjet në lat. partikula deiktike *-ce* në *hice*, *hic*, *si-c*, *illuc*, *tun-c* etj.

Përëmni relativ origjinár ka qenë **i̯os* — krahasò indvj. *yaḥ*, greq. *hós*, frigj. *ios*, sllav. *i(že)*. Mbaresa e përëmnit pyetës origjinár ka qenë **q$^{u}$i* (krahasò lat. *qui-s* „kush?", *qui-d* „shka?", greq. *ti-s* „kush?", *ti* „shka?", sllav. *čĭ-to* „shka?"), gjegjësisht **q$^{u}$o*, *q$^{u}$ā* (krahasò sllav. *kŭ-to*, lit. *ká-s*, indvj. *ka-ḥ*).

11. Zgjedhimi n'indoevropeishtes zânafillëse. Si në lakim, ashtu edhè në zgjedhim, trajta origjinare ka pasë plot dhe

gjithfarësh. Janë dallue tri vehtje dhe tre numra. Nga *genera verbi* prej të cilëvet në gjuhët historike kemi tre, n'ato parahistorike kanë egzistue vetëm dy, aktivi dhe mediumi, kurse pasiv nuk ka pasë. Për pasivin në disa gjuhë gjinden inovacjone të ndryshme, midis të cilavet edhè përdorimi i medjumit në shërbimin e pasivit. Nëse kjo çfaqje ka fillue qysh në fazat e para t'indoev. zânafillëse âsht nji çeshtje endè e hapun. Sistemi i trajtavet të prezentit, të perfektit dhe t'aoristit ka qenë qysh atëherë i ndërtuem, kurse endè nuk âsht zgjidhë çeshtja nëse ka egzistue futuri në periudhën parahistorike. Duket se ai âsht ndërtue me sufiksin *-sio*, apo *-ə₁sio* me mbrapashtesat e prezentit tematik, (khs. indvj. *dā-syā-mi* „do të jap, kam me dhânë", lit. *dúo-sin*, me të cilat duket se âsht i afërt „futuri dorjan", i greqishtes, i tipit *do-sé-ō*, kurse trajtat normale atike te tipit *dō-s-ō* shpjegohen si kryqzim i trajtës së futurit në *-sio-* me konjuktivet e aoristit sigmatik.

Trajtat foljore janë ndërtue me mbrapashtesat primare dhe sekondare, prej të cilave të parat janë karakteristike për prezentin (dhe për perfektin) e indikativit, kurse të dytat për imperfektin, aoristin dhe pluskvamperfektin. Prej moduseve (mënyrave) në fillim kanë egzistue optativi dhe ndoshta edhè konjuktivi, sadoqë ka gjuhë indoevropjane të cilat nuk e kanë këte mënyrë, që nuk âsht identike edhè n'ato gjuhë të cilat e kanë, kurse imperativi në fillim ka qenë identik me rrânjën e thjeshtë — psh. indoev. **bhére* „(m)báj!" = indvj. *bhára*, greq. *phére*, got. *bair* (lexò *bēr*), lat. *fer* (prej **fere*) — krahasò *áge* „ndìq!". Kjo rrânjë ngandonjiherë (në foljet atematike) ka qenë e zgjânueme me partikula, — krahasò indoev. *dhi* në **i-dhi* „shkò!" = indvj. *ihí*, greq. *i-thi*; indvj. *i-tad* „le të shkojë!" (prej indoev. *i-tōd*) = lat. *ito;* greq *i-te*, indvj. *itá*, lat. *ite* „shkoni!" (prej indoev. **i-té*). Kauzativet prej foljevet primare janë ndërtue me anën e sufiksit indoevropjan *-éi̯ō* në të cilin rast, në rrânjë, paraqitet vazhdimisht shkalla kualitative *-o* për *-e*, — krahasò indoev. **sod-éi̯o* „vêndoj" = indvj. *sādáyāmi*, got. *satja*: indoevropeisht **sédō* „rrij, ulem"; indoev. **log-éi̯ō* „vêj" = sllavvj. *ložǫ*: indoev. **leĝhō* „shtrîhem"; indoev. **tor-éi̯ō* „lëshoj" = indvj. *tārayā-mi*, greq. *toréō*: indoev. **terō* „mërrij e kaloj" = indvj. *tárā-mi*. Po me këte sufiks ndërtohen foljet me kuptim iterativ ose frekuentativ, — krahasò indvj. *patáyami*: greq. *dotéomai* „fluturoj rreth e rrotull"; indvj. *pátāmi*, greq. *pétomai* „fluturoj"; greq. *tropéō* „rrutulloj andej këndej": greq. *trépō* „rrutulloj".

12. Infinitivi i tipit si gjindet në gjuhët historike indoevropjane, n'indoev. zânafillëse nuk ka egzistue, por s ka dyshim se në periudhën e stërlashtë kanë egzistue substantive verbale të shumta dhe të ndryshme, gjurmat e të cilave, si rasa të shtangueme, rrallë herë janë ruejtë në të njâjtën trajtë në shum gjuhna. Abstraktevet indoevropjane me *-ti-* u përkasin infinitivet e gjuhëve baltike dhe sllave me *-ti* (lit. *dúoti*, sllav. *dati*) të cilat ndoshta janë lokative të vjetra, kurse nga dativet abstrakte me *-ti-* rrjedhin infinitivet e indishtes së vjetër të tipit *pītayē* (prej indoev. **pi-tai-ei*). Infinitivi i indishtes së vjetër me *-tum* (i tipit *é-tum* prej indoev. **ei* — „me shkue"), në të vërtetë akuzativ i njij abstrakti formue me *-tu-* indoevropjane (krahasò lat. *ex-i-tus*), gjindet në latinishten si supin: *i-tum*. Mbaresavet indoevropjane me *-men-* u përkasin infinitivet e tipit t'indvj. *dāmanē* = greq. *dómenai* si dative primare prej indoev. *dō;* mbaresavet me *-s* u takojnë trajtat si indvj. *jīvasē* (dativi indoev. **gᵘiues-ai*) „me jetue", kurse lat. *vivĕre* = lokativi indoev. **gᵘiues-i;* nga akuzativet me mbaresë në *-o* rrjedhin infinitivet e gjuhës së përgjithëshme gjermanike me *-an* të tipit *itan* të gotishtes „me hângër" prej indoev. **ed-on-om* (krahasò indvj. **ad-an-am* „ngrânje" etj.).

13. Përveç êmnavet foljorë, n'epokën e indoev. zânafillëse ka pasë edhè adjektive foljore, të cilat qysh n'atë kohë janë bâ participe. Këtu bâjnë pjesë participet e prezentit t'aktivit me *-nt* (khs. psh. indvj. *bhárant*, greq. *phéront*, got. *bairand* prej trajtës indoevropjane **bher-o-nt* të nxjerrun prej rrânjes **bher-* „me bajtë, me bartë"), mandèj participi i perfektit të pasivit me *-no-*, krahasò indvj. *bhin-ná-ḥ* : *bhin*, dhe adjektivet verbale të sllavishtes me *nu* = indoev. *no-s* të tipit *dĕla nŭ*, greq. *ték-no-n* „fëmí" ( : *tíktō* „ndërtoj"). Për adjektivet verbale, apo për participet e perfektit me *-to-* t'indoevropeishtes — krahasò indvj. *kṛ-tá-ḥ* „i bâmë" (rrânja *kar-*), greq. *sta-tó-s*, lat. *sta-tu-s* ( : *stāre* „me ndejë në kâmbë"), sllavvj. *vi-tŭ* ( : *vi-jǫ*).

14. Përsa i përkèt sintaksës, âsht krejtësisht e sigurtë se me anë të metodës krahasuese mërrihet mâ vështirë në rikonstruktimin e gjêndjes origjinare sesa në fushat tjera të çfaqjeve gjuhësore, sepsè përputhjet sintaksore midis kësaj apo asaj gjuhe,

ngandonjiherë, mund të jenë të kushtëzueme me zhvillimin spontan paralel, dhe të mos rrjedhin prej epokës zânafillëse. Në lidhje me sintaksën e rasave, âsht e sigurtë se kuptimi i tyne themeluer në thelb âsht formue n'epokën e bashkësís gjuhësore indoevropjane. Me anë gjurmimi krahasuer të fjalís âsht vërtetue se n'indoev. zânafillëse ka mbretnue parataksa, kurse fjalí mvartëse, nuk ka pasë, me përjashtim të fjalive relative, të cilat janë lidhë me fjalín kryesore me anë të përëmnit origjinár **jo-s*, të ruejtun n'indvj. *yah*, greq. *hos* „i cili", frigj. *ios*, sllav. *i(že)*. Në gjuhën indoev. ka pasë gjithësejt dý partikula koordinative: **q$^{u}$e* „edhè" (ruejtun në lat. *-que*, ven.-ilir. *ke*, greq. *te*, indvj., avest. *ča*); **u̯e* (ruejtun në lat. *ve-*, greq. *(e)-ve*, indvj., avest. *va*). Partikula negative *ne* „jo" (lat. *ne-fas*, *ne-scio*, *n'unquam*, got. *ni*, lit. *ne*, sllav. *ne*) dhe partikula prohibitive **me* „mos" (ruejtun në indvj. *mā*, greq. *mē*, shqip *mò*) janë origj nare. Origjinare janë gjithashtu edhè partikulat *ge* (në singularin e akuzativit të greq. *eme-ge*, ven.-ilir. *me-go*, got. *mi-k* „mue" = gjerm. *mich*; **gho-ghe* në sllavvj. *-go*, *-že*).

Krijimi i ndajfoljeve (prej adverbeve origjinare) dhe prefikseve foljore bân pjesë në periudhën e njij zhvillimi të veçantë të gjuhëvet indoevropjane.

15. Tue krahasue gjuhët indoevropjane mërrijmë të njohim deri-diku edhè fjalorin origjinár nëse këto apo ato fjalë gjinden në të gjitha ose gati në të gjitha gjuhët indoevropjane, si për shëmbull për fjalën „zgjedhë": sllav. *igo* = indvj. *yugám*, greq. *zygón*, lat. *jugum*, got. *juk* = gjerm. *Joch*, korn. *iou*, ose për fjalën „i kuq": indvj. *rudhirá̤h*, greq. *erythrós*, lat. *ruber*, got. *rauþs* (= gjerm. *rot*), ose „i zí": indvj. *kr̥šnaḥ*, sllav. *čĭrnŭ* (= sërb. *cr̂n*), ose „i vjetër": shqip *vjet(ër)*, lat. *vetus*, greq. *vétos*, sllav. *vetŭxŭ*, lit. *vetušas* etj. ose foljet si psh. shqip *mjel*, arm. *malem*, irlvj. *melim*, sllav. *meljǫ*, lat. *molō*, got. *malan*; shqip *pjek*, indvj. *pačati*, sllav. *pekǫ*, lat. *coquo* (prej. indoev. **peq$^{u}$o*) etj. etj.

16. Në bazë të këtij fjalori origjinár, qyshse egziston ideja mbi indoev. zânafillëse âsht sýnue të konstatohet se në çfarë shkalle kulturore ka qenë populli që ka folë me këte gjuhë origjinare

n'atë periudhë të stërlashtë. Kjo âsht detyra e paleontologjís linguistike[1]).

Tue i nda në grupe këto fjalë t'indoev. zânafillëse simbas kuptimit të tyne, paleontologjija linguistike ka mërrijtë të konstatojë se qysh n'indoev. zânafillëse ka egzistue nji grup i madh êmnash për lidhjet familjare dhe fisore në përgjithësí: êmni për babë = **pə₁tḗr* (indvj. *pitā́*, arm. *hair*, greq. *patḗr*, lat. *pater*, got. *fadar*, tokar. *pacar*, irlvj. *athir*), dhe nëse për këte Shqiptarët kanë fjalën *át*, edhè kjo âsht fjalë indoev. zânafillëse si na tregojnë got. *atta*, greq. *atta*, sllav. *ot-ĭcĭ* (sërb. *otac*). Nâna âsht quejtë **mātḗ(r)* (indvj. *mātā́*, arm. *mair*, greq *mḗtēr*, lat. *mater*, gjerm. e mesme e naltë *muoter*, tokar. *macar*, irlvj. *mathir*); fjala bir âsht quejtë **sūnus* (indvj. *sunúḥ*, got. *sunus*, lit. *sūnus*, sllav. *synŭ*, tokar. *se*); kurse fjala bijë âsht quejtë **dhug(h)ə₁tḗr* (indvj. *duhitā́*, greq. *thygátēr*, got. *dauhtar* = gjerm. *Tochter*, lit. *duktḗ*, sllav. **dŭkti* = sërb. *kći*, tokar. *ckacar*). Êmni për vlla ka qenë **bhrā́tḗ(r)* (indvj. *bhrā́tā*, tokar. *pracar*, greq. *phrā́tēr*, lat. *frater*, irlvj. *brathir*, got. *broþar* = gjerm. *Bruder*, sllav. *bratrŭ* (*bratŭ*); kurse për motrën **su̯esōr* (lat. *soror*, got. *swistar* = gjerm. *Schwester*, prusvj. *swestro*, lit. *sesuõ*, sllav. *sestra*). Vjehra âsht quejtë **sue͡krus* (indvj. *svašruḥ*, lat. *socrus*, gjermvj. *swigar*), kurse vjehri **su̯e͡kuros* (greq. *hekyrós*, gjermvj. *swehyr*, shqip *vjehër* < *su̯esuro-* me asimilimin e *-k̑-* ndaj *s*-ës në trajtën indoev. **su̯e͡kuros*); kunati âsht quejtë **daḭu̯ḗ(r)* (indvj. *dḗvā* greq. *dāḗr*, lit. *deveris*, sllav. *děverĭ*, gjermvj. *zeihhur*, arm. *taigr*, lat. *levir*); e veja, vejusha (indvj. *vidhávā*, avest. *viδavā*, korn. *gueden*, lat. *vidua*, got. *widuwô*, prusvj. *widdewū*, sllav. *vĭdova*, shqip *ve*) etj. kështu që me anë të këtyne êmnave mund të njohim themelet e rregullimit familjar në këte periudhë të stërlashtë.

---

[1]) Themelet e kësaj lâme të linguistikës krahasore indoevropjane i vûni Adalbert Kuhn në trajtesën *Zur ältesten Geschichte der indogermanischen Völker* (Osterprogramm des Berlines Realgymnasium, 1845; Jakob Grimm në veprën *Geschichte der deutschen Sprache*, 1848 dhe A. Pictet, *Les origines indo-européennes ou les Aryas primitifs, essai de paléontologie linguistique*, Paris, 1859—1863 (botimi i dytë 1877).

Me kulturën e Indoevropjanëvet merren veprat e O. Schrader, *Sprachvergleichung und Urgeschichte*, botimi i III në Jena 1906—1907; id., *Reallexikon der indogermanischen Altertumskunde*, botimi i II, Berlin 1917—1923; id., *Die Indogermanen*, bot i III, Leipzig 1919; Hirt, *Die Indogermanen. Ihre Verbreitung, ihre Heimat und ihre Kultur*, Strassburg 1905—1907; S. Feist, *Kultur, Ausbreitung und Herkunft der Indogermanen*, Berlin 1913.

Prej kafshëve shtëpijake, Indoevropjanët kanë njoftë êmnin e gjedhve, të cilin e quejshin **gʷōu̯s* (indvj. *gāuḥ*, greq. *boûs*, lat. *bōs*, irlvj. *bo* — krahasò edhè sllav. *gov-ędo*), kurse gjurma e këtij êmni origjinár gjindet edhè në fjalët e përbâme shqipe *ga-lâmsh*[1]) dhe *bâle-gë* (bâlgë) < **bəˌlno-gʷā*[2]). Êmni origjinár i mâzit âsht **pōl-o-s* (greq. *pōlos*, got. *fula* = gjerm. *Fohlen*, — krahasò edhè fjalën shqipe *pelë* prej **pōl-n-ā*); dhija âsht quejtë **aiĝ-* (arm. *aic*, shqip *eth*, greq. *aἶx*, *aigós*), kurse delja **ovis* (indvj. *ávih*, lat. *ovis*, lit. *avís*, sllav. *ovĭca*, gjermvj. *ouwis*; derri **sūs* (shqip *thí*, gjermvj. *su* = gjerm. *Sau*, greq. *hȳs*, përveç *sȳs*, lat. *sūs*, — krahasò edhè derivatin e indvj. *sukaráḥ*; qeni: lat. *canis*, greq. *kýōn*, *kynós*, lit. *šuns*, got. *hunds* = gjerm. *Hund*; kali **ekᷠuos* (indvj. *áśvaḥ*, avest. *aspō*, greq. *hippos*, gal. *epo*), kurse pela (indvj. *ašva*, lit. *ašvá*. Asht origjinár edhè êmni për kafshë (krahasò indvj. *śardhaḥ*, got. *haírda* = gjerm. *Herde*) edhè për bagëtí: indoev. *pe*ḱ*u* (indvj. *páśu*, lat. *pecus*). Prej êmnave tjerë të kafshëve âsht origjinár edhè êmni vidër (indvj. *udráḥ*, avest. *udrō*, greq. *hýdros*, lit. *udrá*, sllav. *vydra*, gjermvj. *ottar* = gjerm. *Otter*), edhè i lepurit (indvj. *śaśaḥ*, gjermvj. *haso*, prusvj. *sasnis*). Prej êmnave të bishave: u(j)ku **u̯l̥qʷos* (indvj. *vrkaḥ*, shqip *ulk*, sllav. *vĭlkŭ* = sllavvj. *vlŭkŭ* = sërb. *vûk*, lit. *vil̃kas*) etj. etj.

Asht fakt i pamohueshëm se në shum raste nuk âsht e mundshme me vërtetue me sigurí nëse kjo apo ajo fjalë âsht me prejardhje origjinare ose jo, përmâtepër kur kjo fjalë nuk njihet në ndonjânën prej gjuhëve indoevropjane, sepsè në këte rast mbetet çeshtja e hapun: nëse edhè ato gjuhë e kanë pasë këte fjalë dhe, përgjatë shekujve, e kanë humbë, ose ajo nuk ka qenë e shtrîme në të tânë fushën gjuhore t'indoev. zânafillëse. Për shkak rastesh të këtilla, kur fjalë të përgjithëshme indoevropjane nuk ka, (si psh. êmnat për krypë: lat. *sal*, greq. *hâls*, sllavvj. *soli*, arm *aṙ*, tokar. *sāle*, që në gjuhët arjane nuk gjindet, nuk mund të përfundohet se Indoevropjanët në periudhën e gjuhës zânafillëse këte send nuk e kanë pasë. Në këte mënyrë mund të mërrihet n'absurditet. Tue ndjekë këte rrugë, do të duhej psh. me përfundue se Indoevropjanët nuk kanë dijtë se shka âsht tâm(b)li, sepsè êmën të përgjithshëm indoevropjan për tâm(b)lin nuk kemi; madjè edhè êmni i babës

[1]) H. Barić, *Arhiv za arban. star.* II (1925) 80—81.

[2]) Id., *Južnoslov. Filolog* II, (1923) 297 e vazhdim.

**pə₁tḗr* ose trajta *senti, sonti* „ata janë" nën këte aspekt nuk do të merrej si e gjuhës zânafillëse indoevropjane, sepsè, e para prej këtyne dy fjalëvet nuk gjindet as në gjuhët baltike, as në sllavishten, as në shqipen, kurse e dyta nuk âsht e ruejtun në gjuhët baltike.

17. Kur âsht vërtetue egzistimi indoevropeishtes zânafillëse vetëvetiu paraqitet pyetja: ku âsht folë kjo gjuhë ose, me fjalë tjera, ku duhet kërkue atdheu i stërlashtë i gjuhës indoevropjane. Zona mâ e lashtë që mund të përcaktohet si vënd në të cilin, në periudhën parahistorike, kanë banue Indoevropjanët, përfshîn nji brez, herë mâ të gjanë, herë mâ të ngushtë, prej Rajnës, nëpër gjith Evropën e Mesme dhe nëpër stepat e Kargís deri në Hindokush dhe Iran[1]). Me këte konstatim skeptik pajtohen, kryesisht, shumica e linguistavet dhe parahistor anëvet, të cilët në këto dhetëvjetët e fundit kanë shqyrtue çeshtjet e atdheut zânafillës t'Indoevropjanëvet, por me këte nuk do me thânë se kjo çeshtje âsht zgjidhë. Në kohën e ré atdheu zânafillës i gjuhëve indoevropjane âsht kërkue n'Evropë, sepsè s ka dyshim se Indët janë ngulë n'Indí në periudhën historike, pak a shum në milenjumin e dytë para erës sonë,[2]) por orvatjet që kỳ atdhé evropjan të përcaktohet mâ përafërsisht shkojnë në rrugë të ndryshme. Schrader[3]) si edhè Rozwadowski[4]) e kërkojnë në stepën e Rusís së Jugut, në bregun veriuer dhe veriprendimuer të Detit të Zí, kurse Hoops dhe Much në Gjermanín veriore[5]), ndërsa G. Kossina âsht i mêndimit se atdheu zânafillëse i Indoevropjanëvet ka përfshî, përveç Gjermanís Veriore, Danimarkën edhè Skandinavín Jugore[6]). Me këte hipotezë të fundit përputhet vështirë fakti se në indoev. zânafillëse ka egzistue êmni i breshkës — (krahasò greq. *khélys* = sllavvj. *želũvĭ*), nëse âsht e saktë se breshka nuk njihet

---

[1]) P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, Göttingen 1896, 60.

[2]) Krahasò P. Kretschmer, *Glotta* XXX, 221.

[3]) *Reallexikon der indogermanischen Altertumskunde* 575 *etj.*

[4]) *Eos* XVII, 1911, 188; krahasò edhè *Rocznik Staw.* VI, 1913, 39 etj.

[5]) Hoops, *Waldbäume und Kulturpflanzen im germanischen Altertum*, 126; M. Much, *Die Heimat des Indogermanen in Lichte der urgeschichtlichen Forschung*, Berlin 1904.

[6]) G. Kossina, *Die indogermanische Frage archeologisch beantwortet*: *Zeitschrift für Ethnologie* XXXIV, 1902, 161 e vazhdim.

në Shlezvig-Holshtajn, Norvegjí dhe në Suedí. Në periudhën mâ të ré, mbassi në fillim të këtij shekulli u zbulue gjuha tokarishte, âsht përtrî përsëri teorija se Azija âsht atdheu origjinár i Indoevropjanëvet, sadoqë kỳ zbulim nuk na e imponon këte ndryshim pikëpamjesh. Përmâtepër, ka arsyena mâ bindëse që flasin në favor të tezës se atdheu i lashtë i gjuhës tokarishte ka qenë n'Evropë. Emni i peshkut në tokarishten âsht *laks*, dhe kỳ sigurisht âsht mâ i lashtë se êmni specifik gjerman *laks*, lit. *lašiša* dhe rus. *losos*. Meqenëse *losos* gjindet vetëm në lumej të cilët derdhen në detnat e veriut, Pokorny do të ketë të drejtë kur, për këte, nxjerr përfundimin se Tokarasit janë shpërngulë nga Evropa Qendrore n'Azí[1]). Për atdheun mâ të lashtë evropjan të gjuhës tokarishte bân fjalë edhè êmni finlandez (dial. çeremik) i plepit *oško* (indoev. **oško* > shqip *ah*) për shkak të *k*-ës prej indoevropeishtes $\hat{k}$[2]). Për çeshtjen e pazgjidhun se cili âsht atdheu mâ i lashtë i indoevropeishtes zânafillëse âsht me rândësí êmni i pijes dehëse **meahu* (indvj. *madhu*, lit. *medus*, greq. *méthy*, gjermvj. *metu*, irvj. *mid*, i cili egziston në të gjitha dialektet ugrofine në trajtën që nuk mund të jetë e huamarrun prej ndonjij gjuhe indoevropjane. Meqenëse kjo pije âsht e bâme prej mjaltit, âsht e qartë se atdheu indoevropjan duhet të ketë qenë në zonën ku jetojnë bletët, dhe meqenëse as në Turkestanin Prendimuer as në lindje t'Uralit nuk ka bletë, kjo zonë nuk mund të merret si lokalizim i atdheut origjinár t'Indoevropjanëve.

Orvatjet që atdheu origjinár të përcaktohet mâ përafërsisht në bazë të gjeografís bimore nuk japin rezultate të sigurta. Nën hipotezën se êmni i ahut âsht indoev. zânafillës, âsht konsiderue se atdheu origjinár indoev. duhej të shtrihej në prendim të zonës ku rritet ahu, zonë e cila shkon prej Königsberg-ut deri në Det të Zí, gjâ që nuk âsht e sigurtë, sepsè êmni iranisht (kurdisht) *buz*, si quhet „vidhi" e jo „ahu" nuk ka lidhje me lat. *fāgus*, got. *bôk*, por âsht trajtë dialektore (me *b* prej *v* dhe analogjikisht *u* prej *i*) që nuk mund të ndahet prej sllav. *vęzĭ* = shqip *vidh*[3]). I vetmi êmën indoev. zânafillës për drûnin âsht êmni i mushtekës (indvj. *phurja-h*, oset. *barz*, sllav. *brěza* [prej

---

[1]) J. Pokorny, *Die Stellung des Tocharischen*: *Berichte des Forschungsinstituts für Osten und Orient in Wien* (1923) IX, 17 e vazhdim.

[2]) Barić, *Arhiv* III (1926) 215 e vazhdim.

[3]) Chr. Bartholomae, *Zur Buchenfrage*: Sitzungsberichte der Heidelberger Akademie der Wissenschaften, Phil.-hist. Klasse, Jahrgang 1921.

trajtës origjinare sllave **berzā*], lit. *béržas*, gjermvj. *bircha*, (gjerm. *Birke*), por zona gjeografike e mushtekës nuk âsht karakteristike.

18. Vetëvetiu shtrohet pyetja — nëse kjo gjuhë indoevropjane âsht në lidhje me ndonji grup tjetër gjuhësuer. Qysh në kohën kur Hrozný (*Die Sprache der Hettiter*, 1917) pàt vû në dukje karakteristikat indoevropjane të gjuhës hetite, ndryshimet midis hetitishtes dhe indoevropeishtes zânafillëse (të rikonstruktueme) janë shpjegue me hipotezën se hetitishtja nuk âsht gjuhë indoevropjane, ashtu si âsht indishtja e vjetër, greqishtja, latinishtja etj. porse rrjedh prej njij bashkësije linguistike mâ të lashtë, prej së cilës, nga nji anë ka rrjedhë hetitishtja kurse, nga ana tjetër, gjuha indoevropjane. Kjo teorí, të cilën i pari e ka shtrue Forrer-i, dhe të cilën sidomos e ka përpunue shkolla amerikane në krye me Stutervant-in — autorin e gramatikës së parë krahasore të gjuhës hetite — mund të konsideronet e hedhun poshtë mbas veprës monumentale të Pedersen-it *Hittitisch und die anderen indogermanischen Sprachen*, Kopenhagen 1938. Meqenëse, megjithëkëte, nuk âsht e mundun me hjedhë poshtë idén se gjuha indoevropjane në fillim të zhvillimit të saj ka qenë nji dialekt i njifarë gjuhe origjinare, prej dialekteve të tjera të së cilës janë zhvillue gjuhët tjera joindoevropjane, në shkencë, para do kohe, janë çfaqë dý teorí: njâna, simbas së cilës gjuha paraindoevropjane ka qenë e afërme me gjuhët semite[1]), dhe tjetra, simbas së cilës ajo do të ketë qenë e afërme me grupin ugrofin. Në favor të kësaj teorije të fundit flasin disa përkime të qarta (mbrapashtesa e akuzativit *-m*, e ablativit *-d*, e përbashktë me elativin finlandez dhe përdorimi i dualit[2]). Si duket, megjithate, Hirt-i ka të drejtë kur thotë se për këte problem mund të merret nji gjykim i sigurtë vetëm atëherë kur të kemi gramatikën ugrofine dhe kur të zhytemi mâ thellë n'analizën e fleksjonit indoevropjan. Në konët e fundit âsht mâ pak i rezervuem në këte pikëpamje H. Pedersen-i, i cili mëndon se âsht mëndjelehtësí me mohue afinitetin gjuhësuer indoevropjan dhe ugrofinas[3]).

---

[1]) Krahasò H. Möller, *Semitisch und Indogermanisch*, Göttingen 1907; id., *Vergleichendes indogermanisch-semitischen Wörterbuch*, Göttingen 1910.

[2]) R. Gauthiot, *Festschrift V. Thomsen zur Vollendung des siebzigsten Lebensjahres dargeb acht*, Leipzig (1921) 128 e vazhdim.

[3]) *Sprogvidenskaben i det nittende aarhundrede* (1924) 309 e vazhdim.

Pikëpamjen ugrofine e përkrahin edhè K. B. Wicklund[1]), H. Paasonen[2]) dhe H. Sköld[3]).

19. Si në çdo gjuhë, edhè n'indoevropeishten zânafillëse me kohë janë çfaqë ndryshimet dialektore. Midis karakteristikavet mâ të lashta dialektore numrohet me plot të drejtë njâjtësimi i pallatalevet origjinare dhe i velarevet të thjeshta që janë krye në nji pjesë të teritorit të stërlashtë, kurse në nji pjesë tjetër pallatalet kanë mbetë të ndame prej velarevet të thjeshta, kështu që në këte zonë nëpërmjet t'afrikatevet kanë kalue në sibilante (shih § 4). Në këte zonë të mâ voneshme, t'ashtuquejtun zonë lindore, u çfaq në zânafillje nji inovacjon tjetër, — modifikimi i *s*-ës origjinare mbas vokaleve *i, u* dhe mbas konsonanteve *r, k,* por kjo çfaqje nuk u shtrî në të gjithë këte zonë, por n'ate pjesë të ngushtë të saj prej së cilës mâ vonë u zhvilluen gjuhët arjane dhe baltiko-sllave. Mirëpo, kalimi i *s*-ës në *ś* (*sh*) mbas *k*-ës çfaqet edhè në gjuhët tjera jashtë këtyne grupeve. Kështu në gjuhën armene, ku *sh*-ja në *veš-tasa* „gjashtëdhetë" përkundruell *vec* „gjashtë" = lat. *sex*, na tregon se zâvendësimi i *ks* indoevropeishte, n'armenisht âsht *sh*[4]). E njâjta çfaqje âsht edhè në gjuhën shqipe, ku shêmbujt si *pishë* prej indoev. **pikso* ose shqip *teshë*, indvj. *taštı* „preu", greq. *téktōn* „teslicë, sqepar, teskë"; shqip *tesh* (indoev. **ţleks*: greq. *lákhnē*) tregon se, edhè në këte gjuhë, *s*-ja mbas guturaleve ka kalue në *sh*[5]) si edhè në sllavishten ku shêmbujt si *rĕxŭ* (prezent *rekǫ*) na përkujtojnë trajtën e stërlashtë indoevropjane **rēk-som*, pra nëpërmjet të fazës **rēk-šom* ka rrjedhë trajta historike *rĕxŭ*. Në lidhje me këte âsht me rândësí me përmendë se në greqishten për *ks* të indoevropeishtes në disa shêmbuj çfaqet *kt* (greq. *téktōn*: indvj. *takşa*) në vênd të *ks*. Për shpjegimin e kësaj dyllojshmënije greke supozohet se përveç *s*-ës në gjuhën origjinare ka egzistue edhè nji *s* tjetër, etimologjikisht ndryshe prej kësaj, e cila në gjuhët tjera âsht njâjtësue me *s*.

---

[1]) *Finnisch-ugrisch und Indogermanisch* në „*Le Monde oriental*" I.

[2]) *Zur Frage nach der Urverwandschaft der finnisch-ugrischen und indoeuropäischen Sprachen*: *Finnisch-ugrische Forschungen* VII.

[3]) *Finnisch-ugrische Forschungen* XVIII (1927) 216 e vazhdim.

[4]) Krahasò A. Meillet, *Les dialectes indoevrop.* 86.

[5]) Krahasò H. Barić: *Indoevropski palatali*: *Glas Srp. akad.* 1926 6 e vazhdim.

Asht sidomos me rândësí se *t*-ja greke i përgjigjet *t* së keltishtes (greq. *árktos* „arí": irlandisht *art*, gal. *Deae Artiari*), ku çfaqet dubleti *s/t* mbas *k*-ës, si në greqishten — krahasò greq. *tékhnē* (prej. **teks-na)*, përveç *téktōn* dhe irlandisht *tail* „sëpata", prej indoev. **toks-to.* Sidoqoftë âsht karakteristike se kỳ tingull, i cili simbas disave âsht *š*, kurse simbas disa tjerëvet *þ* çfaqet vetëm mbas *k*-ës në të gjithë fushën e dialektevet *satəme.*

20. Pra, âsht çeshtje me rândësí nëse para diferencimit të pallatalevet indoevropjane në zonën parahistorike ka pasë, edhè inovacjone tjera mâ të vjetra të shtrîme në të tjera zona për të cilat në nji fazë mâ të herëshme dialektore të niansueme t'indoev. zânafillëse do të mund t'imagjinohej nji grupim tjetër i dialektevet indoevropjane. H. Pedersen-i përpara anonte kah mêndimi se përgjigja për këte çeshtje duhet të jetë vetëm pozitive, nëse kemi parasỳsh shtrîmjen gjeografike të *-r*-ës medjopasive. Meqenëse kjo karakteristikë gjindet jo vetëm në hetitishten, tokarishten, ilirishten, në gjuhën italike dhe keltishten, pra, në gjuhët e grupit *centum*, por edhè në frigjishten (krahasò *beretor* përveç *bereto*) — gjuhë e cila me të drejtë numrohet në grupin e *satəm* — arsye për të cilën mêndonte Pedersen-i se përpara ndamjes në *satəm-centum* ka egzistue grupimi në dý zona, njâna me *-r*, dhe tjetra pà *-r*, ndamje të cilën në nji fazë mâ të vonëshme zhvillimi t'indoev. zânafillëse e ka pré isofona e reflekseve dyfishe të pallataleve indoevropjane[1]). Në kohët e fundit, Pedersen-i âsht orvatë të provojë se frigishtja âsht gjuhë e grupit *centum*[2]) dhe, përputhmënisht me këte, ka shpallë *-r*-ën medjopasive si nji shêj karakteristik vetëm për gjuhët *centume*, tue mos pasë parasỳsh se me fjalën *beretor* të frigjishtes përputhet plotësisht trajta e vehtes së tretë t'imperfektit singular t'armenishtes *berēr*[3]) dhe ka lânë në harresë faktin se në indoiranishten, e cila, si edhè armenishtja, padyshim, âsht nji gjuhë *satəme*, mbarapshtesa *-ur* n'indvj. *gamyur* „lë të vijnë" na udhëzon

---

[1]) Holger Pedersen, *Le groupement des dial. ievr.* (Det Kgl. Danske Videnskabernes Selskab. Hist.-filol. Medeleser XI/3) Kopenhagen 1925. Duket se kështu mêndon edhè Odè, *De vitkangen met -r* (1925).

[2]) *Hittitisch und die anderen indogermanischen Sprachen*, Kopenhagen 1938.

[3]) A. Meillet, *Bulletin de la Societé linguistique de Paris* XXIV, 194; H. Barić, *Arhiv za arban. star.* III (1926), 285 e vazhdim.

në *-ṛ*, poashtu si edhè *-ṛš* e iranishtes së stërlashtë (gavest. *čikoiter*$^{a}$*š* „nuk janë të qetë“ në *-rs* = indvj. *urṣ* prej **$^{o}$rš* në *cikitur*[1]) dhe, ndoshta edhè në sllav. *beretŭ*: lat. *-ur* (*fertur*)[2]).

Pra, për arsye të çfaqjes së *-r*-ës medjopasive në nji zonë kaq të shtrîme të gjuhëvet *centume* dhe *satəme* do të jetë fort e besueshme se zgjedhimi në *-r*, sadoqë ai ka shkue në rrugë të ndryshme — në fillim ka qenë i përbashktë për të gjithë fushën gjuhësore indoevropjane, mandèj, âsht shtye nga inovacjonet, si psh. me refleksivin me *sę* në gjuhët sllave. Se *-r*-ja medjopasive âsht ruejtë mâsëmiri në hetitishten, tokarishten, gjuhën italike dhe keltishten shpjegohet me anë të pozitës së mâvonëshme periferike të këtyne gjuhëve, për të cilat, me plot të drejtë, thuhet se kanë ruejtë nji varg karakteristikash origjinare, të humbuna në qendrën e zonës gjuhësore të dikurshme indoevropjane. Prandèj isofona *centum-satəm* mbetet nji karakteristikë me shum rândësí në lidhje me grupimin mâ të lashtë të dialektevet indoevropjane.

21. Natyrisht, kjo nuk don me thânë se midis bashkësís gjuhësore t'indoevropeishtes zânafillëse dhe formimit të gjuhëve të ndryshme indoevropjane duhet supozue se kanë egzistue dý dialekte indoevropjane të formueme: njâni *satəm* dhe tjetri *centum* prej të cilavet, përgjatë shekujve, janë nda gjuhët historike indoevropjane, sepsè egziston nji varg i tânë përkimesh tepër të rândsishme midis kësaj apo asaj gjuhe në të dyja këto grupe të mëdha. Kështu ndodh psh. në ndryshimin e ndërtimit të disa rasave që flllojnë me *-bh* në njânën dhe me *-m* në tjetrën zonë t'indoevropeishtes zânafillëse të cilat nuk përputhen me kufít e *centum-satəm*: krahasò sllav. *gostinŭ*, got. *gastim*, sllavvj. *vŭlkomŭ*, lit. *vil̃kamus* „uqve“ përkundruell lat. *hostibus* „anmiqve“, irvj. *féraib* „njerëzve“, por sllav. *desętĭ* përkundruell got. *taihun* (indoev. **dėkṃ*). Kjo vlen edhè në lidhje me refleksin e dyllojshëm të *i̯s* indoev. që âsht nji çfaqje greke (krahasò greq. *hos* prej indoev. **i̯os* përkundruell *dzygón* „zgjedhë“: indvj. *yugám*, got. *juk* = gjerm. *Joch*) si dhe shqip (krahasò *ju* = got. *jus*, përkundruell *(n)gjesh*: greq. *dzéō* = indoev. **i̯ēs*) edhè armenisht

[1]) J. Charpentier, *Die verbalen r- Endungen in den idg. Sprachen* [*Skrifter utg. af k. Hum. Vetenskapsamfudet*, Uppsala 18/4, 21 e vazhdim.

[2]) H. Barić, *Beiträge zur slavischen Sprachgeschichte*, Wien und Leipzig (1918) 57 e vazhdim; T. Milewski, Prace lingv. 1931.

(arm. *asem* „them“ : indvj. *yašas* prej indoev. **jaḱ*, përkundruell *ǰur* „uji“ : lit. *júres* „deti“).

Tue u kryqzue të këtilla elemente të shumta dialektore të gjuhës origjinare, që janë përhapë nga pika e tyne nisëse, herë në nji zonë mâ të gjânë, herë mâ të ngushtë, përgjatë shekujvet, âsht krijue nji numër i madh sektorësh të vegjël, madje edhè shum të vegjël, prej të cilëvet çdonjâni paraqet njifarë dialekti të stërlashtë. Dhe kur këto pjesë të zonës indoevropjane, të lidhuna dikur gjeografikisht, kanë fillue të ndahen njâna nga tjetra prej dyndjesh dhe depërtimesh së popujve të huej që kanë folë tjetër gjuhë, diferencimi midis tyne, në zhvillimin e vet të mâtejshëm, të ndamë, âsht bâ aq mâ i madh sa mâ pak ka vazhdue fqinjësija e dialektevet të stërlashta, dikur t'afërta, ose sa mâ tepër ka humbë midis tyne — qoftë me anë mërgimi, qoftë me anë depërtimi të huej — sektori indirekt, hallka në zinxhirin e këtyne dialekteve të stërlashta të gjuhës origjinare.

Prej njij sektori të këtillë indoevropjan âsht zhvillue dialekti zânafillës shqiptar, por — si duket nga të gjitha rrethanat (shih kapitinën e III-të) — jo në mënyrë direkte. Midis epokës s'indoev. dhe epokës së të pamvarunës jetesë së zhvillimit të gjuhës shqipe, duhet të ketë egzistue nji epokë në të cilën âsht zhvillue nji nga dialektet parahistorike, prej të cilit, në periudhën historike, kanë mbetë dy sektorë ekstremë: shqipja dhe armenishtja, ndërsa sektorët indirektë, thrakishtja (mâ e afërt shqipes) dhe frigjishtja (mâ e afërt armenishtes) janë zhdukë.

## III.

## POZITA E GJUHËS SHQIPE NË RRETHIN E GJUHËVE T'AFËRTA

22. Sadoqë as në burimet historike as në traditën në lidhje me prejardhjen ilire të Shqiptarëvet nuk bâhet kurrkund fjalë, në historiografí dhe n'etnologjí, madjè edhè te disa linguista — të cilët studimin e gjuhës shqipe e kanë pasë në periferín e interesimit të tyne shkencuer — egziston pak-a-shum nji mêndim i caktuem: Shqiptarët janë mbasardhësit e Ilirëve antikë, dhe se gjuha e tyne âsht nji fazë e ré e gjuhës ilirjane. Në të vërtetë, kjo âsht vetëm nji hamêndje historike, e mbështetun n'êmnin e vjetër nacjonal të Shqiptarëve të sotshëm (Arbën, Arbër)[1]) dhe në faktin se ata, në periudhën historike, gjinden në nji pjesë të teritorit të gjânë të dikurshëm ilirjan. Në nji regjistër anzhuvin të vjetit 1330, në krye të 13 fiseve shqiptare, përmenden *Albi-t*, kurse simbas Ptolome-ut (III 2, 12) dijmë se *Albanoï-t*, në shekullin e dytë t'erës sonë, kanë jetue në krahinën rreh *Albanópolis-it*, mâ vonë të quejtun Kruja, ku banorët e sotshëm quhen *Arbër*, poashtu sikundër edhè Shqiptarët n'Italín e Jugut, të cilët kanë emigrue atje në shekullin XV-të. Kontinuiteti i këtij êmni të vjetër nacjonal, ruejtun edhè ndër emigrantët gegë të Krajës së Malit të Zí në katundin *Arbnesh* të Zarës, në Dalmací, t'ardhun këtu në shekullin XVIII-të do të flitte në favor të teorís së kontinuitetit të popullit shqiptár në trollin ilirjan. Kŷ kombinacjon historik — të cilin i pari e ka formulue historjani gjerman Joh. Thunmann, *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, Leipzig 1774 — ka zânë rrânjë atŷ kah vjeti 1880 edhè në linguistikën historike qyshse âsht vërtetue se në

---

[1]) *Arbnesh, Arbresh* âsht edhè sot e kësaj dite në vetë Shqipnín (Fier, Elbasan, Kurbî, Kthjellë), krahasò N. Ressuli, *Raporti kronologjik i trajtavet Arbnesh-Shqiptar*: Leka VIII (1936) 38—40.

gjuhën shqipe âsht ruejtë ndonji fjalë prej atij numri të paktë fjalësh të cilat, simbas dishmís së shkrimtarëve antikë, janë ilire.

23. Nji identifikim i këtillë i Shqiptarëve dhe i Ilirëve nuk ka fuqí argumentuese të mbrendshme për shkak të vetë natyrës së mjetevet argumentuese. Nëse Shqiptarët, në periudhën historike, kanë banue në nji pjesë të teritorit të dikurshëm etniko-gjuhësuer ilirjan, kỳ fakt nuk ka rândësí vêndimtare për origjinën e tyne ilirjane, sepsè ata, si t'ardhun, kanë mujtë me i vërshue dhe asimilue vêndasit e vjetër në këte krahinë dhe, që për këte, historija të mos ketë asnji shêj të ruejtun, sikundër as mbi shum migracjone tjera në Gadishullin Ballkanik, qofshin të vjetra, qofshin të reja. As kontinuiteti i êmnit të vjetër ilir *Albanoí* n'êmnin e *Arbërëve* të sotshëm nuk ka ndonji domethânje mâ të madhe, sepsè të parët e tyne kanë mujtë me e trashigue këte êmën prej banorëve të vjetër ilirjanë n'atdheun e tyne të rí poashtu sikur, simbas rezultateve të shkencës bashkëkohore, edhè Albanoí-t ilirjanë këte êmën e kanë trashigue prej popullsís së lashtë joindoevropjane, dmth. prej popullsís mediterane, për të cilën gjâ dëshmojnë toponimet e shumta, të nxjerruna prej fjalës mediterane *alb-* „kodër, vênd i ngritun" në të gjithë zonën e shtrîme prej Kaukazit deri në Ligurí dhe në Gadishullin Iberik[1]). Nga ana tjetër, edhè argumentet linguistike, dmth. fakti se në gjuhën shqipe ka fjalë ilirjane humbin mjaft fuqín e vet argumentuese jo vetëm sepsè këto fjalë mund të jenë relikte ilirjane si psh. fjalët e keltishtes në frengjishten, por edhè për shkak sepsè, si âsht vërtetue qysh me kohë, në gjuhën shqipe ka të paktën aq, nëse jo edhè mâ tepër, elemente leksike të cilat, simbas dëshmive së shkrimtarëve antikë, janë të thrakishtes[2]).

Në ndeshjen e hipotezave mbi karakterin ilirjan apo thrakas të gjuhës shqipe, që për këte të fundit qysh atỳ nga mbarimi i shekullit të kaluem kanë ngulë kâmbë C. Pauli[3]) dhe H. Hirt-i[4]), nji qëndrim ndërmjetës ka marrë N. Jokl-i, simbas të cilit karakteri

---

[1]) Krahasò V. Bertoldi, *Problemi di etimologia*: *Zeitschrift für romanische Philologie* LVI (1936), 178—188.

[2]) N. Jokl, *Reallexikon der Vorgeschichte* i Ebert-it I s.v. Albaner.

[3]) C. Pauli, *Altitalische Forschungen* III. *Die Veneter* 233 e vazhdim.

[4]) H. Hirt, *Beiträge zur alten Geschichte und Geographie*: *Festschrift für H. Kiepert*, Berlin 1898.

„iliro-thrakas" i gjuhës shqipe shpjegohet me faktin se karakteristikat gjuhësore ilirjane përputhen me karakteristikat e njâjta të gjuhës thrakishte[1]).

24. Në qendrën e kësaj çeshtjeje, endè të hapun, ndodhen reflekset e pallataleve indoevropjane të shqipes, thrakishtes dhe ilirishtes. Gjuha shqipe âsht, padyshim, gjuhë e grupit *satəm*, në të cilin pallatalet indoevropjane janë të zâvêndsueme me sibilante (shih § 4) — krahasò *sorrë*: lat. *cornix*; *zorrë*: lit. *žarna*, gjerm. *Garn* „pê". Si shqipja, ashtu edhè thrakishtja, padyshim, âsht gjuhë e grupit *satəm*, si na tregon glosa e thrakishtes *dzálmos* „lëkura e ariut" me *dz* prej indoev. *ĝh* e cila përputhet kryekput me fjalën greke *khlamýs* (prej trajtës origjinare indoev. **ĝhl-m*); nji shêmbull tjetër gjithashtu krejt i sigurtë âsht *aspo* „kal" n'êmnin e përbâmë të thrakishtes *Out-áspios*: indvj. *ašvah* „kal" prej indoev. **ekuo-*. Në kundërshtim me këte, pallataleve indoev. *k*, *ĝh* n'ilirishten u gjigjen velaret — krahasò psh. êmnat vetorë t'ilirishtes *Acra-banus* dhe *Bal-acros*, në të cilët *k*-ja velare zâvêndëson *k̂*-ën indoev. pallatale poashtu si në fjalën greke *ákros* „i thepisun, me maje" dhe në lat. *acer* (lexò *aker*!) „i mpreftë" në kundërshtim me fjalën e indishtes së vjetër *ašri h* „tehu" (prej **akris*), lit. *ašrùs*, sllav. *ostrŭ* „i mpreftë" dhe êmni i lumit ilirjan *Angros*, nxjerr me anë të *-ro* prej indoev. **aŋĝho* „i ngushtë", në të cilin velari zâvêndëson pallatalin indoevropjan *ĝh* poashtu si në lat. *ango* „me ndrydhë; me shtërngue" përkundruell sibilantit *z* në gjuhët *satəme* (krahasò psh. sllav. *ǫzŭkŭ* = sërb. *uzak*, avest. *azo* „ngushticë; mjerim".

Në bazë të këtyne reflekseve ilirjane të pallataleve indoevropjane, numri i të cilave, megjithë mungesën ekstreme të burimeve gjuhësore ilirjane, âsht shum i madh[2]), gjuha ilirjane duhet të futet në grupin *centum*, ku bâjnë pjesë edhè gjuha italike, keltishtja, greqishtja, gjuha e lashtë e përgjithëshme gjermanike, tokarishtja dhe hetitishtja, prandèj gjuha shqipe, si nji gjuhë *satəme* nuk mund të jetë në lidhje gjenetike me gjuhën ilirjane si nji fazë e ré e saj.

[1]) *Reallexikon der Vorgeschichte* I, 24 e vazhdim.

[2]) Për karakterin *centum* të gjuhës ilirjane krahasò H. Krahe, *Pannonia* 1937, 16 e vazhdim; id., *Das Venetische. Seine Stellung im Kreise der verwandten Sprachen*: Sitzungsberichte der Heidelberger Akademie der Wissenschaften, Jahrgang 1950, 3. Abh. dhe H. Barić, *Ilirske jezičke studije. Rad Jugoslavenske Akademije* 272 knj., 7—15.

25. Për caktimin e lidhjevet të ngushta n'afinitetin midis gjuhës shqipe dhe gjuhëve tjera *satəme* ka nji rândësí vêndimtare zâvêndësimi i guturaleve indoev. jopallatale, dmth. i velareve të thjeshta (*k, g, gh*) dhe i labjovelareve (*q$^u$, g$^u$, g$^u$h*). Sikundër ka provue Holger Pedersen-i në studimin e tij fundamental mbi guturalet në gjuhën shqipe, me ndryshim prej gjuhëve tjera *satəme*, ku labjovelaret indoev. kanë humbë elementin e tyne labjal dhe kështu janë njâjtësue me velaret e para të thjeshta (krahasò sllav. *pekǫ* „pjek" prej indoev. **peq$^u$-*, sllav. *krŭvĭ* „gjaku": greq. *kréas* „mishi"), reflekset e guturalevet indoev. jopallatale në shqipen kanë mbetë nën disa kushte të shkëputuna sepsè labjovelaret (*q$^u$, g$^u$h*) para vokalevet indoev. *e, i* janë pallatalizue dhe nëpërmjet të pallatalizimit janë zâvêndsue me postdentalet *s, z* ndryshe prej velarevet të cilat, edhè në këte pozitë, kanë mbetë të pandryshueme (krahasò shqip *sȳ* prej indoev. **oq$^u$e* përkundruell fjalës shqipe *kohë* prej indoev. **kēsā*: sllav. *časŭ* prej indoev. *kēso*[1]). Në këte të ndamë refleksesh të rradhëve jopallatale indoev., gjuha shqipe nuk âsht e vetmueme, por lidhet me grupin thrako-frigjiko-armen të gjuhëve *satəme*. Kështu n'armenishten labjovelaret indoev. nuk pallatalizohen para vokalevet pallatale (krahasò arm. *kin* „grueja": indoev. **g$^u$enā*), kurse pallatalizimi âsht bâ nëse para *e*-s dhe *i*-s kanë qëndrue velaret e thjeshta indoev. (krahasò *čim* „frêni": greq. *gémos*). Por, përkueshmënija midis reflekseve të thrakishtes dhe reflekseve të shqipes në rradhët e jopallatalevet indoev. nuk shihet vetëm në të ndamit e tyne, por edhè n'identitetin e refleksevet të velareve dhe labjovelareve indoev. Në glosën e thrakishtes *árgilos* „mini" âsht ruejtë velari para *i*-s, (krahasò greq. *órkhilos* prej rrânjës **orgh-*), ndërsa labjovelaret në këte pozitë janë pallatalizue njilloj si në gjuhën shqipe, krahasò fjalën e thrak. *dzerm-* „i ngrohtë" n'êmnin e banjës së ngrohtë *Dzermi-zirga* në Dakí: indoev. **g$^u$hermos* = shqip. *zjerm, zjarm*. Prandèj, të ndamit e të trija rradhëve të guturalevet indoev. âsht nji karakteristikë konservative[2])

[1]) *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* XXXVI, 277 e vazhdim.

[2]) Krahasò studimin tim *Guturalni problemi* (*Jermenski refleksi indoevropskih nepalatalnih guturala*): *Zbornik filoloških i lingvističkih studija A. Beliću*, Beograd 1921. — Teorín se n'armenishten janë ruejtë të trija rradhët e guturalevet gjuhore zânafillëse tash e përkrah edhè V. Pisani, *Mélanges Henri Grégoire*, Bruxelles 1950, 525 e vazhdim — teorí me të cilën në detaljet fonetike interne t'armenishtes nuk pajtohem. Krahasò të mijat *Lingvističke studije*, Sarajevo 1954, 38 e vazhdim.

e përbashktë e gjuhëvet shqipe, thrakishte dhe armenishte, që tregon pozitën qendrore të dikurshme të këtij grupi, kurse pallatalizimi i labjovelareve âsht nji nga inovacjonet e përbashkta shqiptaro-thrake, nga të cilat ka mjaft.

26. Në konsonantizëm, nji isoglosë shum e rândësishme thrako-shqiptare âsht asimilimi i *s*-ës në grupet konsonante *s*+*nazal*, *s*+*l*, krahasò shqip *jam*: indvj. *asmi* (indoev. **ésmi*) dhe thrak. *nība* „bora" prej indoev. **snigᵘh-m̥*; shqip *kollë*: sllavvj. *kašlĭ* prej indoev. **koslo*. Isoglosë shqiptaro-armene âsht, me të vërtetë, edhe zâvêndësimi i grupit indoevropjan *rn* të cilit në shqipen i përgjigjet *rr*-ja, (krahasò shqip *barrë*: greq. *phérnē*) sepsè faza ndërmjetse midis *rn* dhe *rr* âsht ruejtë në gjuhën armene, ku *r*-ja para *n*-ës kalon në *r* (khs. *darnam* „këthehem": aoristi *darjay*). Se faza e fundit shqipe *rr* âsht e vonëshme, shihet edhè nga fakti se ajo përfshîn edhè fjalë të huamarruna mâ vonë — krahasò psh. *kërrutë* e cila, sidomos për shkak të *u*-s, nuk mund të rrjedhi prej lat. *cornūta* (krahasò shqip *gjyq* prej lat. *jūdice*), por duhet të jetë me prejardhje rumune; ose fjalën shqipe *prrar*, *përnár* „qàrr" prej fjalës së greqishtes së ré *pournári*; *qeveris* prej fjalës së greqishtes së ré *kyvernō*.

27. Reflekset e grupit indoevropjan *sk̂* dhe *sk* janë gjithashtu nji isoglosë shqiptaro-armene nëse këto grupe në të dý gjuhët kanë mbetë të ndame. Në kundërshtim me teorín e mâparëshme se *h*-ja âsht refleksi i *sk̂*-ës dhe i *sk*-ës indoevropjane në shqipen âsht fare e qartë se *h*-ja çfaqet vetëm si zâvêndësim i *sk̂*-ës indoev. — krahasò psh. *hollë* prej indoev. **skēlo*: indvj. *śala* „hèll"; shqip *hardelë*: greq. *kórdylos* me *h* prej *k̂* indoev. n'indvj. *śardula*, ndërsa *sk*-ja mbetet e pandryshueme, krahasò *bashkë*: irlvj. *bask*; *mushk*: indvj. *muškah*; *shkon*: got. *skewjan*; *shkas*: lat. *scateo*, lit. *su-skote*; *shkop*: lat. *scāpus*[1]). Gjithashtu ndodh edhè n'armenishten, ku *c*-ja âsht zâvêndësim i *sk*-ës indoev. (krahasò *hurcanem* „lutem": lat. *posco* prej *porc-sco* = indoev. **prk̂-sko*), ndërsa *sk*-ja indoevropjane mbetet (krahasò *skund* „këlysh": pamir. (wachi) *skön*, sllavvj. *štenĭci*). Shêmbull të sigurtë për refleksin thrakas të *sk̂*-ës indoevropjane nuk ka (*salía* „lule dhije" të cilën disa e nxjerrin prej indoev. **sk̂ēl-iā* [: gjermvj. *scëlo*] si vërtetim se *s*-ja

[1]) Krahasò veprën time *Albanorumänische Studien* I, 51, 73 e vazhdim dhe 91; *Arhiv za arban. star.* III (1926) 215; IV (1929) 246–266.

e thrakishtes vjen prej *sk̂*-ës indoevropjane, âsht fjalë paraindoevropjane — krahasò ligur. *saliunca* „Valeriana celtica“)[1]), por *sk̂*-ja indoevropjane mbetet e pandryshueme, njisoj si në shqipen — krahasò thrak. *skalmē* „shpata“: nordvj. *skalm*; dak. *skiarē*: shqip *shqer* (rrânja *sker-*).

Asht shum karakteristike, në lidhje me afinitetin e ngushtë shqiptaro-armen se në të dyja gjuhët nuk janë njâjtësue *tenues* dhe *tenues aspiratae* indoevropjane (krahasò shqip *fal* prej indoev. **phalnō*: greq. *sphállō*, arm. *p'ul*; shqip *rreth*: indvj. *rátha̱h*.

28. Asht mâ pak karakteristike çfaqja se në gjuhët shqipe dhe thrakishte futet *t*-ja midis *s*-ës dhe *r*-ës = *str* (shqip plur. *shtërpinj* prej indoev. **sṛpiṇi*: lat. *serpens*; êmni thrakas i lumit *Strymon*: indvj. *srávati* „rrjedh“ (rrânja **sreu̯*), sepsè kjo çfaqje âsht edhè litave (*strovẽ*); sllave (*struja*), e gjuhëvet gjermanike (gjerm. *Strom*), ilire (krahasò êmnat e vêndeve *Strevintia* ose *Stravianae*) dhe pjesërisht edhè çfaqje e keltishtes (kornvj. *stret*). Gjithashtu nuk âsht karakteristike si çfaqje shqiptaro-thrake as asimilimi i *kt*-ës indoev. në *t* (shqip *natë*: lit. *naktis*; êmni thrakas i kështjellës *Authi-paros*: prusvj. *Auti-garbin*) sepsè ajo âsht edhè ilire — krahasò *Nesattium* krahas me *Nésaktos* n'Istër dhe êmnin maqedono-ilir *Atto-lobus* „tetë kodrat“: lat. *octo*, greq. *oktō* „tetë“.

29. Mirëpo, lidhëshmënija e ngushtë midis gjuhës shqipe dhe thrakishte shihet në reflekset e sonantevet indoevropjane. Refleksi identik i shqipes dhe i thrakishtes në sonantet nazale indoev. âsht *a*-ja — krahasò shqip *shtatë* prej indoev. **septṃti*; *gjatë* (prej indoev. **dl̥ngh-to*)[2]), kurse në thrakishten, êmnin e lumit anabregas pranë Bizantit *A-thýras* (prej **ndhu-r*: indvj. *dhávāte* „rrjedh“, ndërtue si në lit. *Ne-vadas*) dhe êmni i kështjellës *Bastera* (prej **bhn̥d-teria*: lit. *bandà*). Nji vênd ndërmjetës midis gjuhës shqipe dhe armene zên, edhè këtu, thrakishtja, ku përveç refleksit *a* të shqipes dhe thrakishtes për *n̥*-ën indoevropjane gjindet edhè refleksi *an* i armeno-thrakishtes, — krahasò glosën e thrakishtes *génton* „mish“ prej trajtës

---

[1]) Krahasò K. Oštir, *Arhiv za arban. star.* II 306; shif edhè shënimin në f. 57 të këtij libri.

[2]) M. Vasmer, *Studien zur albanesischen Wortforschung*, Dorpat 1921, 39 e vazhdim; *e* në *zet* „20“ (prej indoev. **u̯i-kṃt-* âsht kushtëzue me *ī* të fundit).

së vjetër **gánton* me trajtën origjinare indoev. **g$^{u}$hn̥-t*[1]) me *e* prej *a*-s si në thrakishten *-deva* krahas me *-dava*.

Edhè zâvêndësimi i likuidevet sonante t'indoevropeishtes përkon në gjuhët shqipe dhe thrakishte, zâvêndësim i cili edhè këtu hedh urë midis shqipes dhe armenishtes. Zâvêndësimi shqiptaro-thrakas i *r̥*-ës indoevropjane âsht *ri*, krahasò shqip *krimb:* indvj. *kr̥mi-h* dhe êmnin thrakas të popullit *Trib-all-oi*: got. *þaurp* (prej **tr̥b-*). Përveç *ri* në gjuhën shqipe çfaqet edhè *ur*, krahasò *burmë* prej indoev. **bhr̥mo-*, kurse refleksi *ur* për *r* âsht konstatue se gjindet edhè në thrakishten, krahasò *Burdipta*: lit. *bredù*, sllav. *bredǫ*. Refleksi armen i *r̥*-ës indoevropjane âsht *ar*, krahasò *arj* „ari": indvj. *r̥kša-h*, kurse gjurmat e këtij zâvêndësimi gjinden edhè në thrakishten, krahasò *Dársioi*: greq. *thārses* „guxim", indvj. *dhr̥ṣnōti* „guxon" = indoev. **dhr̥s-*.

30. Për vokalizmin e shqipes âsht karakteristik pallata izimi i vokalit *ū* > *ü* (*dỳll*: greq. *khȳlos* = indoev. **ghūlo-*); *o* > **ö* > *e* (shqip *né* = indoev. **nōs*); *a* > *e* (*rreth*: gjermvj. *rad*, lat. *rota*), në të cilin pallatalizim shihet qartë lidhëshmënija e ngushtë e gjuhës shqipe me grupin thrako-frigjik. Jà sepsè: s ka dyshim se *ū* do të ketë egzistue edhè në fazat mâ të lashta të gjuhës armene, sepsè përndryshe nuk do të mund të shpjegohej pallatalizimi armen i velareve kur gjindej *u*-ja përpara (arm. *dustr* „bijë": lit. *duktẽ*) ose *w*-ja (arm. *lois* „dritë": lat. *lūceo* „me ndriçue" = indoev. **louk̑o̯ō*) ku faza kalimtare midis *ow* origjinare dhe *oi* t'armenishtes mund t'ishte vetëm *oü* prej nga, me disimilimin e *u*-s labjale në *o* labjale, *i*-ja âsht bâ *oi*. Për *u*-n na flet *ni* e frigishtes: greq. *ny*; frigj. *kímeros* „mëndja": sllav. *kumati*, *kíklen*, „qark": greq. *kýklos*. Se edhè gjuha thrakishte ka pasë tingullin *ü* shihet qartë prej shëmbujve si dak. *sim-peax* „kynoglosson", ku pjesës së parë përbâmëse *sim* (prej *sin* para *p*) i përgjigjet lit. *šun* „qeni".

Në zâvêndësimin e *o*-s indoevropjane gjuha shqipe dhe armenishte shkojnë në drejtime të kundërta. Zâvêndësimi i *o*-s indoevropjane në armenishten âsht *u*, sikundër âsht edhè në frigjishten (krahasò arm. *tur* „dhuratë": greq. *dōron*; frigj. *doumos*: got. *dôms*), ndërsa faza ndërmjetëse midis *o*-s indoevropjane dhe *o*-s shqipe âsht ruejtë në thrakishten, — krahasò thrak. *Loidías* (prej **lōd-* nëpërmjet të

---

[1]) W. Tomaschek, *Die alten Thraker* I, 8.

*lowd/loẅd/loid*) analogjikisht me kalimin e indoev. *ow > oẅ > oi* n'armenishten, si gjindet edhè në thrakishten *Moisoi, Mysoi, Roimetálkēs : Rumitalca* etj.

Krijimi i kësaj dyllojshmënije në zâvêndësimin e *o*-s indoevropjane në thrakishten endè nuk âsht shpjegue, por Oštir-i do të ketë të drejtë kur vên në dukje dyllojshmënín e refleksit *ō* në gjuhën shqipe, ku *ō*-s së theksueme të lat. i përgjigjet *e*-ja, kurse *ō*-s së patheksueme *u*-ja (shqip *pemë* prej lat. *pōmum*, mirëpo *pushoj* prej lat. *pōsāre*), për të cilën arsye dyllojshmënija e refleksevet të thrakishtes do të shpjegohej me dallimin e akcenteve: *oi* prej *ō*-s nën akcentin kryesuer të fjalís, kurse *u* nën akcentin sekondar të fjalís[1]). Sidoqoftë, përsa i përkèt zhvillimit të *ō*-s indoev. gjuha thrakishte zên nji vênd ndërmjetës midis frigjishtes-armenishtes, ku *u*-ja âsht zâvêndësim i *ō*-s indoevropjane, dhe shqipes ku *ō*-s indoevropjane i përgjigjet *e*-ja. Thrakishtja i njef të dyja këto zâvêndësime të kushtëzueme prej akcentesh.

Kjo pozitë ndërmjetëse e gjuhës thrakishte midis shqipes dhe frigjishto armenishtes pasqyrohet edhè në pallatalizimin e *a*-s indoevropjane, kurse në gjuhën frigjishte-armenishte nuk ka gjurma të këtij ndryshimi; *e*-ja për *a* indoevropjane âsht karakteristikë e gjuhëvet shqipe dhe thrakishte, krahasò shqip *helm*: gjermvj. *scalm* „infektim" dhe thrak. *-deva-dava, Nestos : Nastos.*

31. Po kjo vlen edhè përsa i përkèt refleksеve të *o*-s indoevropjane. Ndërsa për *ŏ*-n indoevropjane në thrakishten çfaqet *o*-ja dhe *a*-ja (khs. *Paralisen-sium* krahas me *Porólisson*; *-dama* krahas me *domos*), kurse *u*-ja për *o*-n indoevropjane të pjesës së parë përbâmëse në fjalët e përngjituna (*Aulu-zanus*), i vetmi refleks i *ŏ*-s indoevropjane në frigjishten dhe armenishten âsht *o*-ja[2]).

Në kundërshtim me këte, zâvêndësimi i *ŏ*-s indoevropjane në shqipen âsht *a*, kurse *o*-ja (dmth. *u*-ja) çfaqet vetëm nën akcentin sekondár n'univerbacjonet e tipit **stoíghos sò* prej kah rrjedh fjala shqipe *shteg-u*, ku âsht çelsi për shpjegimin e çeshtjes sesi janë krijue reflekset e ndryshme të *ŏ*-s indoevropjane në fazat mâ të lashta të zhvillimit të saj në grupin thrako-frigjik: kjo ndodh se *a*-ja âsht çfaqë

---

[1]) *Beiträge zur alarodischen Sprachwissenschaft*, 46.

[2]) Armenisht *a* në *akn* „sŷ" etj. âsht refleks i vokalit indoevropjan të reduktuem, khs. veprën time *Uporedne jezičke studije* I (*Rad Jugoslovenske Akademije*, 1930). A. Meillet, *Bulletin de la soc. linguistique* 1931.

nën akcentin kryesuer, kurse *o*-ja (prej nga ka ardhë *u*-ja) nën akcentin sekondár, sikundër edhè në thrakishten, kurse në dialektet tjera ka mbizotnue njâna prej këtyne dý tendencave: në frigjishten dhe armenishten *o*-ja, kurse në shqipen *a*-ja, poashtu sikundër, simbas fuqís së tonit për *a*-n janë çfaqë *e*-ja dhe *a*-ja, kurse për *ŏ*-n *o*-ja dhe *u*-ja; për *-ōi* shqip *e*-ja dhe *u*-ja, si dhe kalimi i *ā*-s në *ü* duhet që të ketë alternue gjithashtu simbas akcentit — khs. arm. *lois* prej **loẅs* (arm. e stërlashtë **loẅko*) përkundruell **lowkósio* me *w* të papallatalizueme, prej së cilës âsht krijue *u*-ja në *lusói*. Nëse kalimi i *ā*-s në *ü* ka qenë i kushtëzuem nga akcenti edhè në thrakishten, nuk mund të konstatohet për mungesë shêmbujsh me *ā* etimologjike, por në lidhje me këte âsht me rândësí me vû në dukje reflekset e dyllojshme të *ā*-s në shqipen, ku lat. *jūdice* > *gjyq* përkundruell *gjukónj* (analogjikisht *gjykòj*) < lat. *judicāre*[1]).

Gjithashtu nuk âsht e lehtë me sqarue nëse pallatalizimi i vokaleve të gjata âsht indigjen ose jo. Meqenëse nuk mund të mohohet lidhja midis këtij pallatalizimi dhe kalimit të *ā/ä/ē* në greq. *mātēr* : *mētēr*, si dhe e njâjta tendencë në shqipen, ku *ä*-ja shqipe e stërlashtë prej *ā*-s n'indoev. **mātēr* âsht njâjtësue me *ē* në shq. e stërlashtë — **läd* = greq. *lēdeîn*, dhe *ē*-ja mâ vonë âsht bâ *ä* edhè në shqipen *motrè* dhe *lodh*. Mund të supozohet se pallatalizimi, i cili a priori mund t'ishte edhè nji çfaqje indigjene, duhet kushtue ndikimit të substratit në Gadishullin Ballkanik dhe kjo për arsye se kalimi i greq. *mātēr* në *mētēr* âsht me të vërtetë indoev. zânafillës. Faza ndërmjetëse midis *ē*-s indoevropjane dhe *o*-s së shqipes âsht ruejtë në thrakishten, khs. dak. *koa-dama* prej trajtës origjinare **kᵘa-dhēmn*. Kalimi i *a* s indoev. në *o* në shqipen âsht relativisht i vonshëm, sepsè përfshîn edhè fjalët e huamarruna prej greqishtes së vjetër, — krahasò geg. *mok(ë)në*, tosk. *mokërë* prej greq. *mākhanā* dhe âsht sigurisht mâ i vonshëm se kalimi *kh*-ës në *h* — shqip *harr*: indvj. *kharah* — si tregon qartë *k*-ja e shqipes në *moknë*, tosk. *mokërë* ndaj *kh*-ës në greq. *mākhanā*.

32. Në reflekset e diftongjeve indoevropjane *aŭ* dhe *eŭ* paralelizmi i zâvêndësimit shqiptaro-thrakas âsht i plotë: në mbetuninat e thrakishtes përveç diftongut të vjetër *aŭ* (psh. *Daunion teikhos*) çfaqet *a*-ja

[1]) Krahasò W. Meyer-Lübke, Gröbers *Grundriss der romanischen Philologie*, I² 1046, 1049; id., *Mitteilungen des rumän. Instituts in Wien*, 1, 3 e vazhdim.

e mâvonshme, krahasò *Daneion* ose *bast-* n'êmnat e vêndeve *Bi-bastos, Stran-basta* prej indoev. **bhau̯-st*; shqip. *agòj*: lat. *augeo*, lit. *áugu*. Se humbja e elementit labjal në diftongun origjinár *au̯* edhè në gjuhën shqipe âsht e vonëshme shihet sepsè ajo âsht bâ qysh në periudhën latine të historís së gjuhës shqipe — krahasò shqip *ár* prej lat. *aurum*. Paralelisht me kalimin e diftongut *au̯* në *a* âsht bâ në shqipen dhe në thrakishten edhè kalimi i *eu̯* indoevropjane në *e*, krahasò shqip *desha*: greq. *eJgeusá-mēn* dhe thrak. *dzétraia* prej indoev. **ĝheu̯tr-*[1]).

33. Nji isofonë e rândësishme shqiptaro-armene âsht edhè kalimi i *en+s* indoev. në *i*: shqip. *mish* – arm. *mis*: prusvj. *mansa*, sllav. *męso*. Mêndimi se kỳ kalim n'armenishten âsht normal kurse në shqipen âsht i vetmuem âsht i paqëndrueshëm[2]), krahasò shqip *nis* prej **enk* indoevropjane të riduplikuemne (greq. *enenkeĩn*), prej nga vjen shqip **enins*, dhe me humbjen e rregullтë të vokalit të parë të patheksuem (si *mik* prej lat. *amicus*) **nins* > *nís*[3]).

34. Për gjuhën shqipe, në morfologjí, âsht karakteristik artikulli postpozitiv. Jokl-i, ka të drejtë padyshim, kur thotë se artikulli ka egzistue qysh në kohën kur në gjuhën shqipe kanë fillue të depërtojnë elementet mâ të lashta të latinishtes, sepsè marrëdhânja midis trajtës së paskajueme *ftua*, *ftue* dhe trajtës së skajueme *fton-i* (prej lat. *cotoneum*) mund të shpjegohet vetëm me luejtjen e cakut të rrokjes (*fto-ni*)[4]). Por s ka dyshim se artikulli postpozitiv ka egzistue shum mâ përpara, dmth. se ai rrjedh nga epoka e stërlashtë e bashkësís gjuhësore shqiptaro-thrako-armene. Në të vërtetë prova për egzistimin e tij në mbetuninat gjuhësore të thrakishtes nuk ka, por për këte na flet gjuha armene në të ciiën për artikullin postpozitiv përdoren partikulat pronominale *-s*, *-d*, *-n* simbas rastit se kush flet, kujt i flitet ose për cilin bâhet fjalë: *mard-s* „njerí kỳ këtu", *mard-d* „njerí ai atỳ", *mard-n* „njerí ai atje", si n'artikullin e trillojshëm maqedon *-ot*, *-ov*, *-on*. Nji përdorim i këtillë shumartikujsh duhet të ketë egzistue edhè në gjuhën shqipe, sepsè për këte na flasin gjurmat

---

[1]) G. Meyer, *Beiträge zur Kunde der indogermanische Sprachen* XX, 124.
[2]) Pisani, o. c. 533.
[3]) Barić, *Albanorumänische Studien* I 89.
[4]) *Zur Gesch. der alban. Diphtonge -ue -ua*: *Idg. Forsch.* (1932) 42 e vazhdim.

e këtij përdorimi. G. Meyer-i[1]) dhe K. Brugmann-i[2]) kanë, padyshim, të drejtë kur artikullin postpozitiv *i* të shqipes e nxjerrin prej indoev. **is* (lat. *is-dem*) ose **ei* (në lat. *ae* prej *eia*) dhe gjithashtu edhè P. Skok-u, i cili artikulin e dytë postpozitiv *u* të gjinís mashkullore e nxjerr (në periudhën historike vetëm për êmnat me velar ose me vokal t'akcentuem në fund) prej *-(o)-vo(s)*[3]). Natyrisht nuk âsht e mundun me ndjekë hap për hap të gjithë proçesin nëpërmjet të të cilit âsht zhvillue sistemi i sotshëm rigjid i artikujvet simbas rastit nëse êmni mbaron me velar (*-u*) ose jo (*-i*), por nji gjâ âsht e sigurtë: — nji përdorim i këtillë i artikullit postpozitiv të dyfishtë relativisht âsht i vonshëm. Nga sistemi i parë *mik-i*, *mik-u*, ku *i* = **is* „ai" dhe *u* < **-ovos* „kỳ" — i pari përjashtohet për t'iu shmangë koklavitjes midis nominativit të singularit *mik-i* dhe nominativit të pluralit *mik-i*. Pikërisht për arsye se në gjuhën shqipe ka pasë shum artikuj, ka mujtë me u evitue shkrîmja vokalike për të cilën arsye artikulli nuk do të mund të dallohej mâ. Meqenëse prej fjalës *shi-i* do të dilte *shi*, artikulli *-u* e ka zâvendësue artikullin paralel *-i*, dhe për të gjitha këto arsye âsht shkallmue sistemi i vjetër *i*: **is*, *u*: **ovos*.

35. Në lakimin e shqipes âsht reduktue mjaft numri i rasavet indoev. Trajta e gjenitivit dhe e dativit në të gjitha klasat âsht e njâjtë, me përjashtim se dialekti i gegënishtes e ruen dallimin e këtyne rasave në pluralin e paskajuem; gjithashtu janë njâjtësue ablativi dhe gjenitivi, me përjashtim të pluralit të paskajuem në dialektin e toskënishtes. Njâjtësimi i gjenitivit dhe i dativit âsht karakteristikë edhè e greqishtes së ré dhe e iranishtes, por ndërsa në greqishten e ré âsht mbajtë formalisht vetëm gjenitivi, i atillë si âsht kryesisht edhè përsa i përkèt funkcjonit, dhe ndërsa në këte njâjtësim gjenitivi i iranishtes lidhet me gjuhët indishte-krite, ku gjenitivi âsht ai që e shtyen dativin, në gjuhën shqipe âsht ruejtë vetëm trajta e dativit si edhè n'armenishten, sepsè vetëm

---

[1]) *Alban. Stud.* II, 40 dhe 79.

[2]) *Grundriss* I, 94 dhe 277.

[3]) *Considérations générales sur la declinaison nominale roumaino-albanaise*: *Arhiv za arban. star.* II, 168. Mirëpo, Skok-u gabon me thes kur *-në* n'akuzativin e sing. të gjinís mashk. dhe femn. e nxjerr prej *(o)nom*, *(o)nam*: sllav. *onŭ*, *ona*, sepsè në këte rast, në trajtën e toskënishtes, duhej të çfaqej *-r-* për *-n-* indoevropjane.

me dativin mund të shpjegohen në gjuhën shqipe mbrapashtesat *-i* (*gur-i*) dhe *-u* (*mik-u*). Holger Pedersen-i këte mbrapashtesë në gjen.-dat. të shqipes e ka nxjerrë prej mbrapashtesës dative indoevropjane *ō*[1]) dhe ka qenë i mêndimit se kështu mund të shpjegohet edhè mbaresa *u* në gjenitivin dhe dativin e shqipes së tipit *zog-u*, gjâ që âsht vështirë të besohet, sepse *ō* e dativit t'indoevropeishtes me të cilën ai operon, nuk mund të konsiderohet e vërtetueme, madjè nuk ka prova as për kalimin e *ō*-s indoevropjane në *u* shqipe si supozon ai. As hipoteza ime e mâpërparshme se *u*-ja e shqipes = *ou* indoevropjane — nga e cila nxirret edhè mbrapashtesa *-u* e sllavishtes, simbas së cilës trajta dative e shqipes e tipit *guri* (prej. indoev. *oi*) do ti përgjigjej trajtës së tipit *zogu* njisoj si në lit. *vil̃kui* ndaj sllav. *vĭlkŭ* — bie poshtë për shkak se *ōi*, *ōu* indoevropjane në rrokjen jofillestare u përgjigjen *ai* > *ē* dhe *au* > *a*.

Mirëpo të gjitha vështirsít zhduken nëse nisemi prej dativit indoevropjan *ōi* dhe *ōu* në rrokjen e patheksueme, sepsè me ruejtjen e karakterit konsonant *i̯*, *u̯* para fillimit vokalik të fjalës vazhduese prej *ōi̯*, *ōu̯* mâ së pari bâhet *ə*‿*i̯*, *ə*‿*u̯*, prej nga vijnë *ĭ*, *ŭ* të rregullta, dhe me reduktimin e tyne në fund të fjalës (para kalimit të *ŭ*-s në *ŭ*) *i*, *u*[2]).

36. Nji karakteristikë e rândësishme e përbashktë shqiptaro-armene në lakim âsht mandèj edhè mbrapashtesa e lokativit të singularit dhe e pluralit të gjinís mashkullore dhe femnore *-t*. Ruejtja e saj na tregon se mbas *t*-ës ka egzistue vokali i mbramë dhe, meqenëse kjo mbrapashtesë âsht e njâjtë për të gjitha gjinít dhe numrat, âsht mâ se e besueshme se ajo âsht, në të vërtetë, — sufiksi i vjetër ndajfoljuer, për të cilën arsye ai mund të lidhet me **dhi* indoevropjane (krahasò greq. *-thi*) prej së cilës, mbas humbjes së *-i* së fundit, *d*-ja tingullore, mù në fund të fjalës, âsht bâ *-t*. Me këte âsht në lidhje sufiksi i lokativit t'armenishtes *-ǰ* = *dhi̯* indoevropjane (krahasò arm. *telvoǰ* prej *teli*, *teleac*, të cilës i përgjigjet saktësisht sufiksi i shqipes *-zi*, në toskënishten *prapa-zi*[3]).

---

[1]) Pikërisht për këte i ka shkue huq përpjekja e Fr. Ribezzo-s *Rivista d'Albania* I, 20. që mbaresën e shqipes *-i* ta identifikojë me mbaresën e gjenitivit *-ī* në lat. *lupī*, tue mos pasë, në këte rast, parasŷsh mbaresën paralele *-u*.

[2]) Krahasò sesi e kam nxjerrë unë n'*Arhiv za arb. star.* III, 281.

[3]) Krahasò veprën time *Albanorumänische Studien*, I, 156.

37. Midis sufikseve të përbashkta shqiptaro-armene, Pisani (o. c. 50, 2) numron edhè *-ve* të shqipes, të cilën ai e identifikon me arm. *bk'* sadoqë kjo, fonetikisht, âsht krejtësisht e pamundun edhè për shkak të *e*-s edhè për shkak të *v*-ës, kurse *-ve* e shqipes, pakurrfarë vështirsije, mund të sillet në lidhje me mbrapashtesën indoevropjane *-ōm,* me kalimin e *ō*-s në *e* dhe me *v* hiatike në shqipen, si në fjalën *vesh*: indoev. **ōs*. Nji karakteristikë e përbashktë shqiptaro-armene âsht mbrapashtesa e shqipes *e* në gjen. dat. të singularit në lakimin e êmnave të paskajuem të gjinís femnore, që vjen prej *-jās*, kurse *-jās* në vênd të *-ās* âsht nji vetí edhè e gjuhës armene (krahasò arm. *ami*, trajta gjenitive prej *am*, *ama-v-* prej indoev. **samiās*), por fakti se *-iās* ka zâvêndësue *-ās* edhè n'irlandishten e vjetër (krahasò *tuathe* prej **theutiās*) tregon prejardhjen dialektore indoevropjane të këtij inovacjoni. I njâjtë âsht rasti edhè me sufiksin *-š* (*sh*) në pluralin e shqipes. Ky sufiks edhè në gegënishten edhè në toskënishten âsht sufiks i ablativit plural, por *-š*-ja në gegënisht çfaqet edhè në gjenitivin e pluralit në lakimin e pacaktuem[1]). Simbas gramatikës normative kjo do të thonte se ablativi i lashtë plural, formue me sufiksin *-š*, ka marrë funksjonin e gjenitivit plural[2]). Mirëpo, nga pikëpamja historike kjo s âsht e saktë, sepsè përkueshmënija e sufiksit *-š* në gjenitiv dhe ablativ të pluralit âsht sekondare, — me fjalë tjera — âsht rezultat i njillojtë i dy sufikseve me origjinë të ndryshme, sufikse të cilat, përgjat shekujve, janë njâjtësue në gjuhën shqipe për shkak veprimi të ligjëve fonetikë. Në të vërtetë *-š*-ja ablative në pluralin e shqipes së përgjithëshme i përgjigjet ablativit plural t'indoev. *-*su* (krahasò lokativin e sllavishtes *tĕxŭ* = indvj. *teṣu*) ndërsa mbrapashtesa *-š* e gjenitivit në gegënishten përkon me sufiksin *-*sōm* të gjenitivit plural t'indoevropishtes. Meqenëse *-š*-ja e gjenitivit në gjuhën shqipe gjindet në trajtën e pacaktueme, kjo dmth. se mbrapashtesa indoevropjane *-sōm*, karakteristike për lakimin pronominal, âsht futë në lakimin e êmnave, si âsht rasti edhè në gjuhën greqishte, ku n'êmnat me mbaresë në *-a* vjen mbrapashtesa *-asōm* (greq. *thedōn*) dhe në latinishten kur ajo gjindet jo vetëm në gjenitivin e pluralit t'êmnavet me mbaresë në *-ā (rosārum)*, por edhè me

---

[1]) Krahasò Gj. Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien 1908, f. 99.

[2]) Gj. Pekmezi, l. c.

mbaresë *-o (dominōrum)*, edhè n'armenishten, ku *-ç*-ja ka përfshî të gjitha lakimet, dhe e cila në fleksjon âsht zâvêndësimi i *-s* së vjetër, si na e tregon këte aoristi i dobtë i armenishtes, dmth. aoristi i vjetër sigmatik, krahasò psh. *ama-ç* „annorum", *mardo-ç* „hominum", etj. prej indoev. *-sōm* dhe *-ç* prej *-s-* n'aoristin *mna-ç* „ai u ndal" në krahasim me prezentin *mna-m*. Mirëpo, ka nji rândësí shum të madhe për lidhjet e afinitetit shqiptaro-armen përkushmënija e *nomina agentis* të gjuhës shqipe me *-es* dhe t'armenishtes me *-ič* dhe *nomina actionis* me *-le*, gjâ të cilën e ka konstatue para mjaft kohe H. Pedersen-i, n'artikulin *Albanisch und Armenisch*: *Zeitschrift für vergl. Sprachforsch.* XXXVI 341 e vazhdim.

38. Në këte artikull, Pedersen-i ka dhânë nji varg të vogël paralelesh leksikore shqiptaro-armene, por në pikëpamje linguistike fort karakteristike; shqip *s* „nuk": arm. *č, oč*; shqip *ardh-í*: arm. *ort'*, (shih § 48); shqip *ha* aoristi *hângra, hëngra*: arm. *utem*, aoristi *e-ker*; shqip *zog*: arm. *jak*. Simbas mëndimit tim këtu hŷn edhè fjala shqipe *zgjedhë* (indoev. **duis* „dy herë" + **ledhō*). Pjesa e dytë përbâmëse e kësaj fjale të përngjitun sillet në lidhje me fjalën shqipe *lidh*, gjâ që fonetikisht âsht e mundun dhe, meqenëse egziston nji fjalë indoevropjane e cila përputhet plotësisht me fjalën shqipe *ledhë*, âsht e qartë se duhet qëndrue n'ekuacjonin e tyne. Kjo fjalë armenisht âsht *luc* prej trajtës origjinare indoev. **lōĝo*, me të cilën ka lidhje edhè fjala shqipe *ledhë* (me *e* prej *ō*-s, të cilës në gjuhën armene i përgjigjet *u*-ja).

39. N'orvatjet që të përcaktohet pozita e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëvet tjera indoevropjane, insistohet sidomos n'isoglosat të cilat e lidhin gjuhën shqipe me gjuhët e grupit veriuer dhe me gjuhën e përgjithëshme gjermanike dhe baltiko-sllave. Nga këto isoglosa bie poshtë „njâjtësimi" i *o*-s dhe *a*-s indoevropjane (shih §. 31), dhe mbeten vetëm dy: 1. ndërtimi i numravet me anë të *t*, në shqipen prej 6—10: *gjashtë* (: indvj. *šaṭ*, lat. *sex*, greq. *héks*); *shtatë* = indoev. **septṃ-ti* (: indvj. *saptá*, lat. *septem*, greq. *heptá*); *tetë* prej shqipvj. **ate-të* = indoev. **oktō-ti* (: indvj *aštau*, lat. *octo*, greq. *oktṓ*); *nândë* geg. *nëntë* tosk. prej indoev. **neun̥-ti* (: indvj. *nava*, lat. *novem*, greq. *ennéa*). Kjo trajtë gjindet edhè në gjuhët gjermanike ku got. *sibun* „7", *niun* „9" dhe *taihun* „10" lidhet me trajtat në *-nt*, edhè në gjuhët

baltiko-sllave: lit. *devĩnt* „9", *dešimt* „10", sllav. *devętĭ, desętĭ*, kurse në sllavishten edhè *pętĭ* dhe *šestĭ*; 2. ndërtimi perifrastik i dhetësheve: *tridhetë:* got. *treis tigjus*, lit. *trys dešimtis*, sllav. *tridesętĭ*.

Vetína të përbashkta të përkufizueme vetëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhët baltiko-sllave nuk ka, — sadoqë Pisani[1]) âsht i mëndimit se egziston nji vetí e përbashktë morfologjike baltiko-sllave. Kjo do t'ishte *-t-*ja e gjenitivit dhe ablativit të gjuhës shqipe, e cila simbas mendimit të tij, âsht *-d-*ja indoevropjane me rrânjë indoev. n'-*o* (latvj. *-ōd*, indvj. *asmād, devād*); me fjalë tjera: shqipja për gjenitiv paska marrë për rrânjët me *o* trajtën e gjenitivit si gjuhët baltiko-sllave (lit. *dievo*, sllav. *raba* prej **od*) — gjâ që âsht krejtësisht e pamundun, sepsè *-d-*ja e fundit indoevropjane humbet në gjuhën shqipe (krahasò shqip *të* prej indoev. **tod*). Gjuha shqipe ka lidhje me sllavishten vetëm në nazalizimin e vokalit para nazalit + konsonantin për shkak të tendencës drejt rrokjevet të hapta. Mâ në fund, në lidhje me zgjedhimin duhet theksue se në dialektin e gegënishtes imperfekti ndërtohet me anën e *-sh* t'aoristit sigmatik (psh. *isha)* njilloj si në sllavishten (krahasò *delaxŭ, delaaše -aše, -axomŭ, -ašete -axǫ*) në kundërshtim me gjuhën e përgjithëshme gjermanike dhe gjuhët baltike, të cilat këte trajtë nuk e njohin. Por, meqenëse aoristi sigmatik gjindet edhè n'armenishten, edhè në nji numër të madh gjuhësh tjera indoevropjane, domethânë se kjo isoglosë rrjedh qysh nga periudha dialektore e indoev. zânafillëse dhe se shqipja zânafillëse, n'atdheun e saj origjinár, ka qenë mâ afër zonës në të cilën âsht individualizue sllavishtja zânafillëse sesa zonës në të cilën janë formue gjuhët baltike dhe gjermanike të përgjithëshme.

Në këte atdhé veriuer të gjuhës shqipe na udhëzon edhè nji varg përkimesh leksikore: gegënisht *rrâni*: gjermvj. *renne*[2]); shqip *shtalb*: gjermvj. *stallra*, hollandisht *stollen*[3]); shqip *lândë*: lit. *lentà*[4]) „dërrasë"; shqip *lthí* (*lajthí, lejthí*): lit. *lazdà*[5]); shqip *vesh* „kalavesh": lit. *vãisius*[6]);

---

[1]) o. c. f. 528.

[2]) W. Meyer-Lübke, *Literaturblatt für germanische und romanische Philologie* XII, 241.

[3]) N. Jokl, *Linguistisch-kulturhist. Unters.* f. 282.

[4]) Id., o. c. 276 e vazhdim.

[5]) Id., o. c. 272 e vazhdim.

[6]) Id., o. c. 213 e vazhdim.

shqip *vjel*: lit. *valýti*[1]); shqip *vidh-i*: sllav. *vezĭ*[2]) etj. Gjithë kjo, në të vërtetë, na tregon fqinjësín parahistorike, mirëpo, thelbi i çeshtjes s'afinitetit gjenetik qëndron n'anën tjetër, domethânë ai ka të bâjë me gjuhën armene, për të cilën gjâ na ka udhëzue, me dorën e sigurtë, Pedersen-i n'artikulin e përmendun. Kur hjekim isoglosat shqiptaro-armene, të cilat janë edhè të greqishtes edhè të gjuhëvet baltiko-sllave, si kemi pá, mbetet nji varg i tânë karakteristikash shum të rândësishme, të cilat përkufizohen me shqipen dhe armenishten. Ky âsht, në të vërtetë, edhè koncepti i Pedersen-it mbi pozitën e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëvet tjera indoevropjane. Ndryshimi midis pikëpamjes sime dhe pikëpamjes së Pedersen-it âsht se ai mohon grupin shqiptaro-thrako-frigjiko-armen[3]), kurse unë mêndoj — si kam provue me argumente të reja — se vêndin ndërmjetës midis shqipes dhe armenishtes e zên thrakishtja, sepsè gjuha shqipe përputhet me thrakishten në të gjitha ato vetína, të cilat e ndajnë prej frigjiko-armenishtes.

---

[1]) N. Jokl, o. c. 214.

[2]) Chr. Bartholomae, *Zur Buchenfrage*: Sitzungsb. der Heid. Akad. der Wissen. Phil.-hist. Kl. Jahrgang 1921 f. 32.

[3]) Krahasò artikullin e H. Pedersen-it: *Armenisch* në *Reallexikon der Vorgeschichte* t'Ebert-it. Në kchën e fundit ai sỹnon që, me gjith dëshmit e Herodot-it (VII, 73) simbas së cilit Armenët janë *Phrygõn ápoikoi*, prej armenishtes ta ndajë frigjish en si gjuhë të grupit *centum*. Krahasò *Das Hetitische und die anderen indogermanischen Sprachen*, Kopenhagen, 1938, 186. Në kundërshtim me këte janë shêmbujt si *mossyn* „kullë": oset. *mäsug* < irlvj. *masu-k* (= indoev. **mŏku-*) E. Lidén, *Folknamet Mosynoiker*: *Strenna phil. Upsaliensis* — Festskrift tillägnad prof. P. Persson, Uppsala 1922, 392 e vazhdim, frigj. *satínē*, *sátilla*: jerm. *sail* „qerre", idem. *Commentationes phil. in hon. J. Paulson* (Göteborg 1905) 159 e vazhdim.

## IV.

## ATDHEU I HERSHËM SHQIPTÁR NË MBRENDËSÍN E GADISHULLIT BALLKANIK. KONTAKTET THRAKO-ILIRJANE. NDIKIMET E GREQISHTES SË VJETËR. KRITIKA HIPOTEZËS SKITJANE.

40. Meqenëse, si âsht thânë deri-tash, gjuha shqipe âsht, në të vërtetë, nji dialekt i thrakishtes, karakteri „thrako-ilirjan" i saj duhet të jetë rrjedhimisht rezultat i simbjozës së mâvonëshme thrako-ilirjane, me çfarë shpjegohen elementet jo aq të shumta ilirjane në fjalorin e shqipes. Prandèj, vetëvetiu paraqitet pyetja: kur âsht bâ kjo simbjozë, në të cilën, Shqiptarët thrakas, t'ardhun në teritorin ilirjan, paraqesin nji shtresë të ré. Mêndimet në lidhje me këte endè sot e kësaj dite janë të ndame. Disa mêndojnë se Thrakasit kanë vërshue Ilirikun qysh në periudhën e stërlashtë. Argument për këte do t'ishin elementet e thrakishtes në toponomastikën e Ilirikut, në të cilat mbështetet edhè hipoteza turravrape mbi prioritetin thrakas n'Ilirik[1]), elemente të cilat, në të vërtetë, nuk egzistojnë, sepsè ato janë êmna mediteranë. Fjala *dava* n'êmnin hibrid greko-ilir të vêndit *Thermi-dava* (Ptolomei II, 16, 9) e cila, padyshim, âsht identike me *-dava* në toponimet në teritorin thrakas, si psh. *Seti-dava* për të cilën, gjâ Jokl-i do ta konsideronte të mundshëm depërtimin e pjesëshëm të Thrakasëve në teritorin ilirjan në periudhën parahistorike shum të lashtë[2]), — âsht, padyshim, nji prej atyne relikteve mediterane të shumta, me të cilat âsht e thurrun toponomastika antike e të gjithë Gadishullit Ballkanik, sepsè *-dava* nuk mund të ndahet prej

---

[1]) K. Patsch, *Thrakische Spuren an der Adria*: *Jahreshefte des Oesterr. archeol. Instituts* X, 1907.

[2]) *Reallexikon der Vorgeschichte* VI 48 b, XIII 284.

fjalës karjane *taba* „shpellë", as prej toponimit paragrek *Thèbai*. Gjithashtu s ka dyshim se êmni *Brygeídes nēsoi* n'Adriatikun Veriur, që përmendet në lidhje me êmnin nacjonal të Frigjiasvet, popull i afërt me Thrakasit, nuk âsht me prejardhje indoevropjane, sepsè për këte na tregon fjala likjane *briga* „i lirë" te Hesyhu.

Imigracjoni i Shqiptarëve n'atdheun e tyne historik, në Shqipnín e sotshme, duhet të jetë relativisht recent, sepsè — si âsht konstatue qysh me kohë — vetëm kështu mund të shpjegohet pse nuk ka gjurma të terminologjís detare indigjene shqiptare, dhe pse toponimet e kësaj zone gjuhësore historike shqiptare nuk kanë karakterin fonetik të shqipes, dmth. se toponimet nuk kanë pësue disa ndryshime fonetike, të cilat do të bâheshin, patjetër, sikur Shqiptarët „të gjindeshin gjithmonë e jetës në teritorin e tyne të sotshëm"[1]). Këto pikëpamje të përgjithëshme janë arsye që edhè historjani K. Jireček-u qysh në veprën e vet *Geschichte der Serben* I (1910) f. 150 e vazhdim, ka braktisë mëndimin tradicjonal mbi kontinuitetin e atdheut shqiptár nga kohët antike deri më sot dhe ka kërkue atdheun e hershëm ballkanik të Shqiptarëvet në zonat malore midis Dalmacís së sotshme dhe Danubit në periudhën e dyndjes së popujve, kurse Jokl-i, flamurtari i zjarrtë i dikurshëm i teorís së kontinuitetit[2]), „në pjesën veriprendimore të zonës së vjetër ilirjane në Gadishullin Ballkanik, ku gjuha thrakishte ka qenë në kontakt me ilirishten"[3]). Simbas hipotezës së arkeologut rumun Pârvan, atdheu i hershëm i popullit shqiptár duhet të jetë Dakija, prej kah, simbas mëndimit të tij, Shqiptarët — si paraardhës të Sllavëve — kanë ardhë n'atdheun e tyne historik aty kah shekulli i tretë dhe i katërt i erës sonë[4]), ndërsa, simbas mëndimit të sllavistit sovjetik A. M. Seliščev, Sllavët, në depërtimin e tyne në Shqipní, nuk i kanë hasë aspak atje Shqiptarët, por vetëm Romanët[5]). Prandèj, — simbas mëndimit të tij — ardhja e Shqiptarëve n'atdheun e tyne historik na qenka bâ në periudhën mbas hŷmjes së Sllavëvet në Shqipní.

---

[1]) L. Spitzer, *Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität in Wien*, I, 1914, 292 e vazhdim.

[2]) *Albanisch* në *Die Erforschung der indogermanischen Sprachen* II/III, Strassburg 1917, 122; po kështu edhè P. Kretschmer-i, *Revue international des études balkaniques* I/II (1935) 47.

[3]) *Albanisch. Reallexicon* i Ebert-it I, 24 e vazhdim.

[4]) Beiheft 26 zur *Zeitschrift für romanische Philologie* 61 e vazhdim.

[5]) *Slov. naselenia v Albanii*, Sofia (1930) 246.

41. Se nji mêndim i këtillë i marrëdhânjevet kronologjike âsht rrânjësisht i gabueshëm na tregon edhè vetë karakteri fonetik i disa toponimevet antike, prej të cilavet rrjedh se ato janë êmna të stërlashtë që Sllavët e Jugut i kanë marrë nëpërmjet të gjuhës shqipe, sepsè në këto toponime mund të konstatohen ndryshimet fonetike, të cilat janë bâ në gjuhën shqipe para ardhjes së Sllavëve të Jugut në teritorin historik të Shqiptarëvet. Vetëm kështu mund të shpjegohet psh. marrëdhânja fonetike midis êmnit serb të lumit Buna, *Bojana* dhe êmnit antik *Barbanna* (Liv. XLIV 31, 3). Trajta ndërmjetëse, padyshim, ka qenë **bauanna* prej të cilës me kalimin sllav të *a* së huej paratheksore në *o* (si psh. *Solin* prej *Salōna*) dhe *j* për *v* (si në *Motajica* krahas me *Motavica*) âsht krijue trajta serbe *Bojana*[1]), por humbja e *-r-* n'êmnin *Barbanna* mund të shpjegohet vetëm me disimilimin e *r*-ës nazale dhe *n*-ës së luhatshme në shqipen[2]), dhe kjo çfaqje âsht, padyshim, parasllave, sepsè rotacizmi i shqipes, i cili mbështetet n'identitetin akustik dhe fonetik të *n*-ës së luhatshme dhe *r* ës nazale nuk ka përfshî as elementet sllave mâ të lashta në gjuhën shqipe.

As teorija e Pârvan-it në lidhje me shpërnguljen e Shqiptarëvet prej Dakís nuk âsht e qëndrueshme. Ja sepse: sadoqë Dakija, simbas dëshmimit të burimevet antike âsht zonë gjuhësore e thrakishtes[3]), dhe gjuha shqipe, padyshim, nji dialekt i thrakishtes, hipoteza e Pârvan-it duhet të hidhet poshtë për arsye se në gjuhën shqipe janë konstatue fjalë greke të huamarruna nga epoka e cila âsht shum mâ e lashtë sesa ndikimet mâ të herëshme latine në gjuhën shqipe, (shih § 44) kurse Dakija ka mbetë jashtë ndikimeve greke. Për të njâjtat shkaqe bie poshtë edhè hipoteza bizare panone e filologut rumun Philippide, e cila, zatën, âsht e papranueshme edhè për shkak se Panonija, në periudhën parakeltike, ka qenë e banueme prej Ilirëve, si i ka ra mirë në sŷ qysh Gaspar von Zeuss-it, tue vû në dukje se fiset e Panonís *Perustae* dhe *Desiates*, të cilat i përmênd Strabo (3, 30) kanë pò ata êmna si edhè fiset dalmate, të cilat i përmend Velloius (II, 15: Perustae et Desiates Dalmatiae) dhe Plini (nat. hist. III, 32: *Mazaei* et *Desiates*)[4]).

---

[1]) Krahasò P. Skok, *Zeitschrift für Ortsnamenforschung* IV, 205.

[2]) Krahasò H. Barić, *Ime reke Bojane: Ramovšev zbornik*, Ljubljana 1951

[3]) Strabo 3, 3.

[4]) *Die Deutschen und die Nachbarstämme.*

42. Për lokalizimin e atdheut të hershëm ballkanik të Shqiptarëve të vonshëm — i cili, patjetër, duhet të jetë shtrî në verí të zonës gjuhësore greke, vetëm prej nga do të kenë mujtë me u futë në gjuhën shqipe elementet mâ të lashta greke (shih § 44), — në mungesë të plotë të çdo lajmi historik — të vetmen mënyrë që të përcaktohet kjo zonë e lashtë shqiptare, ose thânun mâ sakt të përcaktohen disa pika të kësaj zone, na japin toponimet antike shqiptare të lashta nëse nën perden sllave ka mujtë të mbahet karakteri fonetik i shqipes. Nji toponim i këtillë âsht, padyshim, *Nishi* për arsye se marrëdhânja fonetike midis trajtës antike *Naïssus* dhe trajtës sërbishte *Niš* nuk mund të shpjegohet, si mêndojnë disa, me mjete sllave, sadoqë *-š* mund të jetë bâ prej *s-ji*, sepsè kalimi i *ai* në *i* në sllavishten bâhet vetëm në fund të fjalës, kurse kjo mund të shpjegohet lehtë me hiferezën shqipe të *a*-s paratheksore si ka konstatue saktësisht Jokl-i[1]), për të cilën arsye *a*-ja dhe *š*-ja për *ss* âsht nji zâvêndësim normal në shqipen. Nji shêmbull i sigurtë i *š*-ës shqipe prej *s*-ës gjindet në Dardanín antike edhè n'êmnin shqiptár të qytetit *Shkup*, ku *u*-ja dëshmon se Shqiptarët e kanë marrë direkt trajtën antike *Scupi*, të cilën gjâ e ka vû ré P. Skok-u[2]). Nji trajtë tjetër me *š* shqipe për *s*-ën âsht ruejtë edhè në Peonín e afërt, në toponimin *Shtip*, marrëdhânja e të cilit me êmnin antik *Astíbos* shpjegohet me humbjen e rregulltë të *a*-s fillestare në shqipen (krahasò shqip *mik* prej lat. *amicus*) dhe me kalimin e *b* së fundit në *-p*. Pika mâ jugore e vêndeve të herëshme të banueme prej Shqiptarëve, e cila ka mujtë të vërtetohet deri më sot, âsht *Ohri*, ku gjithashtu marrëdhânja midis êmnit antik *Lychnís*, *Lychnídos* dhe trajtës sllave *Ohrid* mund të shpjegohet përsërí vetëm me ndërmjetsimin e shqipes, meqenëse sòll në gjuhën shqipe *n*-ja mbas guturalit kalon në *r* (krahasò shqip *grue*: indvj. *gna*) dhe sidomos fjalën shqipe *(h)rek* prej indoev. **khnak*: gjerm. *(hnakki) Nacken*[3]).

Simbas parashtrimit të mâsipërm, atdheu ballkanik i popullit shqiptár duhet të jetë Dardanija-Peonija, krahina të cilat, tue gjykue simbas êmnave të ruejtun të personave, në periudhën antike kanë qenë ilire e jo thrake[4]). Prandèj lokalizimi i elementit thrako-shqiptar

[1]) *Reallexikon der Vorgeschichte* I 126.

[2]) *Glasnik Skopskog naučnog društva* XV—XVI (1935—36) 301.

[3]) Krahasò veprën time *Albanorumänische Studien* I 82.

[4]) Krahasò P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache.*

në këte sektor bân që të supozohet dyndja e elementit thrakas në krahinën e lashtë ilire. Në burimet historike në lidhje me këte nuk bâhet fjalë, por këte e vërtetojnë rezultatet të cilat i ka zbulue Mateescu n'analizën e tij të hollësishme dhe minucjoze në materjalin epigrafik, tue konstatue infiltrimin thrakas në këto krahina ilire n'ekspansjonin e vrullshëm të Thrakasvet, gjâ që ka ndodhë në nji periudhë relativisht *të vonë — aty nga shekulli i II—III-të t'erës sonë*[1]). Prandèj mund të thuhet se Dardanija dhe Peonija janë krahina në të cilat âsht bâ simbjoza e parë shqiptaro-ilirjane qysh në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik.

43. Ndikimi i substratit ilirjan shpjegohet nëpërmjet të njij numri fjalësh ilirjane në gjuhën shqipe, por deri më sot nuk janë vërtetue edhè ndikimet fonetike t'ilirishtes në gjuhën shqipe — sadoqë âsht shum e mundshme që të ketë — kryesisht sepsè burimet gjuhësore t'ilirishtes mungojnë të thuesh krejtësisht[2]). Mêndimi i dikurshëm se *ft* dhe *fs* të shqipes për lat. *ct*, *x* (krahasò *luftë* prej lat. *lūcta*, *kofshë* prej lat. *coxa*) duhet të merren si ndikim ilirjan[3]) — për të cilën gjâ ka insistue, në kohët e fundit, P. Kretschmer-i[4]), — âsht i paqëndrueshëm: 1. për arsye se kỳ kalim çfaqet vetëm në fjalët shqipe me prejardhje latine, ndërsa në fjalët genuine shqipe âsht bâ asimilimi i togjeve *kt*, *ks* në *t*, *s* (krâhasò shqip *natë* me lit. *naktìs*, përkundruell *luftë* prej lat. *lūcta*; shqip *pishë* prej indoev. **pikso* përkundruell *kofshë* prej lat. *cŏxa*); 2. për arsye se dialektet e lashta romane (paravenecjane) të bregdetit tanë adriatik nuk e njohin këte ndryshim (krahasò *pi̯ák(t)no* „krahën" (në ishullin Kërk) prej lat. *pectine*; *trakta* „nji lloj rrjete" prej lat. *tracta*, *liksija* „bloza" prej lat. *lixīva* në dialektin e Dubrovnikut)[5]). — Varjanta me *ks* dhe *ps* n'êmnin antik t'ishullit

---

[1]) Krahasò *Granița de apus a Tracilor* në *Annuarul Institutului de Istoriă nationala*, Cluj (1923) III 377—492.

[2]) Krahasò H. Krahe, *Wüzburger Jahrbücher für d. Altertumstwissenschaft* I (1946) 171—174.

[3]) Kopitar, *Kleinere Schriften* 239; Schuhardt, *Vokalismus des Vulgärlateins* II, 49.

[4]) *Ditunija gjuhore indogjermane* 1923; id. *Glotta* XV, 177.

[5]) *pt* në dialektin e ishullit Kërk *u̯ápto* „8" prej lat. *octo* âsht analoge me *si̯ápto* „7" (si nji trajtë dialektore e greqishtes *optó* „8" në vênd *októ* për arsye të *heptá* „7") kurse në dialektin e Dubrovnikut *kopsa* „kofshë deleje" nuk âsht refleks i dalmatishtes së vjetër-romanishtes në fjalën latine *coxa*, por fjalë e

*Cres*: *Crexi* (Plinius III, 140) dhe *Krépsa* (Ptolemej III, 16, 13), për të cilën bân fjalë Kretschmer-i, nuk vërteton hipotezën për kalimin ilirjan të *ks* në *ps*, sepsè *p*-ja në trajtën *Krepsa* âsht etimologjike (krahasò shqip *krep*), kurse *Crexi* në vênd *Crepsi* (*-si* = sufiks lokal i ilirishtes) âsht hiperurbanizëm ortografik, si psh. *icse* në vênd *ipse* te Suetoni[1]).

44. Asht nji çeshtje endè e pazgjidhun nëse dhe sa kanë ndikue në gjuhën shqipe, n'atdheun e saj, gjuhët fqinj indoevropjane në periudhën pararomake. Përsa i përket greqishtes së vjetër, ndikimin e së cilës e ka pasë mohue krejtësisht G. Meyer-i[2]), mbas orvatjeve kryesisht të shkueme huq të Bugge-s[3]), A. Thumb-i i ka dalë në krye që, në fjalorin e shqipes, të konstatojë nji numër elementesh të greqishtes së vjetër (krahasò *mok|ë|në*, tosk. *mokërë* prej greq. *mākhanā* (ose *mēkhanē*); *pjepën, pjepër* < greq. *pépon-os*; *presh* përkundruell greq. ré *pras*[4]). Në kohët e fundit Pisani[5]) âsht orvatë që me ndikimin e greqishtes fqinje në shqipen e Gadishullit Ballkanik të shpjegojë dý vetína fonetike të shqipes: humbjen e *g*-s mbas okluziveve (shqip *derë*: indvj. *dvār*, lit. *dvāras*, sllavvj. *dvorŭ*, indoev. **dhu*-dhe asimilimin e *ln* (shqip *valë*: lit. *wilna*, sllavvj. *vlŭna*, greq. (lesb.) *stállā* prej **stálnā*), gjâ që mund të besohet vështirë, sepsè çfaqjet fonetike nuk mirren aq lehtë prej gjuhëvet fqinje, si âsht rasti me fjalët e kulturës së huej, numri i të cilavet, në gjuhën shqipe, përsa u përkèt elementeve të greqishtes së vjetër, âsht shum i vogël.

---

huamarrun prej gjuhës së Vllehvet barij të ngulun në rrethin e Dubrovnikut, fjalë nga të cilat gjinden në nji numër të konsiderueshëm, si mund të shihet në studimin tim: *Uzajamni odnosi balkanskih jezika*, Beograd (1937) 17.

[1]) Krahasò studimin tim: *Po ilirskim tragovima*: *Južnoslovenski Filolog* II (1921) 50 e vazhdim; N. Jokl, *Indogermanisches Jahrbuch* IX, 1922, 67; Th. Capidan, *Dacoromania* II, 1922, 444; P. Skok, *Revue linguistique romane* II, 1926, 267; A. Trombetti, *Saggio di antica toponomastica mediterranea* 1926, 32; Reichenkron, *Berliner Beiträge zur romanischen Philologie* X (1939) 79 e vazhdim.

[2]) *Albanische Studien* IV, 45.

[3]) *Bezzenberger's Beiträge zur Kunde der indogermanischen Sprachen* XVIII 188 e vazhdim.

[4]) *Indogermanische Forschungen* XXVI 1 e vazhdim.

[5]) *Mèlanges Henri Grégoire* II 527 dhe vazhdim.

45. Prej gjuhëvet tjera indoevropjane në verí të Gadishullit Ballkanik në periudhën e lashtë dhe të ré njifarë roli kanë luejtë edhè Skitët iranjanë. Në lidhje me faktin se Shqiptarët, përsa i përkèt gjuhës, janë kaq t'afërt me Thrakasit, Pisanit ia merr mêndja se zâvêndësimi í dyfishtë i pallataleve indoevropjane në shqipen (indoev. $\hat{k}$: shqip *s* dhe *th*: *sorrë*: *cornix*; *thanë*: indoev. **korygna*; shqip *zorrë*: lit. *žarna*; *dhâmb*: sllav. *zǫbŭ*, greq. *gómphos*) duhet të merret si ndikim iranjan në gjuhën thrako-shqipe nëpërmjet të Skitëve, të cilët, mbassi kaluen Kaukazin atỳ nga shekulli i shtatë para erës sonë, u ngulën në Rusín e Jugut dhe, me disa degë të tyne prendimore, u përzien me Thrakasit e përtej Danubit[1]). Kjo hipotezë duhet të hidhet poshtë, sepsè diferencimi i reflekseve shqipe të pallatalevet indoevropjane âsht nji çfaqje relativisht shum recente, si na tregon këte qartësisht lidhja midis fjalës shqipe *vjedhullë*: rum. *vjezure*; shqip *bardhë*: rum. *barză* „lejleku", prej nga del se: në gjuhën shqipe qysh në periudhën kur në rumanishten kanë hỳ fjalët shqipe mâ të lashta, reflekset shqipe të pallataleve indoevropjane kanë qenë endè në fazën *t'š*, *d'ž* — krahasò në lidhje me këte edhè trajtën rumune *cioară* (lexò *ç*-) e cila supozohet të jetë prej fjalës shqipe të lashtë *t'šorë* (sot *sorrë*) dhe sllavvj. *žalī*, sërb. *žal-o* prej shqipes së lashtë **džal* (sot *záll*): indoev. **ĝə*$_1$*sl*- n'irlvj. *gall* „gur" prej **gəslā*, gjermvj. *kisil* „zhavor"[2]).

As vetija e dytë dhe e fundit për të cilën insiston Pisani — lidhja e adjektiveve apo êmnave me karakter gjenitiv me êmnat me anën e *i*-s gjithashtu nuk âsht ndonji „analogjí e përsosun shqiptaro-iranjane". Artikulli prepozitiv i shqipes *i* (*mal i naltë*, *bir i mbretit* etj.) âsht, në të vërtetë, demostrativ (indoev. **is* „ai"), kurse *i*-ja në persishten *mard i chube*, *asp i mard* vihet në lidhje me futjen e përêmnit relativ t'iranishtes së vjetër midis êmnit dhe adjektivit, gjegjësisht gjenitivit atributiv (krahasò persvj. *xčacam tyam Nadibairahya* (përkëthim fjalë për fjalë) „ushtrín të cilën Naditabera", avest. *ažim yim aspo garəm* „gjarpnin të cilin llupitës kuajsh", *Miθro yovourn-gaoyatiš* „Mitri i cilí pronár fushash të mëdha".

---

[1]) o. c. 336.

[2]) Krahasò veprën time *Albanorumänische Studien* I (1919) 118 e vazhdim.

## V.

## NDIKIMET E SUBSTRATIT PARAINDOEVROPJAN.

46. Zbritja e Indoevropjanëve prej Veriut t'Evropës në Gadishullin Ballkanik ka ndodhë në periudhën e herëshme parahistorike. Arkeologët janë të mêndimit se Grekët janë ngulë në Jugun e Ballkanit nga fillimi i milenjumit të dytë para erës sonë, kurse mbas tyne Ilirjanët dhe Thrakasit, prej të cilëvet, të parët kanë zânë Prendimin dhe të dytët Lindjen e pjesës veriore të Gadishullit Ballkanik. Asht shum vështirë me përcaktue mâ saktësisht periudhën e ardhjes së tyne, përmâtepër, sepsè kjo, gjâ që ka shum gjasë, nuk âsht bâ menjiherë, por etap-etap, si âsht, padyshim, rasti me dyndjen e Grekëvet n'atdheun e tyne të rí.

Në periudhën kur Indoevropjanët janë ngulë këtu, Gadishulli Ballkanik ka qenë i banuem prej njij popullsije të vjetër, gjuha e së cilës ka ushtrue nji ndikim mjaft të ndijshëm në gjuhët e popujvet t'ardhun, gjâ që shihet në nji varg të tânë çfaqiesh fonetike dhe morfologjike, të cilat dallohen rrast prej tipit gjuhësuer indoevropjan, sidomos në fjaluer. Me i konstatue këto ndikime âsht nji punë shum e vështirë, sepsè gjuhët e këtyne banorëve të stërlashtë na janë fort pak të njoftuna. Të gjitha dokumentet gjuhësore të popujvet paraindoevropjanë në Gadishullin Ballkanik, të gjetuna deri tash, papërjashtim, janë prej zonës egjeje dhe studimi i tyne endè âsht në zânafillje. Mbishkrime krete n'alfabetin figural dhe linear të Minojës nga milenjumi i dytë para erës sonë ka bukùr shum, por endè nuk janë të deshifrueme. Formula e mallkimit të sëmundjeve, shkrue në nji papirus, i cili ruhet në Londër, mund të lexohet, por orvatjet e derisotshme që të përkëthehet kỳ tekst nuk janë aspak bindëse. Përveç këtyne, në të vërtetë, në burimet gjuhësore endè të pastudjueme, në këte zonë ka edhè katër mbishkrime: mbishkrimi i dyfishtë në nji stele

me parzmin e luftarit n'ishullin Lemnos dhe tri mbishkrime nga Praisona në pjesën lindore të Kretës — të gjitha n'alfabetin grek të shekullit V-të dhe IV-të para erës sonë. Gjuha e këtyne mbishkrimeve përkon me etrurishten n'Italí dhe, me plot të drejtë, merret se âsht e Tyrsenëve të cilët, simbas dëshmive të Tukididit, kanë jetue në Lemnos, dhe të cilët Homeri i quen Pellazgë. Në fillim kỳ êmën përkufizohej vetëm në popullsín e lashtë të rrafshinës së Thesalís, të cilën Grekët e ardhun e kanë quejtë kështu simbas vêndbanimit të tyne (*Pelag-skoi* prej *pélagos* „rrafshinë"), kurse mâ vonë shkrimtarët këte êmën e kanë zgjânue në të vjetrat fise tjera të hasuna atje, kështu që Tukididi midis Pealzgëvet numron edhè Tyrsenët. Ai ka gjetë gjurmat e tyne në Plakí dhe Skylaks të Helespontit dhe në verí të Kalkidikut, ku ka konstatue se ka edhè Tursenë pellazgjikë, gjuhën e të cilëvet ai e quen barbare, prej kah rrjedh se: gjuha e kësaj popullsije të lashtë ka qenë e afërt me tyrsenishten dhe kështu pra edhè me etrurishten.

Nji burim tjetër, shum i rândësishëm për përcaktimin e lidhjevet t'afinitetit të popullsís paraindoevropjane në Gadishullin Ballkanik âsht toponomastika, sepsè toponimet — madjè toponimet në kuptimin mâ të gjânë të fjalës, pra êmnat e lumejve, liqejve dhe maleve, viseve dhe vêndbanimeve — ruhen me ngulm edhè mbas asimilimit të popullsís së herëshme. Rruga e studimit të këtyne toponimeve paraindoevropjane âsht ça plot para nji shekulli prej komparatistit A. F. Pott, i cili ka vërtetue përkimin e sufiksit *-nth-* në toponimet greke dhe të sufiksit *-nd-* në toponimet e Azís së Vogël[1]). Nji hap të rândësishëm përpara e ka bâ mâ vonë C. Pauli në veprën e vet mbi mbishkrimin paragrek në Lemnos, tue zbulue sufiksin paragrek dhe t'Azis së Vogël *s(s)*[2]). Toponimet e shumta me sufikse të këtilla karakteristike — dhe shpesh me mbaresa të njâjta — në Karí, Likí dhe Lidí dhe në zonën e Egjeut kanë bâ që të lindi në shkencë ideja mbi afinitetin e gjuhëvet etruro-pellazge n'Evropë dhe gjuhëve të Karjasve, Likjasve dhe Lidjasve n'Azín e Vogël. Dhe kur H. Hommel, në vështrimin e tij mbi veprën e Pauli-t (*Archiv für Anthropologie* 1890, 251 e vazhdim), në këte

---

[1]) *Die Personennamen und ihre Entstehungsarten auch unter Berücksichtigung der Ortsnamen* (1853) botim i dytë (1859) 451.

[2]) *Eine vorgriechische Inschrift von Lemnos* I (1886).

grup të gjuhëvet paraindoevropjane, të cilat ai i quen alarodike, fut edhè dialektet e Kaukazit të Jugut, elamishten, kosishten dhe hattidishten n'Azí dhe retishten, ligurishten dhe iberishten n'Evropë, Pauli në vëllimin e dytë të librit të tij, kushtue mbishkrimit në Lemnos (1894), i përvishet analizës së të gjitha këtyne gjuhëve dhe, tue konsiderue se âsht i vërtetuem afiniteti gjuhësuer midis Etrurëve dhe Pellazgëve të Lemnos-it, konstaton mundësín e afinitetit t'etrurishtes, karishtes, lidishtes, likishtes, elamishtes, kaukazishtes së jugut, retishtes, ligurishtes dhe iberishtes. Nji grup edhè mâ të gjânë përfshîjnë studimet e Oštir-it, tue fillue prej veprës së tij *Beiträge zur alarodischen Sprachwissenschaft* (1921), vepër e cila hap nji epokë të ré në linguistikën mediterane dhe palevropjane me zbulimin e bazave të sistemit theksuer me shka përcaktohet kỳ afinitèt gjuhësuer mediterano-palevropjan[1]). Sadoqë âsht e qartë se në këte zonë të gjânë ka pasë dhe âsht dashtë të ketë ndryshime dhe stratifikime si gjinden në çdo grup të gjuhëvet të ngjashme midis tyne, në këto tridhetë vjetët e fundit ka depërtue në shkencë ideja se pikësëpari ka egzistue nji lidhëshmëní etniko-linguistike jo indoevropjane prej Kaukazit deri në Piriné. Prej kësaj ure madhështore kanë mbetë dý shtylla ekstreme, që u kanë shpëtue valëve dëpërtuese t'Indoevropjanëvet, të cilët kanë vërshue kohë mbas kohe të gjitha gjuhët tjera mediterane. Këto dý shtylla janë: kaukazishtja në lindje dhe baskishtja, nji fazë e ré e iberishtes, në prendim.

47. Në këte zonë mediterane, padyshim, hỳn edhè Ballkani Veriuer ku ka qenë atdheu i hershëm i Shqiptarëve (shih § 40), dhe ku, sa në lindje aq edhè në prendim, çfaqen toponime të vjetra të ndërtueme me sufiksin mediteran si psh. *s(s)* — krahasò *Arnisa* (afër Durrësit), *Naïssus* (në Dardaní), *Turissa* (në Maqedoní), *Almissa* (në Dalmací) sufiks i cili âsht panmediteran (krahasò *Larissa* në Greqí dhe n'Italín Qendrore, *Erbessos* në Sicilí, mandèj *Iturissa*, *Segissa*, *Salpessa* në Gadishullin e Pirenejve) ose *-ua* n'êmnat e qyteteve si *Butua* (sot Budva) dhe *Malua* (në Dakí) — krahasò në ligurishten *Senua* dhe n'iberishten *Ascua*, *Burdua*, *Cartua* etj. mandèj sufiksi *-anna* n'êmnin paraindoevropjan të lumit Buna *Barbanna* (krahasò êmnin identik të lumit në Francë *Barbanne* (Gironde) dhe

[1]) Krahasò Schrijnen, *La „Lautverschiebung" germanique et la théorie alarodienne*: *Mémoires de la societé linguistique de Paris* 1926.

êmnin e vjetër të lumit Sermanë — *Sermanna).* E njâjta gjâ vlen edhè përsa i përkèt sufiksit *-sta* n'êmnin parailirjan të qytetit Sisak — *Segesta* (krahasò *Segesta* në Sicilí dhe êmnin ligurjan të vêndit *Segesta*, sot *Sestri di Levante*), sufiksit thrakas *-esk-* (krahasò *Drabesces, Garesces:* iberisht *Comenesci gens, Edesco* etj.), morfemes *p* n'êmnin fisuer epirotik *Kassopoi* dhe në sufiksin e pluralit të kaukazishtes *-p-* në *Kaspioi*, elamisht *Mata-pe* „Medijasit" etj.; aqmâtepër, përsa u përkèt disa sufikseve — deri vonë, të konsiderueme si sufikse tipike indoevropjane, karakteristike për thrakishten dhe ilirishten — të cilat, janë zbulue si sufikse mediterane, psh. *Albōna* (n'Istër), *Salōna* (në Dalmací) dhe ligurisht *Dertona*, ose sufiksi *-nt* n'êmnat (para)ilirjanë të vêndeve që tregojnë përkatësí, fqinjësí, pozitë gjeografike (krahasò psh. êmnin ilirjan të vêndit *Taranto* n'Italín Jugore, nxjerr me *nt* prej êmnit të lumit t'afërm *Tara*, që nuk mund të ndahet prej *-nd* t'egjeishtes as prej *-nt* të ligurishtes — *Pergantio, Joventio mons, Bergentium),* as prej *-nt* dhe *-nd* në toponimet e Gadishullit Iberik si psh. *Cascantum, Lucurgentum, Saguntum* dhe *Aurunda* (n'Asturí), *Gerunda* (ndërmjet Barcelonës dhe Pirinejve) etj. Përveç këtyne sufikseve, për karakterin mediteran të parailirishtes dhe parathrakishtes flasin, në mënyrë të pamohueshme, edhè toponimet identike, psh. përveç êmnave të përmêndun të lumejve *Barbanna* dhe *Tara* dhe t'êmnit të vêndit *Segesta* gjithashtu edhè ilirisht *Astura* (ndërmjet Norikut dhe Panonís), thrakisht *Bela-stura-s*, êmni i njij lumi që derdhet në lumin Po n'Italín Veriore, *Stura* dhe êmni i lumit *Astura* në Gadishullin Iberik, mandèj ilirisht *Arba* (sot Rab) n'Adriatikun Veriuer dhe *Arbion óros* (në Kretë), maqed. *Turissa* dhe iber. *Iturissa*, êmni thrakas i lumit *Almus* (në Moesia inferior — sot *Lom*), ligur. *Alma*, êmni ilirjan i vêndit *Celeia* (sot Celje në Slovení) dhe êmni fisuer ligurian *Celeiates* etj. etj.[1]). Në lidhje me këte âsht me rândësí se në shum raste mund t'interpretohet edhè mbaresa paraindoevropiane e toponimeve me anë të apelativeve mediterane — krahasò psh. maqed. *Turissa*, iber. *Iturissa:* bask. *iturri* „burim", ilir. *Asimos* (sot shqip *Ishmi*), êmni thrakas i lumit *Asamos* (sot *Osăm*) që duhet të ketë kuptimin „gurishte" për shkak të greq.

---

[1]) Krahasò sidomos A. Trombetti, *Saggio di antica toponomastica mediterranea: Arhiv za arban. starinu* etj. III (1926) 1—116; botim i dytë në *Studi etruschi* XIII.

*asáminthos* që âsht paraindoevropjane jo vetëm për shkak të sufiksit *-inth*, por edhè sepsè mbaresa identike âsht ruejtë n'apelativin e sumerishtes *asam* „enë guri për ujë"[1]).

48. Sadoqë të jetë i vogël numri i fjalëvet të thrakishtes dhe ilirishtes shënue nga shkrimtarët antikë, midis tyne gjindet nji varg fjalësh të cilat, padyshim, janë me prejardhje mediterane, si psh. fjala thrakishte *salía* „lule dhije": ligur. *saliunca*[2]), ose ilir.-lat. *mannus* (prej *mandus*) „kalth", êmni mesapo-ilirjan i hyjnís *Jupiter Menzana*, të cilit i flijoheshin kuajt; shqip *mâz* (tosk. *mëz, mëzë*) bask. *mando* „mushk"[3]). Prandèj kuptohet vetëvetiu se në fjalorin e gjuhës shqipe, edhè në gjêndjen e sotshme të gjurmimevet etimologjike, âsht konstatue nji numër bukur i madh reliktesh paraindoevropjane, si janë psh. shqip *(h)ardhí*: bask. *ardao* „vênë"; *bisht*: bask. *buztan*; *brenë*: iber.-rom. *brenia* (në spanj. *breña*); *gashtër*: bask. *gestera*; *karpë*: bask. *karbhe*; *kërmill* (me *i* prej *y*): paragreq. *akramylla*; *koran*: bask. *arraim karri*; *mal*: bask. *Malh*; *shegë*: bask. *sagar* „molla", kauk. *žagar*; *sh-kabë*: etrur. *capys*; *sh-kurrë*: bask. *ez-kurr*[4]), *sherp*: paralatinisht *sirpium*.

Shkaku që disa fjalë të lashta indoevropjane kanë humbë në gjuhën shqipe duhet kërkue, patjetër, në ndikimet e substratit paraindoevropjan në këte gjuhë. Kështu fjalën e stërlashtë indoevropjane *sūnus* „bir" (§ 16) e ka zâvêndësue fjala *bír*, kurse êmnin **dhughə₁tēr* „bijë" fjala *bijë* të cilën e gjejmë edhè në mbishkrimet ilirjane (venet. *bila*, mesap.-ilir. *bilia*)[5]). Po me këto ndikime shpjegohet, me shum gjasë, pse në gjuhën shqipe fjala *motër* nuk ka kuptimin „nânë" që ka në gjuhët tjera indoevropjane, por

---

[1]) Përsa i përket iberishtes, këte rrugë ka ndjekë W. von Humbolt, *Prüfung der Untersuchungen über die Urbewohner Hispaniens vermittelst der Vaskischen Sprache*, Berlin 1821. Për *Asamos* krahasò Oštir, *Arhiv za arban. star.* II (1925) 348.

[2]) Oštir, *Arhiv za arban. star.* II/2 (1925) 306; V. Bertoldi, *Archivum Romanicum* X (1926) 201; *Archivio glottologico ital.* XXII—XXIII (1929) 500.

[3]) Krahasò G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, 267; Schrader, *Reallexikon der indogermanischen Altertumskunde.*

[4]) Krahasò, A. Trombetti, *Le origini della lingua basca*, Bologna 1925, 154 e vazhdim, dhe sidomos Oštir, *Beiträge zur alarodischen Sprachwissenschaft* passim.

[5]) Krahasò, H. Barić, *Lingvističke studije*, Sarajevo (1954) 57.

„motër", sepsè në terminologjín familjare të shqipes ka ushtrue ndikim sistemi matriarkal mediteran, i cili shihet aq qartë edhè në gjurmat *couvade*[1]). Edhè gjurmat e sistemit vigesimal të numrimit (dy zet, tri zet, katër zet = 2×20, 3×20, 4×20) sikundër në lindjen mâ të largtë të zonës gjuhësore alarodike, në sumerishten (*ni-min* „40" = 20×2, *nimn-u* „50" = *ni-in* 20×2+10) dhe në prendimin mâ ekstrem, në baskishten *berr-ogei* „2×20", shpjegohen me ndikimet mediterane. Me këto ndikime intensive përputhet krejtësisht edhè veprimi artikulator i substratit, edhè zâvêndësimi i *media* me *tenues fortis*, çfaqje e cila âsht edhè ilirjane dhe na përkujton etrurishten, edhè pallatalizimi i *a*-s, në *e*, *ō*-s në *e* (nëpërmjet të *ö*) dhe *ū*-s në *ü* (shih § 30). Nuk duhet përjashtue mundësija që kalimi thrako-shqiptár i *kt*-ës në *t* (shih § 43) të jetë mediteran, sepsè ai âsht edhè i etrurishtes (*utave*), dhe sigurisht edhè i iberishtes, sikur shihet nga fakti se êmnat e keltishtes si *ambactus* në Spanjë marrin trajtën *Ambatus*, edhè i kretishtes ku *tt*-ja âsht zâvêndësim i togut të vjetër *kt*. Me ndikimin e substratit mediteran disa shpjegojnë edhè sonorizimin në gjuhën shqipe të *k*, *p*, *t* mbas konsonantit nazal (krahasò *ngarkòj* prej lat. *incaricāre*; *këndoj* prej lat. *cantāre*, *mbret* prej lat. *imperātor*). Kỳ sonorizim âsht zbatue saktësisht edhè në greqishten e ré (krahasò *ángyra* prej *ankyra*, *tombatéra* prej *tòn patéra*, *pénde* prej *pénte*), prej nga ka dëpertue kỳ shqiptim në maqedonorumanishten, për të cilën arsye disa tjerë mêndojnë se ai âsht shtrî gjithashtu edhè në shqipen[2]). Por, meqenëse kỳ sonorizim âsht jo vetëm i toskënishtes, por i shqipes në përgjithësí, i thrakishtes, iliromesapishtes, dhe nji vetí e stërlashtë e gjuhëve t'Azís së Vogël, âsht për tu besue mâ tepër se ka origjinë mediterane, dhe se âsht përhapë nëpërmjet të greqishtes, thrakishtes dhe ilirishtes. Kështu shpjegohet edhè fakti se kỳ sonorizim âsht edhè i Italís së Jugut (*tembo* për *tempo*) dhe i umbrishtes (*juenga* prej lat. *juvenca*, *ander* prej lat. *inter*).

---

[1]) Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 25 e vazhdim.
[2]) Skok, *Zeitschrift für romanische Philologie* XLVIII, 410.

## VI.

## EPOKA LATINO-ROMANE. HIPOTEZA GOTIKE.

49. Kontributi latino-roman në fjalorin e shqipes âsht aq i madh sa rândësija e ndikimeve latino-romane në gjuhën shqipe – n'ate fazë albanologjije, në të cilën gjurmimet shkencore të shqipes, me qëllim njohjeje të tipit gjuhësuer të shqipes genuine, kanë qëndrue në shêj ndamjeje t'elementeve të hueja, — âsht tejçmue aq shum sa që shqipja âsht konsiderue si nji gjuhë e përzieme në kuptimin e plotë të fjalës, dmth. „nji gjuhë gjysëmromane", madje jo vetëm përsa i përkèt fjalorit, por edhè përsa i përkèt gramatikës së saj, e sidomos morfologjís. Këte rrugë ka marrë, fatalisht, edhè vetë Franz Bopp-i, i cili pikërisht në mbështetje të disa kriterjumeve morfologjike ka konstatue karakterin indoevropjan të gjuhës shqipe[1]), kurse Gustav Meyer-i, tue ndjekë këte gjurmë, âsht mundue me provue ndikimin tepër të madh të latinishtes në trajtesën e tij specjale mbi morfologjín shqipe[2]) si edhè në lavrimin e elementeve të latinishtes në gjuhën shqipe në botimin e parë të *Grundriss der romanischen Philologie* të Gröber-it.

Kjo metodë se shqipja ka qenë nji gjuhë gjysëmromane âsht hjedhë poshtë atỳ nga fundi i shekullit XIX-të me qëndrimin kritik që ka marrë ndaj kësaj metode romanisti dhe ballkanologu danez, i ndjeri Sanfeld-Jensen-i[3]) dhe me këthesën që ka bâ bashkëvêndasi i tij, komparatisti Holger Pedersen-i, në lidhje me karakterin e morfologjís shqipe, në trajtesat e veta, kushtue problemevet histo-

---

[1]) *Über das Albanische in seinen verwandschaftlichen Beziehungen: Abhandlungen der Preussischen Akad. der Wissenschaften.* Phil.-hist. Kl. 1854.

[2]) *Miscellanea di filologia e linguistica in memoria di M. Caix e U. A. Canello*, Firenze (1886) 103 e vazhdim.

[3]) *Nordisk tidskrift for filologi* III, r. 3, 105 e vazhdim.

riko gramatikore të gjuhës shqipe dhe në hŷmjen e studimit të tij fundamental mbi dialektin e çamërishtes[1]). Në përpunimin që i ka bâ Meyer-Lübke elaboratit të G. Meyer-it mbi elementet e latinishtes, në botimin e dytë të *Grundriss-it* të Gröber-it (Strassburg 1907) janë eliminue të gjitha latinizmat, me përjashtim të njij rasti të vetëm, të cilat i kish numrue në morfologjín e shqipes G. Meyer-i dhe âsht hjedhë poshtë gjithashtu edhè teorija e Bopp-it mbi origjinën latine t'aoristit me *-va* (*këndova*: lat. *cantābam*). Me plotësimet që i ka bâ Pedersen-i kësaj vepre të Meyer-Lübke-s[2]) ka ra poshtë edhè mêndimi se të gjitha sistemet modale (si psh. optativi i aoristit) si dhe kategorija verbale mâ e shpeshtë e shqipes me *-on* janë me origjinë latine. Rezultati i fundit në të cilin ka mërrijtë Pedersen-i âsht — se në fleksjonin e shqipes nuk ka aspak ndikime latine. Dhe kjo âsht gjâ e pamohueshme.

Sadoqë Meyer-i ka tejçmue ndikimin latin edhè në ndërtimin e fjalëve në gjuhën shqipe (në pjesën e dytë të veprës së tij *Alban. Studien*[3]), në gramatikën e tij të shqipes[4]) dhe në fjalorin e tij etimologjik të gjuhës shqipe[5]), disa ndikime të latinishtes në ndërtimin e fjalëve në gjuhën shqipe prapseprap, padyshim, janë të pamohueshme[6]).

Në sintaksë, e cila edhè sot e kësaj dite âsht fusha e lavrueme mâ së paku në gjuhën shqipe, në konceptin e vjetër mbi karakterin e dyfishtë të shqipes si „gjuhë gjysëmromane" këthehet Max Lambertz-i në punimin e vet mbi fjalín hipotetike[7]), tue lânë në harresë, në lidhje me këte, se përkimet sintaksore shqiptaro-romane nuk implikojnë origjinën romane, madjè, sidomos sepsè

---

[1]) *Albanische Texte mit Glossar*, Leipzig 1895: Abhandlungen der Sächsische Gesellschaft der Wissenschaften. Phil.-hist. Kl. 153.

[2]) *Jahresberichte über die Fortschritte der romanischen Philologie* IX/1, 206 e vazhdim.

[3]) *Sitzungsberichte der Wiener Akad.* Phil.-hist. Cl. 107/I, 1884

[4]) *Kurzgefasste Grammatik der albanesischen Sprache*, Leipzig 1888.

[5]) *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg 1891.

[6]) Për shqipen Pedersen-i (o. c, 212) ka rivendikue formimin e fjalëve me *-im*, Jokl-i prefiksin *sh-* (prej indoev. **sm̥-*) dhe sufiksin *-së, ë* (*Studien zur alban. Etym. und Wortbildung* 9, 102 e vazhdim); Barić-i *-onje* (*Albanorum. Stud.* I, 71).

[7]) *Indogermanische Forschungen* XXXIV 1 e vazhdim.

këto „përkime shqiptaro-romane" gjinden edhè në gjuhët sllave jashtë Ballkanit (në rusishten dhe çekishten) madjè edhè — në gjermanishten e sotshme.

50. Në Gadishullin Ballkanik janë zhvillue dý gjuhë romane: romanishtja[1]) në mbrendësín e tij dhe „dalmatishtja", dmth. gjuha indigjene (paravenecjane) në bregdetin linduer t'Adriatikut në qytetin Kërk, që âsht ruejtë deri në fund të shekullit XIX-të, madjè edhè në qytetet e Dalmacís deri nga fundi i kohës së mesme[2]). Romanisht kanë folë edhè në qytetet e Shqipnís së Veriut, ku Romanët e fundit përmenden në Drishtë gjithashtu kah fundi i kohës së mesme[3]). Prandèj, vetëvetiu, na parashtrohet pyetja: cila âsht pozita e gjuhës shqiptaro-romane ndaj rumanishtes, në nji anë, dhe ndaj gjuhës romane bregdetare (dalmatine) n'anën tjetër.

50. Vetít — të përbashkta për mbarë latinitetin ballkanik — të gjitha papërjashtim janë arkaike, e këto janë: ruejtja e *-c-*, *-t-*, *-p-*, *-s-* intervokale latine (psh. rum. *-ată*, shqiporoman. *atë*, dalmjug. *-ata*, në kërkishtën *-uóta* prej lat. *-ata* etj. dhe humbja e *-s* së fundit, që âsht nji inovacjon latin[4]). Mêndimi i Meyer-Lübke-s se *-s*-ja latine ka qenë e ruejtun në periudhën kur në gjuhën shqipe kanë hŷ elementet latine mâ të lashta, âsht krejt i paqëndrueshëm. Kŷ mbështetet në hipotezën se *b*-ja, në fjalën shqipe *remb* prej lat. *ram(u)s*, âsht tingull kalimtár midis *m*-ës dhe *s*-ës[5]), kurse *g*-ja në fjalën shqipe *peng* me futjen e *g*-ës midis *n*-ës (lat. *piŋnus* prej *pignus*) dhe *s*-ës mbas râmjes së *u*-s[6]) gjâ që âsht e pamundun, si na tregon shqipja (dial.) *sheng* prej neutrumit të latinishtes *signum* ku as që mund të flitet për *s*-ën e fundit.

---

[1]) Në lidhje me këte sot janë të gjithë të njij mêndimi, madjè edhè përkrahësit e teoris mbi kontinuitetin e popullsís së mbetun romane në Dakí edhè mbas evakuimit të popullsís nga Aurelie, krahasò E. Gamillscheg, *Zur Herkunftsfrage der Rumänen* 15.

[2]) M. Bartoli, *Das Dalmatische* 131—132.

[3]) M. Šufflay, *Statuta Drivasti*: *Biblioteka Arhiva za arban. star., knj.* IV, 15 e vazhdim.

[4]) Krahasò G. Mohl, *Introduction à la chronologie du latin vulgaire* 112; M. Bartoli, *Alle fonti del neo-latino*: *Miscellanea Hortis* 345.

[5]) Gröber's *Grundriss der romanischen Philologie* 1 1050. Kështu edhè Jokl-i, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereich des Albanischen* 27; id. *Arhiv za arban. starinu* 1, 1923, 3.

[6]) N'artikullin: Alb. *peng*: *Arhiv za arban. starinu* III (1926) 205—206.

Fjala e lashtë shqipe *tremb:* greq. *trémō* edhè shqip *melemb* prej arabishtes *melemm* tregojnë qartë se *b*-ja e fundit në fjalën shqipe *rëmb* nuk âsht tingull kalimtar, porsè në shqipen âsht bâ zgjatimi i *m* së fundit mbas ramjes së vokalit etimologjik të fundit *u*, dhe mandèj do të jetë bâ desimilimi *mm* në *mb*, poashtu si në fjalën shqipe *pelind* prej sllav. *pelin*, ku *nn* dentale e zgjatueme âsht desimilue në *nd; nn* në fjalën shqipe *sheng-u* ka pasë nji natyrë tjetër, sepsè *gn* etimologjike në lat. *signum*, për shkak të karakterit velar të tingullit *g* para *n* qysh në gjuhën latine ka kalue në *ŋn*[1]). Rruga prej *ŋn* në *ng* âsht gjithashtu desimilim[2]).

52. Mirëpo, inovacjone të përbashkta rumune dhe dalmatino-shqiporomane nuk ka. Si nji inovacjon i këtillë âsht konsiderue, për nji kohë të gjatë, labjalizimi e velarevet në togjet latine *ct* dhe *x (ks)*[3]) i cili âsht krejtësisht isofon shqiporomano-rumun unitár ndërsa në dialektet dalmatine togjet latine *kt, x* nëse nuk janë ruejtë (shih § 43), kalojnë në *it, is* — *lâịte* (= lat. *lactes*), *fróịt* (= lat. *frūctus*) në dialektin e Kërkut, dalm. *tráita* = lat. *tracta* (në gadishullin Peleshac) edhè êmni i ishullit *Maisan*, (në të njâjtën zonë) — quejtë simbas kishëzës së shën *Maksimit* (= lat. *Maximus*), me *is* romane prej lat. *x (ks)*, me kalimin e *ĭ* në *a* në sërbokroatishten (krahasò sërb. *tanak* prej sllavvj. *tĭnŭkŭ*: lit. *tinkùs*) dhe me zâvendësimin e *-n-*ës me *m* në çakavishten (çak. *govorin*: shtokavisht *govorim*[4]). N'elementet romane të gjuhës shqipe krahas me *ft* për lat. *kt* çfaqet edhè *it*, krahasò psh. *drejtë* prej lat. *directus*; *trajtónj* prej lat. *tractāre*; fjala shqipe e lashtë *fryit* (Cuneus prophetarum 1685) prej lat. *frūctus*, ndërsa *pt, ps* në gjuhën rumune janë i vetmi zâvendësim i togjeve latine *ct, x*, krahasò rum. *drept* = lat. *directus*, *frupt* = lat. *frūctus*.

Mêndimi se dyllojshmënija e reflekseve të latinishtes *ct, x* në shqipen âsht kushtëzue nga ngjyra e vokaleve paravûse dmth. se *k*-ja

---

[1]) Krahasò Leumann-Hofmann, *Lateinische Grammatik* 57.

[2]) H. Barić, *Uzajamni odnosi balkanskih jezika* I. 16. Për desimilimin në *pelind* krahasò M. Vasmer, *Studien zur albanesischen Wortforschung* 29.

[3]) Bartoli, *Das Dalmatische* I 297; S. Puşcariu, *Locul limbii române intre limbile romanice* 27; Skok, *Zeitschrift für roman. Philologie* LIV 424; von Wartburg, *Die Ausgliederung der romanischen Spracnen*, ibid. LVI 281.

[4]) Krahasò, Barić, *Južnoslovenski filolog* III (1922/23) 209 dhe *Uzajamni odnosi balkanskih jezika* 21.

para *t, s*, mbas vokalevet qiellëzore pallatalizohet, dhe mbas vokalevet labjale kalon në labjal[1]), nuk pajtohet me lândën gjuhësore të shqipes (krahasò geg. *diftòj*, tosk. *diftónj* prej latinishtes *dictare*), gjithashtu as thânja se për *ct* mbas *a*-s çfaqet vetëm *it*[2]) (krahasò *t(r)aftăr* „hinkë" prej lat. *tractārium* krahas me *trajtój* prej lat. *tractāre*).

Simbas mêndimit tim, zâvêndësimi i togjeve *ct, x* me *ft, fš* në fjalët shqipe me prejardhje latine âsht mâ i lashtë, kurse zâvêndësimi *it, is* âsht mâ i ri. Kjo don me thânë se kanë egzistue dý shtresa elementesh romane kronologjikisht dhe gjeografikisht të ndame në gjuhën shqipe, njâna me *ft, fš* n'atdheun e vjetër të Shqiptarëve në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik, në lidhje me elementin roman, në të cilin âsht formue populli dhe gjuha rumune, dhe tjetra me *it, is* në kontaktin mâ të ri të Shqiptarëvet me Romanët bregdetarë mbas ardhjes së Shqiptarëvet në bregdet, gjâ që sot përgjithësisht konsiderohet si vênd jetese mâ i vonshëm i Shqiptarëvet[3]).

Togut *ft* në shqipen *t(r)aftár, koftor*, si dhe *fsh* në fjalën shqipe *kofshë* i përgjigjet zâvêndësimi fonetik *pt, ps*, i këtyne togjeve në rumanishten e lashtë (krahasò rum. *treaptă* = lat. *trajecta, cuptór* = lat. *coctórium, coapsă* = lat. *coxa*), kurse refleksit *it* për lat. *ct* (në shqipen e lashtë *fryit* = lat. *frūctu*, shqip *drejtë* = lat. *directus*, *trajtónj* = lat. *tractāre*, *pajtòj* = lat. *pactāre*), i përgjigjet zâvêndësimi i *it* në dalmatishten e vjetër në kërkishtën *fróit* = lat. *frūctus*; *láite* = lat. *lactes*, dalm. e jugut *traita* = lat. *tracta*. Për saktësín e këtij mêndimi flet edhè fakti se edhè përjashtimet në shtresën e parë rumunoshqiptare janë identike, — krahasò *š* (në vênd të *fš*) në shqipen *lëshoj* dhe *s* (në vênd *ps*) në rum. *lasá* (prej lat. *laxāre*), *t* (në vênd të *ft*) në shqipen *fluturòj* dhe rum. *t* (në vênd *pt*) në rum. *fluturá* (= lat. *fluctulāre*). Në lidhje me këte përkim âsht karakteristik edhè fakti se në gjuhën shqipe togut të latinishtes *-nct-* në disa fjalë i përgjigjet *-mt-*, njilloj si në rumanishten (krahasò shqip *gjymtyrë* = lat. *junctūra* — rum. *unt* = lat. *unctus*) përkundruell *-nt-* në shqipen *shën(t)*, dalm. *sant* (> sllavvj. *sǫt-* > sërb. *sut-*) prej lat. *sanctus*.

---

[1]) Krahasò von Ettmayer, *Beihefte zur Zeitschrift für romanische Philologie* 26, 10; Meyer-Lübke, *Mitteilungen des rumänischen Instituts in Wien* 1; Sanfeld, *Linguistique balkanique* III 64 e vazhdim.

[2]) Jokl, *Revue international des études balkaniques* II 271.

[3]) Jokl, *Albaner* në *Reallexikon der Vorgeschichte* t'Ebert-it, I, 90; M. Vasmer, *Zeitschrift für slav. Phil.* V 280.

Në dyllojshmënín e reflekseve të togjeve latine *velar + dental*, ndihet, me shum gjasë, ndikimi i substrateve të ndryshme: i iliro-shqipes, në Bregdetin Adriatik dhe i thrako-shqipes, në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik. Faza ndërmjetëse midis lat. *ct* dhe *it* të romanishtes bregdetare ka qenë, sigurisht *h*-ja dhe ajo âsht ruejtë në êmnin e perendeshës veneto-ilire *Rehtia* (Este): lat. *rectus*, greq. *orektós*[1]). Nga ana tjetër, zâvêndësimi i velareve para *t*, *s* me labjale, shpjegohet me reaksjonin e gjuhës shqipo-thrakishte, ku togjet indo-evropjane *kt*, *ks* kanë qenë të thjeshtësueme qysh në periudhën paralatine (§ 43) kundër njij togu jo të zakonshëm për këte gjuhë[2]). Se togu *ct* nuk ka qenë i pranueshëm në substratin thrako-shqiptár, në të cilin âsht zhvillue gjuha rumune unitare, e tregon qartë metateza e lat. *pecten* në **kepten*, prej nga ka rrjedhë trajta dialektore istro-rumune *căptir*[3]).

53. Dyllojshmënija e shtresës romane, kontinentale dhe bregdetare, shihet edhè në vetí tjera. Vetëm kështu mund të shpjegohet që në disa fjalë shqipe me prejardhje latine, *a*-ja e latinishtes mbetet e pandryshueshme, njilloj si në rumanishten (krahasò shqip. *shtrat*, rum. *strat* = lat. *stratum*) ndërsa në disa fjalë tjera latine, *a*-ja latine âsht zâvênsësue me *e*, njilloj si në dalmatishten e jugut, krahasò shqip *qytet* = lat. *civitáte*; *mbret* = lat. *imperátor*; *heshtë* = lat. *hasta* — dalmjug. *lena* = lat. *lana*); *remo* = lat. (*ae*)*rámen*; *pen* = lat. *pane*; *chesa* (lexò *kesa*!) = lat. *casa*. Kjo dyllojshmëni e shtresës romane në shqipen, rumanishten unitare dhe dalmatinobregdetare shihet qartas edhè në reflekset dyfishe të *ŭ* së latinishtes. Në gjuhën rumune âsht ruejtë ndryshimi kualitativ midis *u̯* së latin. vullgare (*ŭ* së latin. klasike) dhe *o̯* (*ŏ*-s së latinishtes klasike) — krahasò rum. *tucă* (lat. *bŭcca*) — *nod*

---

[1]) Krahasò Vetter, *Messapische und venetische Wortdeutungen*: *Glotta* XX (1931) 39 dhe 73.

[2]) Meyer-Lübke, o. c. I, 21; Rosetti, *Bulletin linguistique* III, 74.

[3]) Krahasò veprën time *Uzajamni odnosi balkanskih jezika*, 31. Orvatja e fundit e A. Vaillant-it, *Bulletin linguistique* XIV (1946) 8 e vazhdim, që të konstatojë se *ht* âsht fazë ndërmjetëse midis *ct* të lat. dhe *pt* të rumanishtes ka shkue krejtësisht huq. Êmni bullgar *Doxs* dhe bullg. *doxtor-* „nënkresë" në të cilat ai mbështetet nuk janë reflekse të fjalëvet latine *dŭx* dhe **ductārius*, por fjalë të huamarruna të turqishtes së lashtë — bullgarishtes *doxs* „derr" dhe *doγdor* „nënkresë", gjâ që ka vû në dukje para mjaft kohe M. Mikkola, *Journ. Soc. Finno-Ougr.* XXX, 33, 11 e vazhdim.

(= lat. *nōdus*). Me këte përputhet plotsisht fjala shqipe *bukë - nej*, por n'elementet romane të gjuhës shqipe ka shêmbuj mâ të sigurtë, në të cilët *ŭ*-s latine i përgjigjet *o*-ja: *zmojle* = lat. *exmŭlgia*; *groft* = lat. *crŭpta*, njilloj si *ŭ*-ja në reflekset e latinishtes vullgare në mbishkrimet e Dalmacís romake: *avoncolo* [= lat. klas. *avŭnculo*, CIL III 8465; Narona] dhe në dialektin dalmatin të gjuhës së vdekun të Kërkut, ku reflekset e latinishtes *ō* dhe *ŭ* janë identike me diftongizimin shum të vonshëm të *ō*-s në *áu* (: *náuk* „arrë" = lat. *nŭce*; *j-áura* „orë" = lat. *hōra*).

54. Me këte dyllojshmëní të shtresës romane në gjuhën shqipe shpjegohen edhè përkimet e vjetra leksikore midis gjuhës së vjetër dalmatine dhe shqiptaro-romane më nji anë dhe shqiptaro-romane e rumune n'anën tjetër. Kështu në fjalën rum. *creier*, shqip *krie*, *krye* âsht ruejtë trajta e vjetër latine *cérebrum*, të cilën, në dalmatishten e vjetër, e ka zâvêndësue trajta e ré e zgjânueme *cerebéllum* = kërkisht *karvjál*; rum. *cúscru* dhe shqiporomanisht *krushk* kanë lidhje me fjalën lat. *cónsocer* përkundruell dalm. *conségro* (*Dalmatisch* 1, 279; II, 268, 407) prej lat. *consócer*. Në lidhje me këte shtresë dyfishe të romanizmavet në gjuhën shqipe, mâ në fund, janë shum të rândësishme edhè ndryshimet karakteristike në kuptimin e fjalëve latine, të cilat janë të përkufizueme vetëm në rumanishten dhe shqipen, si psh. rum. *cuvînt* „fjalë, bisedim", shqip *kuvênd* (lat. *conventus*) ndryshe prej fjalës lat. *parábula* në dalmvj. *palaure* (ishulll Kërk); krahasò edhè rum. *drac* „djáll", shqip *dreq* prej lat. *draco* „drangue"; rum, *merge* „me (h)ecë"; shqip *mërgónj* prej lat. *mergĕre* „me u fundosë". fjalë të cilën Puşcariu, me mêndjepreftësí, e bie në lidhje me të zdjergunit e barijve nga malet në vërrî[1]); fjala rum. *padure*: shqip *pýll* (**pë/d/yllë*) prej trajtës metatetike të latinishtes vullgare *padule* për shkak të kuptimit „pylli" (e jo „këneta" si në dalmatishten) tregon qartas se rrethanat topografike specifike, të përbashkta për të parët e Shqiptarëvet dhe Rumunëvet, kanë mërrijtë të mundësojnë këte ndryshim kuptimi karakteristik. Në këto paralele semantike shqiptaro-rumune hŷjnë edhè: shqip *kûj*, rum. *cuiu* prej lat. *cuneus*; shqip *kursej*, rum. *a cruța* „me kursye" prej lat. *curtiare* „me shkurtue"; shqip *v(ë)nér*, rum. *venîn* „tâmthi" prej lat. *venēnum* „helm";

[1]) *Locul limbii române* 32.

shqip *urrej* : rum. *a urî* „me urrejtë“ prej lat. *horrere* „me qenë i ngurtë“; shqip *fëlqî(ni)*, rum. *falcă* „nofulla“ prej lat. *falx* „drapën“; shqip *shesh*, rum. *şes* „rrafshinë“ prej lat. *sessum* „selí“; shqip *qërtónj*, rum. *a certá* prej lat. *certāre* „me luftue“; substantivet verbale të fjalëve shqipe *qartë*, rum. *ceartă*; shqip *shkret* : rum. *secret* „i shkretë“ prej lat. *secrētus* ; shqip *shalët* : rum. *şale* „ijët“ prej lat. *sella* „shalë“; shqip *mëngónj* : rum. *a manecà* „me u çue heret“ prej lat. *manicāre* etj. Kỳ paralelizëm semantik, kushtëzue nga simbjoza e vjetër shqiptaro-rumune, shihet edhè në formimin e kalkeve shqipe me kuptime rumune — krahasò psh. shqip *vjet* në kuptimin „vjetin e kaluem“ dhe rum. *an* në përdorimin adverbjal (lat. *anno*) në të njâjtin kuptim.

55. Me këte simbjozë të vjetër shqiptaro-rumune shpjegohen edhè fjalët që rumanishtja i ka huamarrë prej shqipes së lashtë — krahasò shqip *brez* (prej **bren-ze*) > rum. *brîu*; shqip *buzë* > rum. *bu(d)ză*; shqip *bung* > rum. *bunget* „pýll bungu“; shqip *dhallë* > rum. *zară* „tâmbël i prishun“; shqip *fshat* > rum. *fşat* „katund“; shqip *moshë* > rum. *moş* „plak, gjysh“, femnorja *moaşă* „gjyshe“; shqip *mushk* > rum. *muşcoiu*; shqip *sumbullë, thumbullë* : istrorum. *sâmbur*, maqedorum. *sâmbure*, megl. *şemburi*; shqip *bredh* > rum. *brad* (trajta e ré sing. ndërtue prej pluralit *brazi* simbas shëmbullit të fjalëvet me *-d* të singularit, kurse në pluralin me *-zi*, Graur, *Romania* LIII 383); shqip *modhullë*, rum. *mazăre* „bizele“ etj. etj. Për saktësín e vleftës kronologjike të këtyne isoglosavet shqiptaro-rumune, duhet me pasë parasỳsh se ato gjinden në të gjitha dialektet rumune n'epokën historike, gjeografikisht, shum heret të ndame dhe — për këte arsye duhet konkludue se: ndikimi i shqipes në gjuhën rumune âsht krye qysh në periudhën e herëshme rumune. Në lidhje me këte pajtohet plotësisht edhè fakti se në gjuhën rumune janë ruejtë fjalët shqipe në trajtën e tyne fonetike të stërlashtë (rum. *mazăre* me *a* të vjetër e cila në shqipen ka evolvue në *o* : *modhullë*) — me fjalë tjera sepsè ato kanë kalue nëpër të njâjtat ndryshime si edhè fjalët rumune me origjinë latine, krahasò **brenum* = rum. *brîu*, si lat. *frenum* = rum. *frîu*.

56. Krejtësisht në pajtim me teorín e simbjozës së herëshme shqiptaro-rumune në mbrendësín e Ballkanit âsht edhè rrethana se

në dialektet e vjetra romane bregdetare nuk ka gjurma të vetíve të vjetra gjuhësore shqiptaro-rumune. Prej vetíve fonetike, përveç labjalizimit të *k*-ës përpara *t*, *s*, këtu bân pjesë edhè fati i njillojtë i vokalevet të fundit në shqipen dhe rum.: *-e*-ja mbetet; *a*-ja reduktohet në shqipen n'*ë*, në rum. n'*ă*; *i*-ja, *-o*-ja, *u*-ja humbasin; këtu bân pjesë zhvillimi i njillojtë i *a*-s para *n*-ës, që sigurisht nuk âsht çfaqje rumune[1]); në ndërtimin e fjalëve, këtu bân pjesë përkimi i numrave: rum. *al-trei-le* dhe shqip *i-tre-të* për të cilën arsye edhè rum. *un-spre-zece* „11" dhe *duazeci* „12" do të jenë të ndërtueme simbas shêmbullit të shqipes, dhe jo sllavishtes[2]), mandèj sufiksi *-onia* për formimin e femnores prej êmnit të gjinís mashkullore (shqip *ulk—ulkonjë*, rum. *urs* „arí" — *urşoaie* „arushë", prej trajtës së vjetër të ruejtun të dialektit meglenisht *ursoańa* = *urs-ońa*; sufiksi i shqipes *-shor*: rum. *(i)şor*[3]) dhe paralelizmi i sufiksit shqiptar *-uk* dhe *-uq* (*-ok* dhe *-oq*) dhe sufiksit rumun *-uc* dhe *-uq*[4]); në sintaksë, infinitivi i rumanishtes me *a* paravûse simbas shêmbullit sesi përdoret në shqipen (gëgënisht) êmni foljuer, ndërtue prej participit të pà nyje të perfektit me *me* paravûse për infinitiv (rum. *a mâncă*, shqip *me hângër*); mandèj përgjithësimi i foljes „me pasë" si folje ndihmëse në kohën e kalueme të përbâme (shqip *ka vdekë* : rumanisht *a murit*) çfaqje e cila përkundrazi do të jetë me origjinë romane, si tregon përgjithësimi i njillojtë në dialektet e Italís së Jugut[5]) etj.

57. Në vetít e përbashkta shqiptaro-rumune disa numrojnë edhè artikullin postpozitiv, i cili në shqipen sigurisht nuk âsht me prejardhje rumune, as në rumanishten me prejardhje shqiptare, sadoqë njifarë lidhje reciproke, prapseprap, egziston. Graur-i e ndan krejtësisht artikullin postpozitiv prej shqipes, sepsè konsideron se rruga prej lat. *homo* deri në rum. *omul* shkon nëpërmjet fazash: *homo ille-bonus*, *homo-ille bonus*, *homo-ille*, dmth. se artikulli postpozitiv i rumanishtes

---

[1]) Krahasò Gamillscheg, *Zeitschrift für rom. Phil.* XLVIII, 480 — Ndër vetít e përbashkta vokale shqiptaro-rumune disa numrojnë edhè reduktimin e *a* së patheksueme. Por, meqenëse ajo përfshîn edhè fjalët shqipe me origjinë italiane, do të ketë mâ tepër gjasë që kỳ reduktim të jetë nji çfaqje recente, sesa të ketë vazhdue deri në këte epokë kaq të vonëshme.

[2]) Krahasò Meyer-Lübke, *Rumänisch und Romanisch* 26.

[3]) Krahasò Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 312.

[4]) Krahasò Jokl, *Indogermanische Forschungen* XLIV, 53—59.

[5]) Krahasò Meyer-Lübke, *Rumänisch und Romanisch* 16.

ka rrjedhë prej artikullit që ka qenë paravûs i adjektivit (krahasò *Romania* L 475—481). Kỳ koncept, sadoqë parimisht i mundshëm, nuk âsht i besueshëm, sepsè përdorimi prepozitiv në rumanishten âsht i njillojtë si në shqipen. Artikulli prepozitiv *i* (= demostrativi indoevropjan **ei*, **is*, shih § 34) në gjuhën shqipe qëndron midis êmnit dhe mbiêmnit, ose gjenitivit atributiv dhe pajtohet me te në numër, gjini dhe në rasë, krahasò *mal i naltë* „mons ille altus", gjen. (i paskajuem) *mali të naltë*; *bir i mbretit* „filius ille regis", gjenitivi *biri të mbretit*, kurse me artikullin postpozitiv *mal-i i naltë*, gjen. *mali-t të naltë* — rum. *Stefan cel mare* „Stephanus ille magnus", *calul cel frumos* „equus ille pulcher", *inelul cel de aur*, „annulus ille de auro", *calul frumos al vecinului* „equus pulcher ille vicini" etj. Si dihet, shêmbuj me *ille* postpozitive ka edhè në tekstet e latinishtes vullgare (krahasò in ipsa summitate montis *illius*, Peregrinatio Aetheriae 3, 5, speluncam illam, ibid. 3, 7 ubi factus est vitulus *ille*), për të cilën arsye âsht mâ se e besueshme se do të ketë egzistue edhè në latinitetin ballkanik, por përgjithësimi i artikullit postpozítiv në dâm të prepozitivit në gjuhën rumune duhet ti kushtohet, prapseprap, ndikimit të shqipes, përmâtepër, se në gjuhën e vdekun të romanishtes së lashtë të bregdetit tanë (dmth. në „dalmatishten") gjurma t'artikullit postpozitiv nuk ka fare[1]). Gjurma të funkcjonit të dyfishtë të lat. *ille* si demostrativ dhe artikull prepozitiv ka edhè në gjuhë tjera romane[2]). Prandèj âsht *a priori* e besueshme se edhè këtu, si në përgjithësimin e artikullit postpozitiv, ndikimi i shqipes ka kontribue në forcimin e njij tendence analoge në ballkano-romanishten, prej së cilës âsht zhvillue gjuha rumune.

58. Në periudhën e mâvonëshme të marrëdhânjevet shqiptaro-rumune, padyshim, bân pjesë edhè rotacizmi, domethânë kalimi i *n*-ës intervokalike në *r*, kushtëzue edhè në shqipen edhè në rumanishten prej nazalizimit të vokalit paraardhës. Ai ka qenë i njoftun edhè në dialektin e gegënishtes dhe âsht ruejtë deri në periudhën e kontakteve të para sllavo-gege në Shqipnin e Veriut (shih § 41)

---

[1]) M. Bartoli, *Das Dalmatische* I 286—289.

[2]) Krahasò Meyer-Lübke, *Grammatik der roman. Sprachen* III 585, mandèj dalm. *kol* (Bartoli, o. c. II 585), kurse për lat. *ipse* në këte funkcjon sicil. *ssu* Ascoli, *Archivio glottol. ital.* XV, 312 e vazhdim.

kurse prej dialekteve rumune këte çfaqje e njeh vetëm dialekti i rumanishtes së veriut dhe, dega e tij, dialekti istrorumun, gjâ që don me thânë se rotacizmi në rumanishten âsht çfaqë në periudhën kur tashmâ ishte coptue bashkësija teritoriale rumune e lashtë me largimin e dialektevet të rumanishtes së jugut prej fqijësís së shqipes së lashtë në mbrendësín a Gadishullit Ballkanik. Në lidhje me këte pajtohet edhè lajmi i parë historik mbi *Vlahorichínoi* (te Prokopi, De aedificis IV — në shek. e VI-të) si nji fis vllah, tashmâ, i ngulun n'atë kohë në zonën e lumit *Richios*, ndërsa fillimi i këtij migracjoni të grupit rumun të jugut sigurisht do të ketë qenë mâ i hershëm, dmth. — mâ së largu — në gjysmën e dytë të shekullit VI-të, kur ndikimet e shqipes në rumanishten e lashtë kishin marrë fund. Me këte shkëputje të herëshme të Rumunëvet të Jugut shpjegohet jo vetëm mungesa e rotacizmit por edhè fakti se numri i fjalëve të vjetra shqipe të huamarruna në këto dialekte âsht shum mâ i paktë se në rumanishten e veriut[1]).

59. Asht e vështirë të thuhet se deri kur ka zgjatë kjo simbjozë e herëshme shqiptaro-rumune, por sigurisht ajo nuk ka zgjatë deri në shekullin VIII-të si mëndon Jokl-i[2]), ose deri në shekullin X-të si mëndon Friedwagner-i[3]). Mëndimi i Jokl-it mbështetet në hamëndjen se *a*-ja në rum. *gata* „gati" na tregon ndërmjetësín e shqipes midis kësaj fjale dhe sllavishtes *gotovŭ*, sepsè *a*-ja âsht refleks i shqipes i *ovŭ* të sllavishtes[4]), për të cilën arsye ai rekonstrukton trajtën shqipe **gata*. Këte nuk do ta kundërshtonte *a*-ja rrânjore e shqipes ndaj *o*-s së sllavishtes, sepsè *a*-ja e sllavishtes âsht ruejtë madjè deri në shekullin e IX-të[5]), por interpretimi i Jokl-it mbi marrëdhânjet midis *gata* të rumanishtes dhe *gotovŭ* të sllavishtes duhet të hidhet poshtë për arsye se fjala rumune *gata* âsht fjalë indigjene shqipe *gat*, që ka afinitèt me fjalën *ghatatë* t'indishtes së vjetër, *nē-gateos* të

---

[1]) Simbas Philippide, *Originea Românilor* II 712, i cili merr parasŷsh etimologjit e sigurta, në maqedonorumunishten 13, në meglenishten 9 ndaj 25 në dialektin rumun të veriut.

[2]) *Indogermanische Forschungen* L (1932) 41 e vazhdim.

[3]) *Zeitschrift für romanische Philologie* LIV (1934) 683.

[4]) Jokl, *Indogermanische Forschungen* XLIX 254.

[5]) Krahasò Schwarz, *Zur Chronologie von a slav. o: Archiv für slav. Philologie* XLI, 124—136; Liewer, *Einleitung in die historische Gramm. der tschechischen Sprache* I, 10 e vazhdim.

greqishtes[1]), zgjânue me sufiksin adverbjal *a* të rumanishtes. Për datimin shum të vonshëm të ndërpremjes së kontakteve shqiptaro-rumune do t'ishte, me të vërtetë, vêndimtare marrëdhânja tingullore midis fjalës *parâu* të rumanishtes dhe *përrua* të shqipes (prej indoev. **per-ron*) kur për shpjegimin e *-âu* të rum. do të duhej të niseshim prej fazës paraardhëse shqiptare — prej diftongut nazal *-õu*, sepsè ai çfaqet edhè n'elementet sllave të gjuhës shqipe të cilat nuk i përkasin shtresës mâ të lashtë. Mirëpo *âu* në fjalën *parâu* të rumanishtes shpjegohet me ndikimin e fjalës rumune *râu* „përrue" (prej lat. *rīvus*) poashtu si *roj* në fjalën bullgare *poroj* „përrue" shpjegohet me ndikimin e *sŭroj* të sllavishtes me të njâjtin kuptim (të ruejtun në rumanishten *ciroiu* „shê"). Nëse n'anën tjetër *trase* e shqipes âsht *trase* e rumanishtes (prej lat. *traxit*) prej kësaj kurrsesi nuk mund të rrjedhi se kontaktet shqiptaro-rumunoveriore kanë zgjatë deri në shekullin e IX-të ose madjè deri në të X-in, si mêndon Friedwagner-i, sepsè ai nuk merr parasŷsh se fjala *trase* gjindet vetëm në zonën e Gegënís, prej nga del se kjo fjalë rumune do të ketë mujtë me hŷ në shqipen vetëm nëpërmjet të Vllehve të Drinit dhe këta, në këte zonë shqiptare të veriut, janë ngulë sigurisht mbas Sllavëvet[2]). Këte na e tregon *s*-ja e ruejtun në fjalën *trase*, e cila në fjalët e vjetra të sllavishtes të huadhânuna gjuhës shqipe kalon në *š* (Krahasò *Bushtricë* prej sllav. *Bystrica*). Prandèj, shpërngulja e Shqiptarëve nga atdheu i tyne i hershëm dhe ngulja në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik, n'atdheun e tyne historik, do të ketë ndodhë para fundit t'epokës latine, dhe do të jetë bâ herë mbas here — valë-valë — por jo mâ vonë se nga shekulli i VI-të. Shkaku pse burimet historike në lidhje me këte nuk përmendin asgjâ âsht i lehtë të shpjegohet me parândësín politike dhe ushtarake t'ardhjes së masavet barítore të cilat, n'atdheun e rí, për nji kohë të gjatë, nuk vijnë në kontakt intim me popullsín bujqsore dhe qytetare, tue jetue verës nëpër male dhe dimnit tue u lëshue në vërrîje, të largta prej rrjetës së komunikacjonit, njilloj si kanë bâ në periudhën historike edhè Rumunët barij. Në këte mënyrë shpjegohet pse Shqiptarët kanë pranue

---

[1]) Machek, *Ario-Slavica: Zeitschrift für vergl. Sprachforsch.* LXIV 203 e vazhdim.

[2]) Për informata historike mbi këta Vlleh të Drinit krahasò M. Šufflay, *Ungarische Rundschau für historische und soziale Wissenschaften* V, 19 e vazhdim; Th. Capidan, *Români nomazi* 135.

disa êmna bregdetarë shum vonë, si për shêmbull *Durrës*, trajta shqipe e të cilit nuk mund të jetë refleksi direkt shqip i êmnit antik *Dyrrachium*, sepsè në këte rast për *-kį* do të pritshim shqip *-q* (krahasò shqip *shoq* prej lat. *socįus*, *-cį = kį*), kurse *s*-ja âsht zâvêndësim i *č* së sllavishtes (= *Dŭrač*) në shqipen (krahasò psh. fjalën shqipe *porosís* prej. sllav. *porǫčiti*).

60. Gotët kanë mbajtë në duert e veta nji pjesë teritori të Shqipnís së Veriut prej vjetit 396 deri më 535 t'erës sonë. Prandèj qysh prej kohësh R. Loewe[1]) dhe shum mâ vonë N. Jokl-i[2]) âsht përpjekë dý herë të vërtetojë elementet ballkano-gotike në gjuhën shqipe. Mirëpo, midis këtyne fjalëve — nëse këto kanë të bâjnë fare me elementet gjermanike të lashta — shumica dërmuese âsht e atillë, e cila në shqipen ka hŷ ose nëpërmjet të Sllavëve të Jugut (dhe këto janë rendomë elemente gjermanike jashtballkanike) ose — nëse janë gotike — kanë hŷ nëpërmjet të gjuhës rromake ushtarake (si psh. shqip *shkulka* = got. *skulka* „sogjtar, rojë, vëzhgues", termë gotiko-latine e cila âsht ruejtë edhè në sardishten e vjetër *iskolka* dhe në portugalishten e vjetër *escolca*). — Për nji analizë t'imtë etimologjike të këtyne pseudogotizmave, midis të cilave ka edhè fjalë me origjinë të gjuhës latinishte (si shqip *fat* „burrë, bashkëshort" = lat. *fātum*), me origjinë të gjuhës italishte (si psh. gegënisht *fang* „tokë djerrë") dhe fjalë thjesht shqipe (si psh. *afër*, *gjet*, *langjim*, „kapërcim, këcim") si dhe për dallimin e elementeve fort të rralla ballkano-gotike, që kanë hŷ në shqipen nëpërmjet kontaktesh direkte midis Gotëve dhe Shqiptarëve — krahasò të mijat *Lingvističke studije*, Sarajevë, 1954, 87—90; 105—108.

---

[1]) R. Loewe, *Zeitschrift für vergleichende Sprachforsch.* XXXIX (1903) 311 e vazhdim.

[2]) Jokl. *Studien zur albanischen Etymologie und Wortbildung* 107 id. *Linguist. — histor. Untersuch* 15; id. *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen: Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg* 1929.

## VII.

## NDIKIMET SLLAVE.

61. Në shekullin VII-të dhe VIII-të, në nji pjesë rreth Liqenit të Shkodrës (shih § 41) dhe në derdhjet e Bistricës, Vjosës, Devollit Semenit dhe Shkumbinit t'Epërm, në tokën shqiptare, çfaqet nji element i rí etnik dhe gjuhësuer — Sllavët e Jugut. Kỳ element — Sllavët e Jugut — nuk âsht i njinjishëm. Simbas vetivet gjuhësore t'êmnavet topografikë sllavë në teritorin e Shqipnís historike, elementi sllav në krahinën e Shkodrës dhe në krahinën në veri të Drinit të Mesëm ka qenë sërb, kurse ai element sllav i jugut, i cili ishte ngulë në Shqipnín e Mesme dhe të Jugut, âsht i grupit gjuhësuer maqedono-sllav. Kjo shihet mâ së miri në reflekset e dyllojshme të **tj* ( = indoev. *kt*) dhe të **dj* sllave të përgjithëshme në njânën dhe tjetrën krahinë, — khs. *Peć* „katundi Pekiani" në krisovulën e St. Dushanit dhânë manastirit arkangjelik në Prizrend (Novaković, *Zakonski spomenici* 688) prej **pekt*-sërb. *peć* dhe *šč* n'êmnin e kodrës bregdetare *Peščera* në verí të Vjosës dhe n'êmnin e malit *Pešter* në verí t'Elbasanit, *Želevižda* (në krahinën e Beratit). E njâjta dyllojshmëní shihet edhè në fjalët shqipe me origjinë sllave të jugut, krahasò shkodranisht *megje* prej sërb. *međa* përkundruell shqipes së jugut *mezhda* prej maqedonishtes së jugut *mežda* me *žd* prej sllav. **dj*. Orvatjet që *ć* ja e sërbishtes (prej **tj* të sllavishtes) të vërtëtohet edhè në jug të Shqipnís kanë shkue huq krejtsisht: toponimet në shqipen epirjane *Krie-Kuqi, Hundo-Kuqi,* — fjalë të cilat disa sllavista, tue ndjekë rrugën e Hilferding-ut[1]) i identifikojnë me fjalën sërbishte *kuća* (prej sllav.

---

[1]) *Starin. poselenija Slavjan na grč. zem.* 1859; P. A Lavrov, *Žurn. Min. nar. prosv.* 1901 (numri i muejit gusht); L. Niederle, *Slovanské starožitnosti* I 442 e vazhdim; A. Belić, *Galički dijalekat*, botim i Akademis serbe, vjeti 1935, f. 18.

origjinare **kǫtja*) dhe këta êmna i shpjegojnë si **Krivo-kući*, **Hudokući* — padyshim vijnë prej fjalës shqipe *kuq* dhe këta êmna, thjeshtësisht shqiptarë, në të vërtetë, janë llagape si *Kryeziu*, *Kryezeze* etj. Krahasò Seliščev o. c. 281. Po kjo vlen edhè përsa i përkèt Shqipnís së Mesme: elbasanisht fjala *domaqin* âsht identike me fjalën maqedone *domakin* (<sërb. *domaćin*,) dhe ka depërtue në Shqipní të Mesme si fjalë shtegtare (sikundër në sërbishtën fjala ungareze *gazda* po me atë kuptim), Gjithashtu bie poshtë edhè mêndimi i Seliščev-it (o. c. 279) se ka gjurma gjuhore bullgare në krahinën e Shkodrës. Sadoqë *e*-ja për gjysëmzânoren e sllavishtes *ĭ* âsht nji vetí e bullgarishtes, kurse *a*-ja refleks sërb i *ĭ*-s sllavishte (krahasò *otěcĭ* : *otec* : *otac*), *e*-ja në *Deniza* (lexò *Denica*) në katistikun shkodrano-venecjan të vjetit 1416, dhe në toponimet me *-ec* (prej sllav *-ĭcĭ*), në verí dhe në verilindje të Liqenit të Shkodrës, si për shêmbull *Gradec*, *Šterbec*, *Buleca* etj. nuk na argumenton kurrgjâ në këte drejtim, sepsè *e*-ja e haptë ( = *ä*) âsht nji zâvêndësim i dialektit malazez në gjysëmzânoret *ĭ* dhe *ŭ* të sllavishtes[1]), të cilavet në maqedonishten u përgjigjen *e*-ja dhe *o*-ja. Kỳ zâvêndësim i të dyja gjysëmzânorevet gjindet vetëm në Shqipnín e Mesme dhe të Jugut, krahasò toponimet *Boz* (prej sllav *bŭzŭ* „shtogu“) në Devollin e Epërm, *Boz-bregas* në jug të Kavajës, *Sop* (prej sllav. *sŭpŭ* „toka e zezë“ — në jug të Pojanit), mandèj sufiksin *-ok* prej *-ŭkŭ* në toponimet *Pŭtok* në jug të Shkumbinit dhe n'apelativet e përkufizueme në këte krahinë, si *çepirók*, *patók*, përkundruell shqipes së veriut *çepérak*, *pátak*. Edhè zâvêndësimi *um* për sllav. *um* n'êmnin e lumit *Osum* të shqipes së jugut âsht maqedon (përkundruell *ăm* n'êmnin e lumit *Osăm* në Bullgarí), krahasò maqedonisht *sedum* „7“.

Seliščev-i âsht i mêndimit se kjo dyllojshmëní e elementit të dikurshëm sllav në Shqipní shihet edhè në togjet e reflekseve sllave *tlt*, *trt* (maqedonisht *tolt*, *tort*) në toponomastikën sllave të Shqipnís, tue vû në dukje fjalën *Molçani* (prej sllav. *mŭlč-*) në zonën e Drinit të Zí, *Helm* (prej sllav. *xülmŭ*) në zonën veriprendimore të Gegënís, gjâ që, padyshim, s âsht e saktë, sepsè me këte nuk âsht në pajtim fjala *Vuk* prej trajtës së mâparëshme *vülk* (krahasò êmnin e sotshëm *Vukatani* dhe *Vulkatani* në katastikun e Shkodrës (vjeti 1416) që çfaqet në nji varg të tânë toponimesh të Shqipnís së Veriut dhe të Mesme, krahasò *Vukaj* (Dukagjin), *Vukli* (Malsija e Madhe),

---

[1]) Krahasò T. Malecki, *Lud Słow.* II A, 1931, 231.

*Vulçani* (qarku i Elbasanit). Prandèj Jokl-i[1]), padyshim, ka të drejtë kur niset nga *ël* e përgjithëshme shqiptare si refleks i *ļ* së sllavishtes (krahasò tosk. *gëlltis* prej sllav. **gļtiti* — në sllavishten kishtare *po-glŭtiti*) prej të cilës *ë*-ja mbas *r*-ës në gegënishten âsht zhvillue njilloj si në fjalën shqipe *furrik* prej **fër-nik* : *farë*[2]).

Në kundërshtim me këte, edhè toponomastika edhè shtrîmja gjeografike e fjalëve sllave të huadhânuna dialekteve të shqipes tregojnë qartësisht dyllojshmënín e elementit sllav të dikurshëm në lidhje me reflekset e vokalevet nazale sllave — *ę* dhe *ǫ* të sërb. në veriprendim zâvêndësohen me *u* për *ǫ* të sllav. — khs. êmnin e katundit *Lug-u* = sërb. *lug* (prej sllavvj. *lǫgŭ*) në juglindje të Pulajt, *gusë* prej sërbishtes *gusa*; *drugë(z)* prej sërbishtes *druga*; *tugë* prej sërb. *tuga*. Në të gjitha krahinat tjera të Shqipnís reflekset shqipe të vokalevet nazale sllave rrjedhin prej maqedonishtes: në juglindje me *ŭ* + *n* (prej **ǫ*) prej nga rrjedh maqed. *on*, *an*, kurse në fjalët e huamarruna shqipe *ën*, *on* dhe *un* — krahasò shqip *orëndí* (sllav. *orǫdiie*), *pëndár* (sllav. *pǫdar*), *trondít* (sllav. *trǫditi*), *sundój* (sllav. *sǫditi*) me zâvêndësimin e *ǫ*-s me *o* (*Dobrova* prej *Dǫbrova*, *Goskova* prej *Gǫskova*) në zonën e Drinit të Zí në verí të krahinës së Dibrës, si dhe në jugprendim të krahinës së Kosturit dhe në krahinën e Liqenit të Prespës (*roka* prej *rǫka*) në të cilat popullsija e dikurshme sllave e zonës Goskov–Položani ka qenë në lidhje të ngushtë, prej nga mund të përfundohet se fjalët e huamarruna të tipit *porosis* (sllav. *porǫčiti*) duhet të rrjedhin prej kësaj zone t'afërt me Dibrën — *ę*-ja e sllavishtes i përgjigjet shqipes së jugut *ën* — krahasò *lëndinë* (sllav. *lędina*), *rëndë* (sllav. *rędŭ*).

Zâvêndësimi shqiptar i *ě*-s sllave âsht *'a*, *ᵉa* – khs. shqip *sanë* prej *sěno*, *carâ* prej *čerěnŭ*. Për juglindjen âsht karakteristik zâvêndësimi i dyllojshëm i *ě*-s sllave: njâna e jotueme (*Ljabova* prej *Xlěbova*) dhe tjetra e pajotueme (*Brag* prej *brěgŭ* pranë Beratit). Skok-u[3]) dhe simbas tij edhè Jokl-i[4]) janë të mêndimit se *a* (*ᵉa*) âsht zâvêndësim i vjetër i përgjithshëm i sllavishtes së jugut i *ě*-s origjinare sllave (khs.

---

[1]) *Slaven und Albaner*: *Slavia* XIII 636 e vazhdim.

[2]) Jokl, *Arhiv za arban. starinu* I (1923) 5.

[3]) *Časopis za slov. jez.* VIII (1931) 118 e vazhdim; shif edhè *Rad Jugosl. Akademije* (1948).

[4]) o. c. 639.

sërb. *orah* prej *orěxŭ*) dhe i *a*-s së depallatalizueme. Mâ tepër do të ketë mundësí që *a*-ja të jetë maqedonizëm, sepsè *ě*-ja e lashtë ka qenë e mbyllun[1]). Prandèj fjala *sanë* do të jetë me origjinë maqedone.

62. Marrëdhânjet intime dhe intenzive sllavo-shqiptare nuk kanë ndodhë me siguri në shekujt e parë të nguljes së Sllavëve të jugut në tokën shqiptare, por kryesisht prej shekullit i XIV-të kur, për rrethana politike e shoqnore, âsht bâ simbjoza dhe bilinguiteti sllavo-shqiptár. Megjithkëte mund të konstatohet deri-diku edhè shtresa mâ e vjetër e elementevet sllave jo vetëm në toponomastikë, por edhè në fjalorin e shqipes, i cili dëshmon për ndikimet shum të ndryshme kulturore sllave. Nji kriter i besueshëm për vjetërsín e këtyne elementevet janë gjurmat e ruejtuna *i* dhe *ŭ* të sllavishtes, krahasò *Dibra* prej *dĭbrĭ*[2]), *druhna* prej sllav. *drŭva*; *shullë*[3]) „shërbtore" (prej sllav. *sŭlŭ* „lajmtár") me të njâjtin ndryshim kuptimi si në fjalën e përbâme sllave *po-sel*[4]), *sule* „lundër" (prej sllav. *čŭlnŭ*)[5]); *u* për sllav. *y* në greko-shqipen *matukë* (prej sllav. *motyka*), *karrutë* (prej sllav. *koryto*), *purrë* (prej sllav. *pyr*)[6]), fjalë të cilat kanë hŷ në shqipen para shekullit XIII-të kur në gjuhët sllave të jugut *y*-ja kalon në *i* — krahasò *Bushtrica*, êmën i degës së Drinit të Zí në rrjedhjen e tij të poshtme.

Kësaj shtrese të vjetër elementesh të sllavishtes i përkasin edhè fjalët me metatezë sllave endè të pakryeme të tipit **tolt – tlat*, si psh. *daltë* prej **dalto* përkundruell të mâvonëshmes *dlato*[7]) dhe fjala *harabel* e gegënishtes së jugut, tosk. *arravelë* „vramç" me refleks shqiptár të vokalit sllav krejt të shkurtë midis okluzivit dhe likuidit[8]), njilloj si në greqishten e ré *salóma* „kashtë" (Thesali) = **soloma* në lidhje trajtën mâ të ré sërb. *slăma*[9]). Shtresës së vjetër t'elementevet të

---

[1]) Krahasò sidomos Fr. Ramovš, *Razprave* II (1944) 113—124.

[2]) Treimer, *Archiv für slavische Philologie* XXXV, 602 e vazhdim.

[3]) Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen* 120.

[4]) Jokl, *ibid.* 58; id. *Slavia* XIII 293 e vazhdim.

[5]) M. Vasmer, *Studien zur alban. Wortforschung* I 58 e vazhdim.

[6]) Jokl, *Studien zur alban. Etymol. und Wortbildung* 102; Wędkiewicz, *Mitteilungen des Rumän. Instituts an der Univ. in Wien* I 287.

[7]) M. Vasmer, *Živaja starina* XV 278; Skok, *Slavia* II, 115; Barić, *Arhiv za arban. starinu* II 386.

[8]) Për këte shih A. Meillet, *Le slave commun* 61.

[9]) Jokl, *Indogermanische Forschungen, Anzeiger* XXXV 36.

sllavishtes i përkasin edhè fjalët e huamarruna shqipe në të cilat *š*-ja âsht zâvêndësim i *s*-ës sllave, krahasò shqip *lesh* prej sllav *lěsa*[1]), *shuk* „topthi" prej sllav. *sŭka*[2]), *koshere* prej sllav *kosyrĭ*[3]). Meqenëse *s*-ja e italishtes në fjalët shqipe të huamarruna mbetet e pandryshueme[4]) dhe ndikimi italjan në fjalorin e shqípes fillon aty nga vjeti 1000, âsht e qartë se zâvêndësimi shqiptar i *s* > *š* ka ndodhë mâ së voni para shakullit të XI-të. Për ndikimet sllave relativisht shum të herëshme në gjuhën shqipe, mâ në fund na tregon edhè rrethana se rezultatet e zhvillimit të fjalës sllave *rav(ĭ)nŭ* (= *raun*) dhe êmnit antik të lumit *Bauanna* (prej *Barbanna* shih § 41) janë identike: shqip *rrue* : *Buenë*[5]).

Çeshtja sesa mund të kònstatohet kronologjija e zhvillimit fonetik të shqipes me anën e elementevet të sllavishtes, porsa ka fillue të trajtohet. Për periudhën parasllave të rotacizmit në shqipen krahasò § 41. Kalimi i *br* në *r* në gjuhën shqipe âsht krye para hŷmjes së elementeve mâ të vjetra të sllavishtes, krahasò *Dibra* (prej *dĭbr-*, shih § 62). Se kalimi i vonshëm shqiptar i *rn* në *rr* (shih § 26) ka përfshî edhè disa fjalë të huamarruna prej sllavishtes, tregojnë shêmbujt shqip *g(ë)rrèc* prej sllav. *gŭrn(ĭ)c-; gorricë* prej sllav. *gornica*, por kjo çfaqje nuk âsht mâ e vonëshme nga shekulli XI-të, sepsè ajo çfaqet vetëm n'elementet mâ të vjetra t'italishtes në gjuhën shqipe[6]).

Për shkak të fjalës shqipe *sule* prej sllavishtes *čŭlnŭ* „lundër" Vasmer-i mêndon se kalimi i *ln* në *l* të shqipes âsht bâ edhè në periudhën sllave, por kjo *a priori* âsht e pamundshme, sepsè faza kalimtare midis *ln* dhe *l* ka qenë gjeminati *-ll*, si shihet se zâvêndësimi i *ll* latine në gjuhën shqipe âsht *l* (krahasò lat. *pŭllus* > shqip *pulë*). Nji argument direkt se kalimi i togut konsonant *ln* në *l* në shqipen âsht krye në periudhën parasllave na âsht nji nga reliktet shqiptare mâ të vjetra në gjuhën rumune, *poală* prej shqipvj. **polë* (sot *pelë*) në të cilën mungesa e kalimit të *l*-ës intervokale në *r* në rumanishten unitare (krahasò rum. *ceru* prej lat. *caelu*) na tregon

---

[1]) Seliščev o. c. 145, 156, 178, 321.
[2]) Jokl, *Miletičev Zbornik* 142.
[3]) G. Meyer, *Etym. Wörterbuch der alban. Sprache* 201.
[4]) Thumb, *Indogermanische Forschungen* XXVI, 11.
[5]) Jokl, *Indogermanische Forschungen* XLIX, 286; L, 33, 37.
[6]) Helbig, *Jahresberichte des rumänischen Instituts in Leipzig* X,91.

gjeminatin *ll* në trajtën e parë shqipe **pōl-n-ā* (: greq. *pōlos*). Prandèj *l*-ja në fjalën shqipe *sul-e* duhet të jetë sekondare. Nominativi dhe akuzativi i sllavishtes *čŭlnŭ* në gjuhën shqipe âsht pranue si nji trajtë e caktueme e akuzativit të gjinís mashkullore *sul-në*, prej nga — simbas shêmbullit të nominativit *mal-* akuzativi *mal-në* — âsht krijue nominativi i rí *sul*, dhe kỳ âsht zgjânue me sufiksin kolektiv *e* — krahasò *djep-e* : *djep*[1]).

63. Për përcaktimin e kronologjís së ndryshimevet fonetike të shqipes kanë rândësí reflekset shqiptare të togjeve sllave *kl*, *gl*, sepsè ato na tregojnë se diferencimi dialektuer i shqipes ka ndodhë në periudhën mbassllave, meqenëse reflekset e këtyne togjevet konsonante janë identike në fjalët shqipe genuine dhe në fjalët shqipe me prejardhje sllave — krahasò fjalën e gegënishtes së jugut *gjuh(ë)*, shkodranisht *g'uh(ë)*, në gegënishten e verilindjes *gúh* — në gegënishten e jugut (Elbasan) *gjobë* (prej sllav. *globa*), në Shkodër *g'obë*, gjakovarisht *gób*. Kjo vlen edhè përsa i përkèt humbjes së medjave intervokale në shqipen që përfshîn jo vetëm elementet e vjetra romane (*mjek* prej lat. *medicus* si *dhí* = indoev. **dighā* — gjermanisht *Ziege*), por edhè fjalët mâ të vjetra sllave të huadhânuna gjuhës shqipe — si *ograjë*, *ugrajë* prej sllav. *ograda* me *j* të futun për pengimin e hiatusit, i cili ka ardhë mbas râmjes së *d*-ës intervokale[2]). Për humbjen mbassllave të medjave intervokale në gjuhën shqipe na tregon edhè fjala shqipe *Shkinikë* „Bullgarija" = *Sclavinica*[3]).

64. Në gjuhën shqipe inovacjone të cilat do t'ishin të kushtëzueme prej ndikimesh sllave, me përjashtim sufiksesh (shif § 66) — nuk ka. Ndikimet sllave shihen kryesisht në fjalorin e shqipes. Sintezën e gjurmimevet në këte drejtim, themelin e të cilavet e ka hjedhë

---

[1]) Jokl, *Indogermanische Forschungen* XXXVI, 158; id. *Slavia* XIII, 311.

[2]) Simbas Jokl-it në fjalën shqipe ograjë *j*-ja do të na udhëzonte n'origjihën çakavishte. Mirëpo çeshtja nëse në gjuhën shqipe ka fjalë të huamarruna ikavishte âsht endè sot e kësaj dite e hapun, — krahasò Barić, *Arhiv za arb. starinu, jezik* etj. I 205 e vazhdim. Selišćev-i, (o. c. 159) fjalën *ograjë* e nxjerr prej bullg. *ogradńa*, gjâ që âsht e pamundshme, sepsè nuk ka kurrfarë provash që *dń* në gjuhën shqipe të jetë asimilue në *ń*, mandèj kundër origjinës bullgare flet rrethana se fjala *ograjë* gjindet vetëm në veriprendim të Gegënís.

[3]) Jokl, *Indogermanische Forschungen* XLIV 37 e vazhdim.

Fr. Miklosich-i (1870)[1]), âsht përpjekë ta japi A. M. Seliščev-i (o. c. 140—200) sadoqë koha për këte endè nuk ka ardhë, jo vetëm për arsye se mungon puna paraprake mbi shtrîmjen gjeografike t'atyne fjalëvet të huamarruna të cilat do të na jepshin pikat nisëse të shtrîmjes së tyne, por edhè për shkak se në nji numër të madh rastesh nuk janë gjetë kriteret për përcaktimin kronologjik të shtresave, të cilave u përkasin këto fjalë të huamarruna dhe për shkak se vetë lânda âsht mbledhë, gati ekskluzivisht, prej fjalorit dhe sepsè midis sllavizmavet janë rradhitë shum pseudosllavizma dmth. fjalë për cilat qysh moti âsht vërtetue origjina e tyne thjeshtësisht shqiptare (si psh. *a[illegible]ís*[2]), *gërris*[3]), *groshë*[4]), *plotní*[5]), *shurrë*[6]), *vrânë*, tosk. *vrërë*[7]) etj. greqizmat si *poganik*[8]), turqizmat si *zapaná*[9]) etj. etj.

65. Fjalët e huamarruna të njij gjuhe janë kriterjumi objektiv për intenzitetin dhe mënyrën e ndikimeve të hueja kulturore të cilave u ka qenë shtrue nji popull, sidomos kur për këte nuk ka burime historike të shkrueme. Fjalët sllave të huadhânuna gjuhës shqipe kanë të bâjnë kryesisht me punët bujqësore (krahasò psh. *prashis* — sllav. *prašiti, vadis* — maqed. *vadit* etj.) dhe me veglat bujqësore e me pjesët e tyne përbâmëse (psh. *branë* — sllav. *brana*; *kosë* — sllav. *kosa*; *koshere* — sllav. *kosyrĭ*; *jarm* — sllav. *jarĭmŭ*; *llopar* — sllav. *loparĭ*; *oshtë, oshtëje* — sllav. *o/j/ishte* etj. etj.); me shtëpín (*izbë* — sllav. *izba*; *pod* — sllav. *podŭ*; *postrè-ja* — sllav. *podstrěxa*; *strehë* — *strěxa*; *trem-i, treme-ja* — sllav. *tremŭ* etj.) dhe me orendít shtëpijake *kofçek* sllav. *kovčegŭ*; *stoll* — sllav *stolŭ* etj.; me enët (psh. *bludë* — sllav. *bl'udo*; *çerep* — maqed. *cerep*, *gërçàk* — sërb. *krčag*; *g(ë)rrèc* — sllav. *gŭrn/ŭ/cĭ*, *koritë* — sërb. *korito*; me enët e shtëpís së zjarmit (psh. *sitë* — sllav. *sito*;

---

[1]) Fr. Miklosich, *Albanische Forschungen* I. *Die slavischen Elemente im Albanischen: Denkschriften des Akad. der Wissenschaften*, Phil.-hist. Klasse XXIX. Wien 1870.

[2]) Krahasò Barić, *Albanorum. Studien* I.

[3]) Krahasò Jokl, *Slavia* XIII.

[4]) *Ibid.* 209.

[5]) Krahasò G. Meyer, *Etym. Wörterbuch* 321.

[6]) Krahasò Barić o. c. 96 e vazhdim.

[7]) *Ibid.* 117.

[8]) Prej fjalës greke *apogonikía*, krahasò G. Meyer o. c. s. v.

[9]) Prej fjalës turqishte *zap(h)aná*, krahasò Jokl o. c. 315 e vazhdim.

*vedër* — sllav. *vědro* etj.); me rrethinën e shtëpís (psh. *kotèc* — sllav. *kotĭcĭ*; *kosh* — sllav. *košĭ*; *oborr* — sllav. *oborŭ*; *plemë* — maqed. *plemna*; *plevicë* – *plevnica* etj.; mandej me terminologjín e industrís shtëpijake (*bërdila* — sërb. *brdila*; *drugëz* — sërb. *drŭga*; *motovilë* „eleme" — sërb. *motovilo*; *valanicë, valavicë* — sërb. *valjavica* etj.); me mbathje *opingë* — sllav. *opĭnka, opângë* — sërb. *opanak*; me veshje: *rizë* — sllav. *riza*; *rub* „shamí koke" — sllav. *rubŭ* etj.; me êmnat zoologjikë: *galë* — sllav. *gala*; *esh* „iriq" — sllav. *ežĭ, meçkë* — sllav. *mečka*; *molicë* — sllav. *molica*; *sokol* — sllav. *sokolŭ*; *stenicë* — sllav. *stěnica*; *vrabec* „arabel" — sllav. *vrabĭcĭ*; me êmna të kafshëve shtëpijake (*kokosh* — sllav. *kokošĭ*; *kvoçkë* — sllav. *kvočka*; *patë* (gegënisht), *patak* (toskënisht) — sërb. *patak* — maqed. *patok* etj.; me metalet (*zhivë* — sllav. *živa*); me termat tokësore *lë(n)dinë* — sllav. *lędina, magulë* — sllav. *mogyla*; *rudinë* — sllav. *rudina*; *vrellë* — sllav. *vĭrelo*. Nji rândësí jashtëzakonisht të madhe kulturo-historike kanë termat juridike dhe administrative me origjinë sllave (*parotë* — sllav. *porota*; *zakòn* „dóke, adèt" — sllav. *zakonŭ*; *çelnik* „kryetar" — sllav. *čelinikŭ*; *vojvodë* — sllav. *vojevoda*; *gjobë* — sllav. *globa*; *gjobár* — sllav. *globarĭ*; *kasnec* — sllav. *kaznĭcĭ*; *carinë* — sllav. *carina*; *dim* „taksë në natyre" — sllav. *dim* (prej *dymŭ*); *ujem* — sërb. *ujam* etj.

Fjalët e huamarruna shqipe me karakter emocjonal mâ së shumti janë folje: *çuditë, çudis* — sllav. *čuditi* (krahasò *çudë, çuaí-ja* — sllav. *čudo*); *gërditë* — sllav. *gŭrditi*; *habitë – xabiti*; *lubis* „puth" — *l'ubiti*; *mërzitë* — sllav. *mŭrziti*; *shtravitë* „tmerue" — sllav. *straviti* etj.

66. Në pikëpamje gramatikore nji gjurmë të thellë në gjuhën shqipe e kanë lânë disa sufikse êmnore sllave, të cilat janë bâ produktive, dmth. se shartohen edhè në fjalët me origjinë shqipe edhè në fjalët e huamarruna shqipe me origjinë josllave. Këtu bâjnë pjesë sufikset e maqedonishtes *-ec* (sërbishtja dialektore = *ec* (*äc*), sërb. *-ac* (prej *-ĭcĭ*), psh. *pirr-ac* „therrë": *pirra*[1]), *thumb-ac*; *-ica* për ndërtimin e êmnavet të gjinís femnore psh. *bullicë* : *bull, gomar-icë* : *gomar*; *-ka* (shqip *-kë*) psh. *sherret-kë* : *sherret* (këte sufiks duhet me e dallue mirë prej sufiksit origjinár *-kë* të shqipes së lashtë në

[1]) Jokl, *Ling.-kult. Untersuchungen* 217.

fjalët *prof-kë, shemër-kë*[1]); *-ishte,* psh. në fjalët *plep-ishte* : *plep* (prej lat. *pōpulus*), *rrap-ishte*; *-nik* psh. *bes-nik* : *besë, fis-nik* : *fis*; mandèj *-ak* n'etnikonet (n'êmnat etnikë) — krahasò *mbishkodr-ak* „banor i Malsís së Madhe", *Rom-ak, Ulqin-ak* etj.[2]) — që duhet dallue prej sufiksit origjinár të shqipes së lashtë *-ak* në *pl-ak:* greq. *pel-ii-ós, pol-i-ós* „i thimë".

67. Foljet shqipe me origjinë sllave kryesisht janë folje me mbaresën *-is* në toskënisht, kurse me mbaresën *-it* në gegënisht = sllav. *iti* : *çudis* (sllav. *čuditi se*), *godis* (sllav. *goditi*), *koris* (sllav. *koriti*), *mërzis* (sllav. *mŭrziti*) ku hŷjnë edhè *darovis* (sllav. *darovati*), *dërmis* (sllav. *drěmati)* përveç *vikàs* = sllav. *vikati.* Përjashtimet prej kësaj kategorije janë vetëm në dukje, sepsè ato grupe foljesh të pakta shqipe me *-onj* të tipit *bisedónj* (gegënisht: *me bisedue*) nuk rrjedhin direkt prej sllavishtes *besědeti*, por janë ndërtim denominal prej fjalës shqipe *bisedë* = sllav. *beseda.*

---

[1]) Jokl, o. c. 9.
[2]) Barić, *Arhiv za arban. star.* I (1923) 247.

## VIII.

## NDIKIMET E GREQISHTES SË RÉ NË SHQIPEN.

68. Nga të gjitha marrëdhânjet me gjuhët fqije me të cilat gjuha shqipe ka ardhë në kontakt mbas shpërnguljes së Shqiptarëve nga mbrendësija e Gadishullit Ballkanik dhe ardhjes së tyne n'atdheun historik (shif § 44), mâ së paku âsht studjue marrëdhânja midis shqipes dhe greqishtes së ré dhe kjo kryesisht përsa i përkèt ndikimeve të shqipes në greqishten e ré[1]), e jo anasjelltas, me përjashtim të studimit t'elementevet leksikore të greqishtes së ré në fjalorin e shqipes, të cilat kryesisht kanë mbetë në rezultatet e mërrijtuna prej G. Meyer-it në fjalorin e tij etimologjik të gjuhës shqipe të vjetit 1891[2]).

Nga fjalët e shumta greke të huadhânuna gjuhës shqipe, pjesa mâ e madhe ka hŷ në nji periudhë mjaft recente, madjè jo vetëm êmnat e objektevet të përdorimit të përditshëm, termat kishtare dhe tregtare, por edhè termat abstrakte, madjè edhè nji numër i madh foljesh. Në këto fjalë të huamarruna çfaqen ndryshime tingullore shum të pakta. Në vokalizëm nuk ka ndryshime, ndërsa konsonantizmi grek deri-diku i âsht përshtatë sistemit fonetik të shqipes. Kështu psh. *l*-ja ose *ll*-ja (*l'* ose *l̃*) âsht zâvêndësim i *l*-ës greqishte (krahasò *pallamár* = greq. *palamári*), ndërsa në fjalët e huamarruna krejt të reja çfaqet „*l*-ja e mesme" (shqip *fileps* = greq. *philépsō*; *k*-ja e butë (*k'*) në shqipen âsht *q*, greq. χ = χ dhe χ', kurse në fjalët e huamarruna dishka mâ përpara âsht zâvêndësue me *h* (shqipja e Kalabrís *haromë* = greq. *hárama* „pare"; zâvêndësimi i *g*-ës velare greke âsht *g* (shqip *gomár* — greqishte e ré *gomári*, shqipja e Siciljes

[1]) G. Meyer, *Albanesische Studien* II, 64—71; krahasò edhè Hoeg, *Les Saracatsans* II 206.

[2]) Disertacjoni i M. Hardy, *Ujgörög elemek az albán nyelvben* (Budapesti Tudományegyetem, Románisztikai dolgozatok), Budapest 1935 nuk shënon asnji hap përpara; krahasò N. Jokl, *Indogermanisches Jahrbuch* XXII.

*gaidhúr* „gomár" = greq. ré *gaidoúri*); kurse zâvêndësimi i *g* së greq. së ré pallatale âsht *gj* e butë (*ǵ*) ose (mâ e ré) *j* (krahasò *kallogjer* dhe *kallojer* — greq. *kalógeros*); *s*-ja që ka kalue në *š*, madjè edhè në shtresën mâ të vjetër të fjalëvet të huamarruna prej sllavishtes (shif § 62) mbetet e pandryshueme — krahasò *selí* — greq. e ré *sellí* „karrikë", *nisí* „ishull" — greq. ré *nēsē* (lexò *nisí*), gjithashtu fjala *pras* (përkundruell sinonimit *presh*) nuk mund të bâjë pjesë në shtresën e vjetër të greqishtes për shkak mos kalimi të *a*-s në *e*, sepsè kjo çfaqje nuk e kalon epokën e vjetër romane; konsonantet tingullore në fund të fjalëve janë bâ jotingullore, — krahasò *karaf*: në trajtën e skajueme *karavi*, greq. e ré *karavi*; vokali i fundit i fjalëvet të huamarruna nga greqishtja e ré i âsht përshtatë gjuhës shqipe: shkod. *varkë* „barkë" — greq. e ré *varka* „lundër" *lip* — greq. e ré *lipē* (lexò *lipí*), kurse *e*-ja âsht zâvêndësim shqiptar i *iá*, *eá* të greqishtes së ré (krahasò shqip *goné* „kând" prej greq. së ré *gōniá*, shqip *nomé* „e drejtë kullote" prej greq. ré *nomiá*[1]), njilloj si *e*-ja për *ia* në fjalën shqipe *magje* prej ital. *madia*[2]), dhe *e*-ja në fjalën shqipe *babúne* prej maqed. *babun(ï)ja*[3]).

Foljet e greqishtes së ré të cilat kanë hŷ vonë në shqipen janë marrë me mbaresën e aoristit (krahasò *plakós* „sulmoj" prej greq. ré *nà plakṓsō*; *porséks* „vështroj" prej greq. ré *prosékso*, dhe disa folje të huamarruna mâ të herëshme me mbaresën e prezentit (krahasò shqipen e Kalabrís *parastén* „jam i pranishëm" prej greq. ré *parasténō*; *psalónj* „këndoj" prej greq. ré *psállō*. Meqenëse imigracjonet e Toskëve n'Italín e Jugut dhe në Sicilje janë bâ në shekullin XV-të dhe XVI-të dmth. se këto elemente recente të greqishtes së ré kanë hŷ para kësaj periudhe, gjâ që vlen edhè përsa u përkèt elementeve të greqishtes së ré edhè në gegënishten, sepsè në lândën leksikore të shqipes, të cilën në kalimin nëpër Durrës për në Jeruzalem e ka shënue Arnold von Harff-i prej Köln-i (1496), ndodhet fjala e huamarrun e greqishtes së ré e shtresës mâ recente „*kijrij*" (lexò *qirí*). Në kundërshtim me këte, fjalët e huamarruna në të cilat, vokaleve të patheksueme të greqishtes së ré u përgjigjet *e*-ja (si psh. *alem* = greq. ré *áleima* (lexò *álimma*), *erëm* = greq. ré *érēmos* (lexò *érimos*)] duhet ti përkasin shtresës mâ të herëshme. Caku kohuer i sigurtë âsht i përcaktuem me rotacizmin, i cili âsht krye para epokës së ndikimeve

[1]) Jokl, *Linguistisch-kulturhist. Untersuchungen* 225.
[2]) Meyer-Lübke, *Grundriss der roman. Philol.* I i Gröber-it., 1048, 25.
[3]) Jokl, *Slavia* XIII, 303.

sllave në gjuhën shqipe (shih § 41). Krahasimi i dubleteve shqipe *korë* dhe *ikonë* = greq. ré *eikóna* (lexò *ikóna*) në të vërtetë tregon qartë se kalimi i *n*-ës intervokale në *r* shkon, përsa i përkèt kohës, krahas me humbjen e vokalit fillestar të patheksuem, i cili gjithashtu ndodh në periudhën parasllave të historís gjuhësore të shqipes, prej shka del se fjala *korë* i përkèt shtresës mâ të lashtë t'elementevet të greq. ré në gjuhën shqipe, kurse fjala *ikonë* — kohës recente.

69. Çeshtja nëse dhe në ç'masë pasqyrohen ndikimet e greqishtes së ré në morfologjín e shqipes, sillet: së pari rreth formimit të futurit me anë të „do të" (tosk. *do /të/ shkruaj*), dhe së dyti rreth humbjes s'infinitivit, i cili gjithashtu âsht nji çfaqje vetëm e shqipes së jugut. Tue ndjekë gjurmën e Fr. Miklọsich-it, i cili formimin e futurit me „do të" ia kushton ndikimit t'elementit autokton ballkanik[1]), Weigand-i âsht i mêndimit se kjo vetí, e cila âsht edhè e greqishtes së ré, e rumanishtes, e bullgarishtes, e maqedonishtes dhe e sërbo-kroatishtes — âsht me origjinë thrake, pra, me fjalë tjera me origjinë shqiptare[2]), gjâ që âsht krejtësisht e pamundun. Në shqipen e veriut futuri formohet me anën e prezentit të foljes „me pasë": „kam": *kam me shkrue*, kurse Jokl-i ka tregue[3]) se admirativi i shqipes, i cili âsht i formuem prej infinitivit të gegënishtes pà *me* me anën e *kam* të mbrapashtuem, ka origjinë futuri: „Kỳ pare paska" në fillim ka pasë kuptimin „kỳ pare do të ketë", prej nga rrjedh „kỳ duhet të ketë pare". Kỳ admirativ âsht edhè i gegënishtes, edhè i toskënishtes, pra, i mbarë shqipes e kjo domethânë se formimi i futurit me anën e *kam* + infinitiv âsht çfaqje e vjetër shqipe, kurse formimi me anën e „do të" në dialektin e toskënishtes âsht nji çfaqje e ré. Meqenëse zona dialektore e toskënishtes ka qenë e përfshîme nga ndikimet e greqishtes së ré, âsht e qartë se burimi i tipit të futurit të toskënishtes, simbas Sanfeld-it, duhet të kërkohet në greqishten[4]), ku *théllō* (= „due") + infinitiv çfaqet qysh në shekujt e parë t'erës sonë[5]) dhe ku âsht ruejtë, në trajtë dialektore, deri më

[1]) *Die slavischen Elemente im Rumänischen*: *Denkschriften der Wiener Akademie*, Phil.-hist. Cl. vëllimi XII.

[2]) *Ethnographie von Makedonien*, Leipzig 1924; krahasò edhe parathânjen e tij programatike në vëllimin e parë të *Balkan-Archiv-it* të tij, Leipzig 1925.

[3]) *Litteris* IV, 207—208.

[4]) *Linguistique balcanique* 18.

[5]) Dieterich, *Untersuchungen* 245

sot[1]). Nji argument i rândësishëm në favor të këtij koncepti âsht fakti se që të dý tipat e futurit të toskënishtes: *do të shkruaj* : *do shkruaj* gjinden në greqishten qysh n'epokën e mesme greke, — krahasò *the* (shkurtim i *thele*) „do(n)" në përdorimin pavetuer *nà gráphō* dhe *the gráphō*. Vrejtja eventuale, se ndikimit grek duhet me ia kushtue vetëm fazat e fundit të zhvillimit të futurit toskënisht, dhe se ai, ndoshta, do të jetë me origjinë shqipe, bie poshtë a priori për shkaqe kronologjiko-gjeografike. Futuri i vjetër i greqishtes ka humbë qysh në gjuhën greke të Dhiatës së ré, dhe në këte periudhë nuk kanë mujtë të ndodhin kurrfarë ndikimesh të shqipes në gjuhën greke, sepsè n'atë kohë Shqiptarët janë ndodhë në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik, në krahinën e zonës gjuhësore latine.

70. Me origjinë të greqishtes së ré, padyshim, âsht edhè humbja e infinitivit në toskënishten, pra, në krahinën dialektore në të cilën simbas shêmbullit të greqishtes së ré âsht formue edhè futuri me „do të". Humbja e infinitivit në greqishten — vû në dukje nga Miklosich-i — âsht krejtsisht e qartë: për shkak të ramjes së *n* së fundit n'infinitivin e vjetër të greqishtes *thélei[n]*, *thélei* ai âsht njâjtësue me trajtën e vehtes së tretë të singularit dhe âsht krijue njifarë koklavitjeje, për shmang'jen e së cilës âsht dëbue tipi *thélō agei* me përgjithësimin e fjalivet mvartëse që kanë egzistue q'prej kohësh me *nà* : *thélō-ágei* (prej *thélō ágein*) — *thélō nà ágei*, që çfaqet qysh në gjuhën greke të Dhiatës së ré. Këtij konstrukti përshkrues grek i përgjigjet konstrukti i toskënishtes me *të*, mbas të cilit vijon, konjuktivi njilloj si në greqishten, (greq. *dosmon nà píō* — tosk. *a-më-të pí*), krahasò Sanfeld-in, *Rumänska studier*, 1900; *Linguistique Balkanique* 184. Përkimi i toskënishtes me greqishten shihet edhè në faktin se në fjalít me *ná* të greqishtes = me *të* të shqipes, folja që vjen menjiherë mbas *të*-s nuk mund të ndahet prej tyne me êmën. Edhè zhvillimi i mâtejshëm i këtyne fjalive me *na* të greq. në fjalít me *dià ná*, për të nënvizue finalitetin, e ka reflektin e vet në tosk. *për të*, inovacjon i cili ka përfshî jo vetëm zonën e ngushtë, dmth. dialektet toskënishte në Greqí, por në kohët e fundit edhè të gjithë Toskënín, madjè vênde-vênde ka kapërcye edhè Shkumbinin.

---

[1]) Thumb, *Handbuch der neugriechischen Sprache* 226.

REGJISTRAT

# REGJISTRI ANALITIK


*a* > *e* në shqip-thrak 36; në shqipo-romanishten 64

*ā* (indoev., greqvj.) > shqip *o* 51; *-ā* (indoev.) > shqip *-ë* 64

admirativi. ~ i shqipes ka origjinën në futurin e vjetër të mbarëshqipes me *kam* 83

akcenti. ~ indoevropjan 11; stabilizimi i akcentit në gjuhën shqipe 12; gjurmat e akcentit të shlirshëm indoev. në shqipen 12

aoristi ~ i greqishtes në mbaresën e foljeve shqipe me origjinë të greqishtes së ré 12

apofonija 13; ~ kuantitative 13; ~ kualitative 14; kritika teorís së zgjatimit plotësues 14

artikulli. ~ postpozitiv në shqipen dhe armenishten 39; shqip *i* < indoev. **is* ose **ei* 40; *u* < indoev. (*o*)*vo*(*s*) 40; ~ i rumanishtes nuk âsht me origjinë shqipe 67-68

*aų* (indoevr.) > shqip-thrak. *a* 38; lat. *au* > shqip *a* 39

*ct* (lat.) > shqip *ft*, rum. *pt* 50,63; shqip *it* = dalm. *it* 63

deklinacjoni. ~ i shqipes ndaj indoevropeishtes 40-41

*-e* (indoev.) > shqip *ø* 40

*ė* (indoev., greqvj.) > shqip *o* 64; lat. *ē* > *ie* 51

*ě* (sllav.) maqed. *'a*, *a* shqip *a* 74

*ę* (sllav.) > shqip *ën* 74

*eá* (greq ré) > shqip *é* 82

*en* + *s* (indoev.) > shqip *i*, arm. *i* 39

*eų* (indoev.) > shqip dhe trak. *e* 38

fjalët e huamarruna. ~ shqipe prej greqvj. 81; ~ latine-romane 59; ~ gotike 71; ~ sllavishte 78-79; ~ të greqishtes së ré 82

futuri. ~ origjinár 19; ~ i shqipes me *kam* ka origjinë të mbarëshqipes 83; origjina e futurit të toskënishtes të tipit *do* (*të*) *shkruaj* âsht nga greqishtja e ré 83-84

*gl*. Kalimi i ~ në shqipen: gegjug. *gj*, shkod. *gl*, gegver. *g* ka ndodhë në periudhën mbassllave të zhvillimit fonetik të shqipes 77

greqishtja e vjetër. Fjalët e huamarruna shqipe me origjinë prej greq. së vjetër 51

grupi gjuhësuer baltiko-sllav. Marrëdhânja e shqipes me grupin ~ 43-44

guturalet (indoev.) Gjurmat e sistemit të treshit të ruejtum në shqipen 33; ~ e thrakishtes 33; ~ e armenishtes 33; kalimi i vonshëm i $\widehat{k}$, $\widehat{g}(h)$ ievrop. > shqip *s, th, z, dh, d* 32

gjenitivi. ~ indoev. me *-ī̆as* (shqip *-e*) âsht edhè i arm. edhè i irlandishtes 42; *-ve* < indoev. *e* 42; *-š* < indoev. **som* 41

gjenitiv-dativi. ~ i shqipes âsht formalisht dhe funksjonalisht dativi i vjetër 40; ~ i greqishtes âsht gjenitivi i vjetër 41; ~ i shqipes me *-i, -u* < dativit indoev. 41

ilirishtja. ~ bân pjesë në grupin *centum* 32-46; kontributi i saj në formimin e gjuhës shqipe 31

imperfekti. ~ i gegënishtes ndërtue me anën e *-š* s'aoristit sigmatik 42

indoevropeishtja zânafillëse. Shif edhè *akcenti, apofonija.* Sistemi vokalik 9; konsonantizmi 11. Deklinacioni 14; deklinacioni i êmnave 14; deklinacioni i adjektivere 15; deklinacioni i përêmnave 17. Verbi 18; infinitivi 19; participet 19. Sintaksa 19-20. Vetît dialektore 26. Individualizimi i gjuhëve historike indoevropjane 29

Indoevropjanët. Atdheu parahistorik 23-25; kultura 21-22; dyndja në Gad. Ballkanik 46

infinitivi. ~ indoevropjan 19; humbja e infinitivit në dialektin e toskënishtes âsht me origjinë prejgreqishtes së ré 84; ~ i gegënishtes me *me* + substantivi verbal 84; ~ i rumunishtes me *a* paravûse 67

*i̯-* (indoev.). Zavêndësimi i dyfisht i *i̯* në gjuhët shqipe, armenishte dhe greqishte 23

*ĭ* (sllavvj.) > shqip *i* 75

*ja* (sllav.), greg. rè *iá*, ital. *ia* > shqip *é*. 82

*k* mbas konsonantit nazal në gjuhën shqipe, greqishte të ré dhe maqedono-rumanisht > *g*. 58; shif *Sonorizimi.*

*l* (lat.) > shqip. *t* (ll) 76

*ll* (lat.) > shqip *l'* (l) 76

*ln* (indoev.) asimilue në *l'* n'epokën parasllave 76

*m̥* (indoev.) > shqip *a*, thrak. *a* 35

*n̥* (indoev.) > shqip *a*, thrak. *a*, *an* 35

*n* (indoev.) mbas velareve > shqip *r* 49

*-n-* (indoev. greq. lat.) > shqip *-r-* 68; shif *rotacizmi.*

*ŏ* (indoev.) > shqip *a*; nën akcentin sekondar < *u* 38

*ȯ* (indoev. greqvj., lat.) > shqip *e* (prej *ö*) 36

*p* mbas konsonantit nazal > shqip greq ré, maqedorum. *b* 58

palatalizimi: ~ vokalik *a* > *e*, *ō* (**ö*) > *e*, *ū* > *ü(y)* në shqipen 36; gjurmat në thrakishten,

frigjishten dhe armenishten 36; origjina mediterane e kësaj çfaqjeje 38; ~ shqip i *k* indoev. para e âsht mâ i vonshëm se kalimin i *ē* indoevropjane në *o* 33

paralelet leksikore ~ shqipo-armenishte 43; shqipo-baltiko-sllave 44; shqipo-rumune 65-66

përkimet semantike shqiptaro-rumune 66

*ŗ* (indoev.) > shqip-thrak. *ri, ur*; thrak-arm. *ar* 36

*r* medjopasive indoev. 27-28

reliktet ~ ilire në shqipen 32; ~ mediterane 17

*rn* (indoev., lat., rum., greqré., sllav.) > shqip *r̄* (*rr*), arm. *ŗ* 34

romanishtja e vjetër e Bregdetit Adriatik. Përkimet me shqipo-romanishten: *á* > *e*, *ā* > *ó*, *ct* > *it* 63; përkimet leksikore 65

rotacizmi. Gjurmat në gegënishten 68; ~ i toskënishtes dhe i rumanishtes veriore âsht krye n'epokën parasllave 48

rumanishtja. Atdheu i gjuhës rumune unitare 63; elementet e vjetra të shqipes në rumanishten 66; isofonat rumuno-shqiptare 63; isofonat dhe isoglosat tosko-rumunoveriore 69; sa kohë ka zgjatë simbjoza e vjetër rumuno-shqiptare 69; mbarimi i kontakteve tosko-rumunoveriore 69; ndikimi i vonshëm i gjuhës së Vllehve të Drinit në gegënishten 70

*s* (indoev.) > shqip *š* (*sh*) para pallataleve > *h* para vokaleve jopallatale > *g'* (*gj*) para vokaleve të theksueme 72

*s* (lat. greqvj. sllavvj.) > shqip *š* (*sh*) 76

sistemi vigezimal 57-58.

*sk̂ (h)* (indoev.) > shqip *h* 34; ievr. *sk̂* dhe *sq* janë të ndame në shqipen edhè n'armenishten 34

*sk* (indoev.) para vokaleve pallatale shqip *tš* (*ç*); në rastet tjera > *sk* 35

Sllavët. Depërtimi i Sllavëve në Shqipní âsht mâ i vonshëm se dyndja e Shqiptarëve n'atdheun e tyne historik 42; dyllojshmënija e elementeve etniko-linguistike të Sllavëve të Jugut në Shqipní 72-73

sonorizimi. ~ i *k, p, t* në gjuhën shqipe mbas konsonanteve nazale dhe origjina e tyne 58

*sr* (indoev.) > shqip, thrak., ilir., sllav, gjerm. > *str.* 35

sufikset. Paralelizmi shqip-*shor*: ruman. *(i)şor*, shqip *-uk, -uq* (*-ok, -oq*): rumun. *-uc, -uţ* 67; ~ sllave *-ak, -ište* 80

shqipja. Shoshitja e teorís ilirjane 31-32 ~ âsht nji dialekt thrakas shum i ilirizuem 30; marrëdhânja e shqipes me arme-

nishten 33, 39, 41; ndikimet e greqvj. në shqipen 31; kritika hipotezave mbi ndikimet skitjane 52; elementet latine 50-51; shtresa balkano - romane 62; shtresa bregdetaro-romane 63-64; ndikimi i riargumentuem i gotishtes 71; ndikimet e gjuhëve sllave të Jugut 72-80; ndikimet e greqishtes së ré 81-84

Shqiptarët. Origjina e êmnit *Arbën : Arbër* 31; atdheu i hershëm i Shqiptarëve në mbrendësín e Gadishullit Ballkanik dhe simbjoza e vjetër shqiptaro-rumune 67; dyndja e Shqiptarëve n'atdheun historik 48; Shqiptarët dhe Romanët bregdetarë 63-64; Shqiptarët dhe Sllavët 72-80

*t* > *d* mbas nazaleve në shqipen, greq. ré, maq.-rum 58

teorija alarodike (mediterane) 58

tenues aspiratae (indoev.) në shqipen dhe armenishten 35

toponimet. ~ mediterane 55-57 ~ me origjinë sllave në Shqipní 72

*ā* (indoev. lat.) > shqip *ü* (y) 36; *ā* paraakcentore > *u* 38

*ă* (lat.) > shqip. *u* 64; *ă* > *o* 65

*ă* (sllavvj.) > shqip *u* 75

*y* (sllavvj.) > shqip *u* 75

# REGJISTRI I FJALËVET

**Shqip**


*afër* 71
*agòj* 39
*ah* 24
*ár* 39
*ardhí* 43, 57
*arravelë* 75 (tosk.)
*avís* 78
*babúne* 82
*bágël* 22
*bálegë* 22
*bardhë* 52
*barrë* 34
*bashkë* 34
*bërdila* 79
*bijë* 57
*bír* 57
*bisedë* 80
*bisedòj* 80 (geg)
*bisedónj* 80 (tosk.)
*bisht* 56
*bludë* 78
*branë* 78
*bredh* 66
*brenë* 57
*brez* 66
*bukë* 65
*bung* 66
*burmë* 36
*buzë* 66
*carâ* 74
*carinë* 79
*çelnik* 79
*çepérak* 73 (geg.)
*çepirók* 73 (tosk.)
*çerep* 78
*çudë* 79
*çudí* 79
*çudis* 79
*çuditë* 79
*daltë* 75
*derë* 51
*desha* 39
*diftòj* 63 (geg.)
*diftónj* 63 (tosk.)
*djep* 77
*djepe* 77
*domaqin* 73 (Elb.)
*drejtë* 62, 63
*dreq* 65
*drugë(z)* 74, 79
*druhna* 75
*dýll* 36
*dhallë* 66
*dhâmb* 52
*dhí* 77
*esh* 79
*eth* 22
*fal* 35
*fang* 71 (geg.)
*fat* 71
*fëlqîni* 66
*fileps* 81
*fluturòj* 63
*fruit* 62 (shqipvj.)
*fshat* 66
*ftua* 39 (tosk.)
*ftue* 39 (geg.)
*furrik* 74
*gaidhúr* 82 (Sic.)
*galâmsh* 22
*galë* 79
*gashtër* 57
*gat* 79
*gazdë* 73
*gëlltis* 74
*gërçàk* 78
*gërditë* 79
*g(ë)rrèc* 76, 78
*gërris* 78
*gíobë* 77 (Shkod.)
*gób* 77 (Gjak.)
*gomár* 81
*goné* 82
*gorricë* 76
*groshë* 78
*groft* 65

*grue* 49
*gusë* 74
*gjashtë* 43
*gjatë* 35
*gjet* 71
*gjobár* 79
*gjobë* 77, 79
*gjumë* 12
*gjymtyrë* 63
*gjykòj* 38
*gjyq* 34, 38
*ha* 43
*habitë* 79
*hângra* 73 (geg.)
*hardelë* 34
*haromë* 81
*harr* 38
*harrabel* 85 (geg. jug.)
*helm* 37
*heshtë* 64
*hëngra* 43 (tosk.)
*ḫollë* 34
*-i* 40
*im* 16
*ikonë* 83
*izbë* 78
*jam* 34
*jarm* 78
*kallogjer* 82
*kallojer* 82
*karaf* 82
*karpë* 57
*karrutë* 75
*kasnec* 79
*katër* 10
*këndòj* 58
*kërmill* 57
*kërrutë* 34
*kofçek* 78
*kofshë* 50
*koftor* 63
*kohë* 33
*kokosh* 79
*kollë* 34
*koran* 57
*korë* 83
*koritë* 78
*kosë* 78
*kosh* 79
*koshere* 76, 78
*kotèc* 79
*krie* 65
*krimb* 36
*krushk* 65
*krye* 65
*kûj* 65
*kursej* 65
*kuvênd* 65
*kvoçkë* 79
*lajthí* 44
*lândë* 44
*langjim* 71
*ledhë* 43
*lejdhí* 44
*lesh* 26, 76
*lëndinë* 74
*lidh* 43
*lip* 82
*lodh* 38
*lthí* 44
*lubis* 79
*luftë* 50
*llopar* 78
*magulë* 79
*magje* 82
*mal* 57
*matukë* 75
*mâz* 57 (geg.)
*mbledh* 13
*mblodha* 13
*mbret* 58, 64
*meçkë* 79
*megje* 72 (Shkod.)
*mezhdë* 72 (tosk.)
*mëngónj* 66 (tosk.)
*mërgónj* 65 (tosk.)
*mërzitë* 79
*mëz* 57 (tosk.)
*mëzë* 57 (tosk.)
*mish* 39
*mjek* 77
*mjel* 20
*modhullë* 66
*mok(ë)në* 38, 51 (geg.)
*mokërë* 38, 51 (tosk.)
*molicë* 97
*moshë* 66
*motovillë* 79
*motër* 38, 57
*mushk* 34, 66
*nândë* 43 (geg.)
*natë* 35, 50
*nëntë* 43 (tosk.)
*ngarkòj* 58
*nís* 39
*nisí* 82
*nimé* 82
*oborr* 79
*ograjë* 77, 77
*opângë* 79
*opingë* 78
*orëndi* 74
*oshtë* 78
*oshtëje* 78

*pallamár* 81
*parasten* 82 (Kal.)
*parotë* 79
*pátak* 73 (geg.)
*patë* 79 (geg.)
*patók* 73 (tosk.)
*pelë* 76, 22
*pelind* 62
*pemë* 37
*peng* 61
*pëndár* 74
*përrue* 70
*pishë* 26, 50
*pjek* 20
*pjepën* 51 (geg.)
*pjepër* 51 (tosk.)
*plemë* 79
*plevicë* 79
*plakós* 82
*plotní* 76
*pod* 78
*poganik* 78
*porosis* 71, 74
*vorseks* 82
*vostreja* 78
*vrapazi* 41
*pras* 51, 82
*prashis* 78
*presh* 51, 82
*prrar* 34
*psalónj* 82
*pulë* 76
*purrë* 75
*pushòj* 37
*pýll* 65
*qartë* 66
*qeveris* 34
*qirí* 82
*qërtónj* 66 (tosk.)
*qytet* 64
*rek* 49
*remb* 61
*rëndë* 74 (tosk.)
*rizë* 79
*rub* 79
*rudinë* 79
*rrâni* 44 (geg.)
*rreth* 35, 36
*rrue* 76
*s* 43
*sanë* 74
*selí* 82
*-sitë* 78
*sivjet* 17
*sokol* 79
*sonte* 17
*sorrë* 11, 32, 52
*stenicë* 79
*stoll* 78
*strehë* 78
*sule* 75, 76
*sumbullë* 66
*sundoj* 74
*sŷ* 33
*shalët* 66
*shegë* 57
*sheng* 61
*sherp* 57
*shesh* 66
*shën(t)* 63
*shkabë* 57
*shkas* 34
*shkon* 34
*shkop* 34
*shkret* 66
*shkulka* 71
*shkurrë* 57
*shqer* 35
*shtalb* 44
*shtatë* 12, 35
*shtërpinj* 35
*shtrat* 64
*shtravitë* 79
*shuk* 76
*shullë* 75
*shurrë* 78
*teshë* 26
*tetë* 43
*t(r)aftár* 63
*trajtòj* 63 (geg.)
*trajtónj* 62 (tosk.)
*trase* 70
*tremb* 58
*treme* 78
*tremi* 78
*tridhetë* 44
*trondit* 74
*tugë* 74
*thadër* 10
*thanë* 52
*thí* 22
*thumbullë* 66
*-u* 40
*ugrajë* 77
*ujem* 79
*ulk* 22
*unë* 17
*urrej* 66
*vadis* 78
*valanicë* 79
*valavicë* 79
*valë* 51
*varka* 82
*ve* 21

*vedër* 79
*vesh* 44
*v(ë)nér* 65
*vidh* 24, 44
*vjedhullë* 52
*vjel* 44
*vjehër* 21
*vjet* 66
*vjet(ër)* 20
*vojvodë* 79
*vrabec* 79
*vrânë* 78 (geg.)
*vrellë* 79
*vrërë* 78 (tosk.)
*zakòn* 79
*záll* 52
*zapaná* 78
*zet* 35
*zgjedhë* 43
*zjarm* 33
*zjerm* 33
*zmojle* 65
*zog* 43
*zorrë* 11, 32, 52
*zhivë* 70

**Armenisht**

*aic* 22
*arj* 36
*ç* 43
*čim* 33
*dustr* 36
*eker* 43
*hair* 9, 21
*hurcanem* 34
*im* 16
*jak* 43
*kin* 33
*lois* 36, 38
*luc* 43
*lusoi* 38
*mair* 21
*malem* 20
*mis* 39
*oç* 43
*ort'* 43
*p'ul* 35
*tur* 36
*utem* 43

**Gjuhët baltike**

*áugu* 39 (lit.)
*bandà* 35 (lit.)
*bredù* 36 (lit.)
*dešim̃t* 11, 44 (lit.)
*duktẽ* 36 (lit.)
*dvãras* 51 (lit.)
*lašiša* 24 (lit.)
*lazdà* 44 (lit.)
*lentà* 44 (lit.)
*mansa* 39 (prusvj.)
*naktìs* 35, 50 (lit.)
*strávati* 35 (lit.)
*stataũ* 10 (lit.)
*suskote* 34 (lit.)
*šun* 36 (lit.)
*udrá* 22 (lit.)
*vãisius* 44 (lit.)
*valýti* 45 (lit.)
*vetušas* 20 (lit.)
*vil̃kas* 22 (lit.)
*widdewū* 21 (prusvj.)
*wilna* 51 (lit.)
*žárna* 11, 32, 52 (lit.)

**Baskisht**

*ardao* 57
*buztan* 57
*ezkurr* 57
*gestera* 57
*iturri* 56
*karbhe* 57
*mando* 57
*sagar* 57

**Etrurisht**

*capys* 57

**Finlandisht**

*oško* 24 (dial. çerem.)

**Frigjisht**

*doumos* 36
*kíklēn* 36
*kímeros* 36
*ni* 36

**Greqisht**

(Greq. e vjetër nuk âsht shënue)

*aĩx* 22
*akramýlla* 57 (para-greq.)
*boũs* 22
*dõron* 36
*eJgeusáimēn* 39
*enenkeĩn* 39
*ennéa* 43
*gaidoúri* 82 (greq. ré)
*gémos* 33
*gomári* 81 (greq. ré)
*gómphos* 11, 52

*hárama* 81 (greq. ré)
*héks* 43
*hekyrós* 21
*hevtá* 43
*hístāmi* 10
*hýdros* 22
*kýpnos* 12
*hȳs* 23
*kalogeros* 82 (greq. ré)
*khlamýs* 32
*khȳlos* 36
*kórdylos* 34
*kýklos* 36
*kyvernȱ* 34 (greg. ré)
*lákhnē* 26
*mākhanā̇* 38, 51
*mḗtēr* 21
*nēgateos* 69
*ny* 36
*órkhilos* 33
*oktȱ* 43
*palamári* 81 greq. ré)
*patḗr* 14, 21
*phérnē* 34
*philépsō* 81
*põlos* 22
*pournári* 34 (greq. ré)
*salóma* 75 (greq. ré)
*sellí* 82 (greq. ré)
*sphállō* 35
*stállā* 51 (lesb.)
*statós* 9
*sȳs* 22
*téktōn* 26
*thárses* 36
*vétos* 20

**Gjuhët gjermanike**

*brôþar* 12 (got.)
*dôms* 36 (got.)
*fadar* 9, 12, 21 (got.)
*Fohlen* 22 (gjerm.)
*fula* 22 (got.)
*Garn* 32 (gjerm.)
*kisil* 52 (gjermvj.)
*laks* 24 (gjerm.)
*malan* 20 (got.)
*mik* 20 (got.)
*muoter* 21 (gjermvj.)
*Nacken* 49 (gjerm.)
*niun* 43 (got.)
*ottar* 22 (gjermvj.)
*Otter* 22 (gjerm.)
*rad* 36 (gjermvj.)
*renne* 44 (gjermvj.)
*Sau* 22 (gjerm.)
*scalm* 37 (gjermvj.)
*sibun* 43 (got.)
*skalm* 35 (nordvj.)
*skewjan* 34 (got.)
*skulka* 71 (got.)
*stallra* 44 (gjermvj.)
*stat* 10 (gjermvj.)
*staþs* 9 (got.)
*stollen* 44 (holland.)
*Strom* 35 (gjerm.)
*su* 22 (gjermvj.)
*swehyr* 21 (gjermvj.)
*swigar* 21 (gjermvj.)
*taihun* 43 (got.)
*þaurp* 36 (got.)
*Vater* 9 (gjerm.)
*widowô* 21 (got.)
*Ziege* 77 (gjerm.)

**Ilirisht**

*billa* 57 (mes.)
*mannus* 57
*Menzana* 57

**Gjuhët indoiranjane**

(Indishtja e vjetër nuk âsht shënue)

*asmi* 34
*aštan* 43
*bhrā̇tār* 12
*dhršnōti* 36
*dvā̇r* 51
*dhávāte* 35
*gaūḥ* 22
*ghatatē* 69
*gna* 49
*kṛmiḥ* 36
*kharaḥ* 38
*matā̇* 21
*muškaḥ* 34
*nava* 43
*pačati* 20
*pitár* 9 (avest.)
*pitā̇(r)* 9, 12, 21
*ráthaḥ* 35
*ṛkšaḥ* 36
*saptá* 43
*sthitáḥ* 9
*svápnaḥ* 12
*svašruḥ* 21
*šala* 34
*šardula* 34
*šat* 43
*šatrám* 10
*tašti* 26
*udráh* 22

*udrō* 22 (avest.)
*viδavā* 21 (avest.)
*vithávā* 21
*vrkaḥ* 22

**Karisht**

*taba* 47

**Kaukazisht**

*žagar* 57

**Keltisht**

*athir* 9, 21 (irlvj.)
*bask* 34 (irlvj.)
*bo* 22 (irlvj.)
*gall* 52 (irlvj.)
*gorn* 11 (irlvj.)
*gueden* 21 (korn.)
*mathir* 21 (irlvj.)
*melim* 20 (irlvj.)
*stret* 35 (kornvj.)

**Latinisht**

*augeo* 39
*aurum* 39
*bōs* 22
*cantāre* 58
*castrare* 10
*coquo* 20
*cornix* 11, 32, 52
*cotoneum* 39
*coxa* 50
*crŭpta* 65
*datus* 10
*dictāre* 63
*directus* 62
*exmŭlgia* 65
*fructus* 62
*incaricare* 58
*imperátor* 58
*judice* 34, 38
*lŭcta* 50
*lactes* 62
*lixīva* 50
*lūceo* 36
*mannus* 57
*mater* 21
*molō* 20
*novem* 43
*octo* 43
*pater* 9, 21
*pectine-* 50
*pōmum* 37
*pōsāre* 37
*posco* 34
*ram(u)s* 61
*rota* 36
*satus* 10
*scāpus* 34
*scateo* 34
*septem* 43
*serpens* 35
*sex* 43
*sirpium* 57 (paralat.)
*socrus* 21
*status* 9
*sūs* 22
*tracta* 50, 63
*tractare* 62
*vetus* 20
*vidua* 21

**Ligurisht**

*saliunca* 35, 57

**Gjuhët romane (neolatine)**

*an* 66 (rum.)
*berză* 52 (rum.)
*brad* 66 (rum.)
*breña* 57 (spanj.)
*brenia* 57 (iber.)
*brîu* 66 (rum.)
*bu(d)ză* 66 (rum.)
*bunget* 66 (rum.)
*ceartă* 66 (rum.)
*certá (a)* 66 (rum.)
*chesa* 64 (dalm. jug.)
*cirou* 70 (rum.)
*coségro* 65 (dalm.)
*creier* 65 (rum.)
*cruţá (a)* 65 (rum.)
*cuiu* 65 (rum.)
*cúscru* 65 (rum.)
*căptir* 64 (istrorum.)
*drac* 65 (rum.)
*drept* 62 (rum.)
*escolca* 71 (portugj.)
*falcă* 66 (rum.)
*frîu* 66 (rum.)
*fróit* 62 (kërk.)
*fróit* 63 (kërk.)
*frupt* 62 (rum.)
*fşat* 66 (rum.)
*gata* 69 (rum.)
*iskolka* 71 (sardvj.)
*kuvînt* 65 (rum.)
*(a)laite* 63 (kërk.)
*lena* 64 (dlmjug.)
*manecà* 66 (rum.)
*mazăre* 66 (rum.)
*merge* 65 (rum.)
*moaşă* 66 (rum.)

*moş* 66 (rum.)
*muşcoiu* 66 (rum.)
*padure* 65 rum.)
*palaure* 65 (dlmjug.)
*parâu* 70 rum.)
*pen* 64 (dalmjug.)
*pi̯áktno* 50 (krëk.)
*poală* 76 (rum.)
*remo* 64 (dalmjug.)
*sâmbure* 66 istrorum.)
*sâmbur* 66 (maqedorum.)
*secret* 66 (rum.)
*sęmburi* 66 (meglorum.)
*şale* 66 (rum.)
*şes* 66 (rum.)
*trase* 70 (rum.)
*u̯ápto* $50_6$ (kërk.)
*urĭ(a)* 66 (rum)
*venîn* 65 (rum.)
*vjezure* 52 (rum.)
*zară* 66 (rum.)

### Gjuhët sllave

(Fjalët e përgjithëshme sllave nuk janë shënu-)

*babun(i)ja* 82 (maq.)
*bredǫ* 36
*časŭ* 33
*desętĭ* 44
*devętĭ* 44
*drŭga* 74, 79 (sërb.)
*dvorŭ* 51
*gazda* 73 (sërbokroat.)
*gl̨oba* 77
*gornica* 76
*govędo* 22
*gusa* 47 (s ërb.)
*gŭrn(ĭ)c* 76
*kašlĭ* 34
*kopsa* 50 (sërb.)
*koryto* 75
*kosyrĭ* 76
*kumatĭ* 36
*lĕsa* 76
*liksija* 50 (dalmjug.)
*losos* 24 (rus.)
*međa* 72 (sërb.)
*mel'ǫ* 20
*mežda* 72 (maq. jug)
*męso* 39
*motyka* 75
*ogradńa* $77_2$ (bullg.)
*pekǫ* 20
*pętĭ* 44
*plemna* 76 (maqed.)
*plevnica* 79 (maqed.)
*poglŭtiti* 74 (sll. kish.)
*poroj* 70 (bullg.)
*porǫčiti* 71
*pyr* 75 (çek.)
*rav(ĭ)nŭ* 76
*struja* 35
*sŭka* 76
*sŭlŭ* 75
*šestĭ* 44
*traita* 63 (kroat. dial.)
*trakta* 50 (kroat. dial. kërk.)
*trideseti* 44
*vetŭxŭ* 20
*vęzĭ* 24, 44
*vidova* 21
*vlŭkŭ* 22
*vlŭna* 51
*vydra* 22
*zobŭ* 11, 52
*žalĭ* 52

### Tokarisht

*laks* 24
*macar* 21
*pacar* 21

### gjuhët turke

*doxs* $64_3$ (bullg.)
*doxtor* $64_3$ (bullg.)

### Thrakisht

*árgilos* 33
*-aspo* 32
*-dama* 37
*-dava* 37, 46
*-deva* 37
*-domos* 37
*dzálmos* 32
*dzerm* 33
*dzétraia* 39
*génton* 35
*koadáma* 38 (dak.)
*níba* 34
*salía* 34, 57 (dak.)
*simpeax* 86 (dak.)
*skálmē* 35
*skiare* 35 (dak.)

### Ungarisht

*gazda* 73

### Venetisht

*bila* 57
*mego* 20

# REGJISTËR TOPONIMESH


*Alбanópolis* 30
*Alma* 56
*Almissa* 55
*Almus* 56
*Angros* 32
*Arba* 56
*Arbion* 56
*Arnisa* 55
*Asamos* 56
*Ascua* 55
*Asimos* 56
*Astibos* 49
*Astura* 56
*Attolobus* 35
*Athýras* 35
*Autigarbin* 35
*Austura* 56
*Authíparos* 35
*Barbanna* 48, 55, 56
*Barbanne* 55
*Bastera* 35
*Bauanna* 76
*Aelasturas* 56
*Bibastos* 39
*Boјana* 48
*Boz* 73
*Bozbregas* 73
*Brag* 74
*Brygeides* 47
*Buenë* 76
*Bunë* 48
*Burdipta* 36
*Burdua* 55
*Bushtricë* 70, 75
*Butua* 55
*Bystrica* 70
*Cartua* 55
*Celcia* 56
*Cres* 51
*Crexi* 51
*Daneion* 39
*Dibra* 75, 76
*Dobrova* 74
*Drabesces* 56
*Durrës* 71
*Dŭrač* 71
*Dyrráchium* 71
*Dzermizirga* 33
*Erbessos* 55
*Garesces* 56
*Goskova* 74
*Helm* 73
*Hundokuqi* 72
*Ishmi* 56
*Iturissa* 55, 56
*Krepsa* 51
*Kriekuqi* 72
*Larissa* 55
*Loidias* 36
*Lug* 74
*Lychnis* 49
*Ljubova* 74
*Maisan* 62
*Molçani* 73
*Malh* 57
*Malua* 55
*Naïssus* 49, 55
*Nastos* 37
*Nesaktos* 35
*Nesattium* 35
*Nestos* 37
*Nevadas* 35
*Niš* 49
*Ohri* 49
*Ohrid* 49
*Osăm* 56
*Osum* 73
*Paralisensium* 37
*Peščera* 72
*Pešter* 72
*Porolisson* 37
*Richios* 69
*Saguntum* 56
*Salpessa* 55
*Scupi* 49
*Segesta* 56
*Segissa* 55

*Sop* 73
*Stranbasta* 39
*Stravianae* 35
*Strevintia* 35
*Strymon* 35
*Stura* 56
*Shkinikë* 77
*Shkup* 49
*Shtip* 49
*Tara* 56
*Taranto* 56
*Turissa* 55, 56
*Vukaj* 73
*Vukatani* 73
*Vukli* 73
*Vulçani* 74
*Vulkatani* 73
*Želevižda* 72

## REGJISTËR ETNIKONESH DHE PËRSONASH

*Albanoi* 30, 31
*Acrabanus* 32
*Albi* 30
*Arbër* 30
*Arbnesh* 30, $30_2$
*Arbresh* 30
*Auluzanus* 37
*Balacros* 32
*Darsioi* 36
*Desiates* 48
*Doxs* $64_3$
*Moisoi* 37
*Mysoi* 37
*Outásios* 37
*Perustae* 48
*Rehtia* 64
*Roimetalkēs* 37
*Rumitalca* 37
*Triballoi* 36
*Vlahorichinoi* 69

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
BIBLIOTEKA LEGATË
KRIST MALOKI

Dr. H. Barić

HŶMJE NË HISTORÍN E GJUHËS SHQIPE

Korektorë:
H. Thaçi — H. Kaleshi

Tirazhi: 3.000 copë

Shtypshkronja „Beogradski grafički zavod" — Beograd
Shtatuer 1955